ISSN 1857-6443

Ligji aktual nuk e ndal korrupsionin! FAQE 4

Lëshime në rastin "Monstra" FAQE 5

Për 9 muaj, 1.6 mln udhëtarë FAQE 6

Institucionet ende të centralizuara FAQE 7

www.koha.mk

Koha

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3193 • E martë-e Mërkurë 10-11 tetor 2017 • 15 DEN

Ka femra që pranojnë të jenë "stoli"

FAQE 12-13

Liderët lënë nën hije kandidatët

Shkup, 9 tetor - Mbajtja e zgjedhjeve të rregullta fer dhe kredibile, si dhe me rezultate të pa manipuluara dhe të pranuara nga të gjitha palët, do të jenë testi kryesor i Maqedonisë për shkurtimin e rrugës së integrimeve euroatlantike. Zgjedhjet lokale për Maqedoninë pritet të kenë një vend të veçantë edhe në raport-progresin e Komisionit Evropian për vitin 2017, ndërsa jo pa impakt do të jenë edhe për Samitin e ardhshëm të paktit NATO vitin e ardhshëm, ku Maqedonia ka gjasa të marrë sinjale pozitive për anëtarësim. Keqpërdorimi i votës, për të cilin Prokura Speciale po bën hetime aktualisht, pastaj frikësimi i votuesve, votimi familjar, dhe përdorimi i resurseve shtetërore gjatë zgjedhjeve - ndër vërejtjet kryesore të raporteve të OSBE-ODHIR-it, pothuajse në çdo cikël zgjedhor... Faqe 3

Kumanova, qyteti i problemeve të shumta në arsim

Mjekësia, problem që rritet çdo vit

Krahas problemeve të shumta të pabarazisë në shkollat e mesme të Kumanovës, në këtë qytet vazhdon të rritet edhe një problem tjetër, ai i paraleleve të mjekësisë. Janë gjithsej 20 paralele të drejtimit motër medicinale, 12 në gjuhën shqipe dhe 8 në gjuhën maqedonase, të cilat funksionojnë në kuadër të shkollës së mesme teknike "Nace Bugjoni". Këtë fenomen e gjejmë edhe në Shkup, Gostivar, Strugë dhe Kërçovë FAQE 4

GLOBI

Brazili si Katalonja, kërkohet krijimi i një shteti të ri

Votuesit në jug të Brazilit janë pyetur në një anketë joformale nëse ata do të donin të ishin pjesë e një vendi të ri. Sondazhi u organizua një javë pas një referendumi të ngjashëm të ndodhur në Katalonjë, nga lëvizja separatiste e quajtur "Jugu është... FAQE 15

GLOB

Mijëra vende pune më pak për shkak të uraganeve

FAQE 15

RAJON

Përfshirja amerikane në dialog, e domosdoshme

FAQE 14

18 tetori vendimtar për Sopotin

Shkup, 9 tetor - Ndryshimi i Këshillit Penal në rastin e "Sopotit" ishte arsyeja e radhës se pse procesi gjyqësor kundër banorëve të fshatit Sopot të Kumanovës u prolongua për datën 18 tetor. Pala mbrojtëse e të akuzuarve, në koordinim me përfaqësuesin e ri të Prokurorisë Speciale Publike, prokurorin Burim Rustemi, propozuan që seanca e ditës së hënë të shtyhet për javën e ardhshme. Avokati i të akuzuarve, Vullnet Paçuku, theksoi se me qëllim që i gjithë ky proces të mos zgjatët më tepër, ato kanë propozuar anulimin e seancës, me çka gjatë ditëve në vazhdim - përfaqësuesit e akuzës dhe Këshilli i ri penal, do të kenë mundësi të njihen nga afër me lëndën në fjalë. "Besojmë se në seancën e ardhshme do të bëhet koncentrimi dhe shqyrtimi i të gjitha dëshmive kryesore, me çka shpresat tona janë që ky proces përfundimit të përmbyllet atë ditë", tha avokati Paçuku. Mes tjerash, ai... FAQE 5

GLOBI

Kush e vrau Anën?

FAQE 15

Gruevski: Ushqimor falas për nxënësit deri në klasën e pestë

Një vakt ushqimor të shëndetshëm falas nga klasa e parë deri në të pestën në të gjitha komunat ku do të fitojnë kryetarët e komunave të VMRO-DPMNE-së dhe ku partia do të ketë shumicën në këshill, premtoi sonte para qytetarëve të Strumicës lideri i VMRO-DPMNE-së Nikolla Gruevski në tubimin e koalicionit "Për Maqedoni më të mirë". Menyja tha ai do të përgatitet në bashkëpunim me nutricistë dhe sipas moshës së fëmijëve. Do të shmanget përdorimi i të ashtuquajturit ushqim i shpejtë. Ai shtoi se në pajtim me mundësitë financiare të komunave gjatë mandatit katërvjeçar do të punohet që ky projekt të përhapet edhe në klasat më të larta. Lideri i VMRO-DPMNE-së para të pranishëmve tha se janë qytetarët ata që do të vendosin më 15 tetor se në cilin drejtim do të ecë Maqedonia. Gruevski tha se VMRO-DPMNE është garanci për një Maqedoni të fortë dhe stabile, ndërsa duke folur për Qeverinë e Zaevit, ai tha se investimet kapitale kanë shënuar rënie, industria po bie, ndërtimtaria po shkatërrohet, ndërsa paga mesatare në vend që të rritet ajo po zvogëlohet. "Ne e dimë se si duhet t'u shërbejmë qytetarëve, ndërsa të tjerët nuk kanë ide për gjithë këtë. Ne sigurojmë vende pune, ata kanë vetëm fjalë boshe. Ne tregojmë rezultate, ata krijojnë mjegull. Politika e VMRO-DPMNE-së buron nga projekte dhe zgjidhje. Ne ju ofrojmë epokën e re, ku nuk do të ketë rrugë të paasfaltuara e të pandriçuara", tha Gruevski.

Ahmeti në Ohër dhe Strugë

Fitorja e Merkos, fitore e të gjithë qytetarëve të Strugës

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka qëndruar në anën e Strugës, me ç'rast tha se fitorja e Ramiz Merkos, do të jetë fitore e gjithë qytetarëve të kësaj komune. Në tubimin e mbajtur në Strugë u tha se përderisa oponentët lëshojnë "llafe fjalë të mëdha", është BDI-ja ajo që i bën punët e mëdha. Asim Musa, shef i shtabit lokal, duke folur për aktivitetin e deri-tashëm, tha se kandidatët e BDI-së me në krye Ramiz Merko, por dhe veprimtarët e shumtë, krahas ofertës së paraqitur po evidencojnë edhe të gjitha shqetësimet dhe kërkesat e elektoratit me qëllim që ato të inkorporohen në programin e ardhshëm katërvjeçar të qeverisjes lokale: "Tani dalëngadalë punët po i ndajmë, ne do të merremi me punë, ata të tjerët le të vazhdojnë me fjalë", tha Musa në sallën e mbushur përplot buzë Liqenit të Strugës. Duke iu drejtuar të pranishmëve kandidati për kryetar, Ramiz Merko, i bindur se në zgjedhjet e 15 Tetorit, BDI-ja do ta rikthejë pushtetin në Komunë, u shpreh se vijnë të udhëhequr me institucionin, por për interesat e qytetarëve, të të gjitha grup-moshave, të biznesit, të arsimit, shëndetësisë, për një ambient më të mirë e më të pastër të jetesës, për zhvillimin e turizmit, për uljen e papunësisë dhe për një mirëqenie më të mirë. Gjithë kjo do të bëhet me transparencë dhe llogaridhënie. "Ne do të qeverisim ashtu siç e do popullata, për çdo projekt do të konsultohemi me qytetarët dhe vendimet e përbashkëta do t'i realizojmë", tha Merko. Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, tha se Bashkimi Demokratik për Integrim vazhdon të mbetet zëdhënësi dhe mbrojtësi kryesor i kauzës shqiptare në Maqedoni.

"Ne me kohë parashikuam projektet, orientimet. Kur thamë që do bëhet kryetari i Parlamentit shqiptar, u tha - u bë! U thamë që tani është momenti që gjuha shqipe të jetë zyrtare dhe e barabartë në Republikën e Maqedonisë dhe që duhet mbyllur ky kapitull kaq i rëndësishëm nga Marrëveshja paqesore, u tha u bë!", rikujtoi Ahmeti dhe më pas shtroi nevojën e forcimit të stabilitetit dhe të paqes në vend. Ai nënvizoi se kjo mund të arrihet me çuarjen përpara të reformave dhe vendosjes së shtetit të së drejtës dhe me anëtarësimin në BE dhe në NATO. "Aderimi në këto struktura përfundimisht do të shmangte ndikimin e Rusisë në Ballkan", tha Ahmeti, duke u angazhuar për forcimin edhe të marrëdhënieve me fqinjët.

RISHIKIM I PLANEVE URBANISTIKE

Do të doja të theksoja tri projektet kryesore të parashikuara për Komunën e Çairit, të cilat nuk janë të shkruara në Kontratë dhe të cilat me siguri që planifikoj t'i implementoj në mandatin tim të ardhshëm, tha në konferencë për shtyp kandidati i BDI-së për kryetar të komunës së Çairit, Visar Ganiu. "Në bisedimet që i kemi pasur me qytetarët tanë në këtë muajin e fundit, disa herë më është theksuar se në Çair ka shumë pak parqe, parkingje dhe hapësira publike të cilat shpesh janë uzurpuar. Puna e parë që unë të bëj, si të marr mandatin e kryetarit të Komunës, do të jetë rishikimi i Planeve të detajuara Urbanistike. Me ekipin tim do të kontrollojmë nëse ka gabime të bëra me planet urbane? A mund të përmirësohet diçka? Unë ju premtoj se do të shfrytëzoj çdo mundësi të cilën ligji më jep brenda kompetencave te mija, që sa më pak të ketë hapësira urbane të uzurpuara dhe të planifikojmë sa më tepër vende me zona të reja të gjelbërta dhe hapësira të reja më të vogla parkimi!", tha Ganiu.

Sela: ASH, forcë e parë politike te shqiptarët

Shkup, 9 tetor - Aleanca për Shqiptarët mbajti një tubim madhështor në Sheshin "Skenderbeu" në Shkup, ku prezent ishin mijëra qytetarë, simpatizantë të kësaj partie. Në tubim pjesëmarrës ishin funksionarë të lartë të ASH, kandidat për kyetarë komunash, kandidat për këshilltarë komunal etj. Kryetari i Aleancës për Shqiptarët u prit me brohoritje dhe duartrokitje nga pjesëmarrësit në tubim. Ai në fjalimin e tij tha se më 15 tetor shkupjanët do ta tregojnë shqiptarinë e vërtet duke i dënuar ata që për 15 vite kanë dështuar në procesin e decentralizimit e më gjerë. Sela u shpreh se Aleanca për Shqiptarët shumë shpejtë do të jetë forcë e parë politike në bllokun shqiptarë sepse kjo parti sipas tij është krijuar për t'i bërë bashkë shqiptarët.

Kasami: Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimet, prioritet

Problemi nuk qëndron me mungesë të prurjeve të ujit, por me rrjetin e amortizuar. Sipas përllogaritjeve, mbi 50 për qind e ujit humbet në rrjetin e amortizuar. Kështu ka thënë kryetari i Lëvizjes BESA, njëherësh kandidat për Komunën e Tetovës, Bilall Kasami, i cili para tetovarëve ka premtuar rregullimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, ujërave të zeza dhe reshjeve atmosferike. "Riparim i rrjetit ekzistues duke ju dhënë prioritet pikave më kritike në qytet. Aty ku ka mungesë me të theksuara me furnizimin me ujë të pijshëm si dhe aty ku kemi më së shumti humbje të ujit Sipas një përllogaritje që e kemi bërë, shtrirja e rrjetit aktual është diku 40.000 metër gjatësi nga të cilët diku 30.000 metër gjatësi duhet riparuar tërësisht. Gjithashtu, rrjeti aktual duhet të zgjerohet që të mund të furnizoj tërë zonën urbane me ujë të pijshëm gjatë 24 orëve pa ndërprerje dhe restrikcione", ka thënë Kasami, i cili është zotuar të rikthejë konceptin e orëmatësve të ujit me çka, siç tha ai, do të kontrollohet shpenzimi i ujit. "Për një sasi të ujit të shpenzuar do të ketë një çmim të arsyeshëm kurse për ata që do të shpenzojnë pa kontroll do të duhet të paguajnë një çmim shumë më të lartë. Me këtë do të mundësojmë edhe uljen e nivelit të pagesës ekzistuese për ujë. Financimi i gjithë këtij aktiviteti do të bëhet me mjete nga buxheti i Komunës, si dhe me donatorë të jashtëm", është shprehur Kasami.

Zaev: Maqedonia po ndryshon

Shkup, 8 tetor - Maqedonia po ndryshon, po bëhet më e mirë dhe nuk ka kthim mbrapa, nuk do ta tradhtoj besimin tuaj, e keni fjalën time, porositi kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev. "Prej jush qytetarëve kërkoj mbështetjen si koalicion i bashkuar i majtistëve, djathtistëve, qendrës, liberalëve, të gjelbërve, të gjithëve. Të ndërtojmë komuna shërbyese dhe të zhvilluara, komuna dhe qytete të cilat do të punojnë për qytetarët", theksoi ai në tubimin qendror në Shkup të koalicionit "Për jetë në Maqedoni", të kryesuar nga LSDM. Zaev shtoi se në katër muajt e kaluara, pasi filloi me punë Qeveria e re me parime dhe politika të reja. "Treguam se jemi njerëz të fjalës, se jemi të përkushtuar në mënyrë serioze dhe ekonomike se në Maqedoni në mënyrë të ndershme mund të ketë ndryshim real", porositi lideri i LSDM-së. Si simbol i kohës së re paralajmëroi se "tanku" i Nikolla Gruevskit, gjegjësisht mercedesi qeveritar prej 600 mijë euro do të shitet dhe me paratë e vlerës aktuale të tij do të blihen automjete ambulante. Duke e kërkuar mbështetjen e qytetarëve Zaev e potencoi bashkëpunimin e pushtetit qendror dhe lokal dhe përkujtoi se në katër muajt e kaluar është krijuar plan për rritje ekonomike, kompani vendore janë në fokusin, ndërsa ka mbështetje edhe për investitorët e huaj. Shteti, tha ai, do të lëshojë para në ekonomi që ta parandalojë derdhjen e të rinjve dhe do t'ju ndihmojë bujqve. Ai paralajmëroi se

për zhvillimin e biznesit në Maqedoni nga buxheti për vitin 2018 janë planifikuar miliona euro dhe qindra milionë euro nga Banka Botërore dhe institucione të tjera financiare.

Zgjedhje kredibile test për Maqedoninë në rrugën euroatlantike

Liderët lënë nën hije kandidatët

Ditëve të fundit po dështmohet se sigla partiake dhe figura e liderit të partisë po lë nën hije kandidatët dhe programet e tyre zgjedhore për komunat përkatëse

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 9 tetor - Mbajtja e zgjedhjeve të rregullta fer dhe kredibile, si dhe me rezultate të pa manipuluara dhe të pranuara nga të gjitha palët, do të jenë testi kryesor i Maqedonisë për shkurtimin e rrugës së integrimeve euroatlantike. Zgjedhjet lokale për Maqedoninë pritet të kenë një vend të veçantë edhe në raport-progresin e Komisionit Evropian për vitin 2017, ndërsa jo pa impakt do të jenë edhe për Samitin e ardhshëm të paktit NATO vitin e ardhshëm, ku Maqedonia ka gjasa të marrë sinjale pozitive për anëtarësim. Keqpërdorimi i votës, për të cilin Prokura Speciale po bën hetime aktualisht, pastaj frikësimi i votuesve, votimi familjar, dhe përdorimi i resurseve shtetërore gjatë zgjedhjeve - ndër vërejtjet kryesore të raporteve të OSBE-ODHIR-it, pothuajse në çdo cikël zgjedhor. Lidhur me mbarëvajtjen e rregullt të procesit zgjedhor, Qeveria ka përgatitur një sërë masash ndëshkuese mes tyre dhe dënime në të holla për personat që shfrytëzojnë resurset shtetërore ditën e zgjedhjeve, ndërsa lidhur me keqpërdorimin e votës, Qeveria zotohet se do të respektojë me përpikmëri Kodin penal, i cili parasheh dënim të rënda deri në 5 vite burgim për ata që vjedhin vota. Por pastrimi i Listës zgjedhore lë shumë për të dëshiruar dhe ende mbetet një hije e zezë edhe për Qeverinë e re, ashtu siç ishte edhe për qeveritë e kaluara. Afër 30 mijë votuesit që ishin kontestuar nga LSDM në zgjedhjet parlamentare dhe që u hoqën nga Lista zgjedhore me aminin e të katër partive me të mëdha politike dhe që nuk pati kritika nga ndërkombëtarët, ndonëse u llogarit nga shumica e ekspertëve si veprim antiligjor dhe antikushtetues. Të njëjtit nuk po kontestohen nga LSDM që tani është në pushtet dhe duket se Qeveria e re pak ka bërë ose hiç për të hulumtuar më tej si qëndron problem me këta votues. KSHZ, që ashtu si Qeveria, është në sprovë të vërtetë për organizimin e zgjedhjeve pa probleme të natyrave të ndryshme, së fundmi ka miratuar Listën zgjedhore e cila ka mbi 1 milionë e 800 mijë votues për këto zgjedhje. Një numër i konsiderueshëm i tyre - mbi 70 mijë kanë vetëm pasaporta e nuk kanë letërnjoftime, ndërsa mbi 1800 janë nga të burgosurit që do të votojnë një ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Sa i përket përfaqësimit partiak në Këshillat Zgjedhor, ngaqë Komisionet komunale janë të përbërë nga punonjësit administrativ, Lëvizja BESA si partia e dytë më e madhe opozitare do të zëvendësojë PDSH-në përmes anëtarëve të vetë në Këshillat Zgjedhor. Kujtojmë se PDSH nga partitë opozitare e kishte primatin e përfaqësimit në këshillat zgjedhor në të gjitha ciklet zgjedhore që nga viti 2002 e këndej. Kur jemi tek numërimi i votave, ndonëse vazhdimisht ka kritika nga ndërkombëtarët dhe nga partitë opozitare në Maqedoni, ende nuk kemi një proces transparent deri në fund siç ka ndodhur vite më parë në Shqipëri, ku votat nuk numërohen në qendra e votimit, por dorëzohen në qendra të posaçme numërimi në nivel komunal dhe çdo votë paraqitet në skener dhe është e njohur për publikun. Në Maqedoni në çdo cikël zgjedhor nuk kanë pushuar zërat në opinion dhe vërejtjet e partive të papërfaqësuara në Këshillat Zgjedhor se rezultati real i votave të numëruara nuk është paraqitur në procesverbale, duke pasur vërejtje se fletëvotimet e mbetura janë ndarë proporcionalisht në vendvotime, ku nuk ka pasur monitorim të duhur të shtetit dhe organizatave joqeveritare, sidomos në zonat me të thella malore. Sa i përket fushatës parazgjedhore, deri më tani ka pasur disa incidente të vogla më shumë thyerje shtabesh lokalesh të partive politike, por që menjëherë masa ka marrë Ministria e Punëve të Brendshme. Incidenti i fundit ndodhur në Haraçinë mbrëmjen e së shtunës, ku një person më veturë Golf u raportua se ka gjuajtur në ajër në afërsi të aktivistëve të Lëvizjes BESA duke ngjitur pllakata nëpër mure. Incident tjetër pati dhe në Manastir, siç kanë njoftuar nga MPB, 15 min pas mesnatës së të shtunës është paraqitur edhe një rast tjetër ku në bulevardin "1 Maji" në Manastir janë parë tre persona deri sa kanë hedhur ngjyrë të zezë në pllakatën e kandidatit për kryetar komune të Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM). Incident është raportuar edhe në lagjen Draçevë, ku sipas MBP-së, një kryerës i panjohur me gur e ka dëmtuar xhamin e shtabit të partisë politike "Të bashkuar për Maqedoninë". Në aspektin e garës politike, fushata parazgjedhore pesë ditë para fundit të saj është bërë më intensive nga paraqitjet e liderëve dhe kritikat që japin njëritjetrit. Ditëve të fundit po dështmohet se sigla partiake dhe figura e liderit të artisë po lë nën hije kandidatët edhe programet e tyre zgjedhore për komunat përkatëse. Mes liderit të BDI-së, Ali Ahmetit dhe atij të ASH-së, Ziadin Sela, po zhvillohet një luftë verbale në distancë lidhur për qytetin e Strugës. Ali Ahmeti i BDI-së në tubimin e partisë së tij në Strugë tha se para se të nisë fushata parazgjedhore, i ka thënë liderit të ASH-së, Ziadin Sela se në këtë komunë do ti matin forcat veçmas dhe nuk do ta ndihmojnë Selën siç e ndihmuan gjatë zgjedhjeve të kaluara, ku Sela që fitoi në rrethin e parë kundrejt kandidatit të BDI-së, Arben Llabunisht, në rrethin e dytë u ndihmua nga BDI kundrejt kandidatit të VMRO-së. Por i menjëhershëm ka qenë kundërreagimi i Selës gjatë një tubimi në Shkup, duke i thënë Ahmetit se ai nuk është personi që mund ti jap atij mejdan në Strugë dhe duke ironizuar me Ali Ahmetin se elektorati i tij në Shkup nuk do të votojë një kandidat shqiptar ashtu siç do të votojë elektorati i ASH-së shqiptarin nga Shkupi, Naim Bajrami. BDI, ndonëse në koalicion me LSDM-në, ditë më parë kishte kritika ndaj Lëvizjes BESA së është në koalicion të heshtur me VMRO-në për Çairin dhe Tetovën - pretendime këto që u mohuan nga lidershipi i Lëvizjes BESA. Ndërkaq lideri i PDSH-së, Menduh Thaçi, gjatë një tubimi në Gostivar - duke potencuar se e vetmja parti opozitare shqiptare është PDSH, bëri edhe një pyetje publike deri te partitë tjera shqiptare: "Ku do të fshiheni kur ditën e zgjedhjeve do të del në pah realiteti i koketimit me partitë maqedonase?". Në taborin politik maqedonas, lideri i VMRO-së Nikolla Gruevski vazhdon të paraqitet si mbrojtës i interesave shtetërore të Maqedonisë, duke thënë se vetëm me fitoren e partisë së tij Maqedonia është e fortë dhe stabile. Gruevski gjatë një tubimi partiak në Strumicë akuzoi Qeverinë e Zaevit se po ndikon në rënien drastike të investimeve të huaja në vend. Nga ana tjetër, rivali i tij Zoran Zaev vazhdon më premtime para elektoratit të vetë. Së fundmi, ai premtoi mbështetje nga 30-50 për qind për investimet e reja të kompanive vendase, 70 milionë nga buxheti për vitin 2018 dhe 100 milionë nga Banka Botërore për zhvillimin e biznesit. Siç mund të vërehet tek dy blloqet maqedonase, tubimet elektorale mbahen me mijëra simpatizantë por e njëjta nuk vërehet edhe tek partitë shqiptare. Në qytete e mëdha - VMRO dhe LSDM dhe partitë që kanë në koalicion bëjnë tubime zakonisht me rreth 5 mijë veta, ndërsa shihet një atmosferë impozante të pjesëmarrësve me pllakata dhe fotografi të liderëve partiak. Para zgjedhjeve, opinionin e kanë intriguar dhe anketa e fundit e Institutit për hulumtimin e opinionit "Dimitrija Çupovski", e cila e nxori VMRO të parën me 38 % kundrejt 21% për LSDM-në. Tek partitë shqiptare - e para është BDI me 4.2% të votave, gati e barazuar me Lëvizjen BESA me 3.9%. Aleanca për Shqiptarët e Ziadin Selës, sipas anketës, është me mbështetje 2%, ndërsa për partitë tjera do të votonin. 2.9%.

KANDIDATËT ZOTOHEN PËR TETOVË TË PASTËR

Me nënshkrimin e marrëveshjes "Pesë përkushtimet ndaj tetovarëve" të inicuar nga organizata joqeveritare ambientaliste "Eco Guerilla", kandidatja për kryetare komune nga radhët e Bashkimit Demokratik për Integrim, Teuta Arifi, si dhe kandidati nga Aleanca për Shqiptarët për kreun e Komunës, Adnan Neziri, janë zotuar se nëse marrin besimin e qytetarëve për të qeverisur me Komunën e Tetovës, në mandatin katërvjeçar do të angazhohen në realizimin e pesë përkushtimeve që kanë të bëjnë me transparencën e plotë fiskale, pastrimin e rrugëve, dhe lagjeve të qytetit, organizimin e transportit publik, si dhe shndërrimi i kazermës në park të qytetit. Nga Lëvizja "Eco Guerilla" theksuan se janë ftuar të gjithë kandidatët nga të gjitha partitë politike për të nënshkruar këtë dokument, mirëpo disa të tjerë edhe pse ftesës i janë përgjigjur pozitivisht munguan në aktin e nënshkrimit. Sipas Eco Guerillës, marrëveshja e nënshkruar do të mbikëqyret nga ana e kësaj organizate joqeveritare, por edhe nga ana e qytetarëve, të cilët janë të interesuar të jetojnë në një qytet më të pastër, më të zhvilluar dhe më të bukur.

TRE INCIDENTE TË LIDHURA ME ZGJEDHJET LOKALE

Në 24 orët e kaluara policia ka regjistruar tre incidente të ndërlidhura me zgjedhjet e ardhshme lokale, informoi të hënën MPB-ja. Incidenti i parë është regjistruar mbrëmë në fshatin Haraçinë, derisa aktivistët e partisë politike BESA kanë ngjitur pllakata, një person i panjohur nga automobili ka qëlluar me një plumb në ajër me armë zjarri, pas çka është larguar në drejtim të panjohur. Në lagjen Draçevë një kryerës i panjohur me gur e ka dëmtuar xhamin e shtabit të partisë politike "Të bashkuar për Maqedoninë". Në bulevardin "1 Maji" në Manastir efektivë të policisë kanë hasur tre persona se si me sprej të zi e spërkatin në pllakatën zgjedhore të kandidatit për kryetar të komunës të partisë politike "LSDM".

Në tre muajt e parë janë realizuar të gjitha masat qeveritare nga Plani 3-6-9

Shkup, 9 tetor - Në tre muajt e parë janë realizuar të gjitha masat, të cilat janë në kompetencë të Qeverisë, gjegjësisht 58 aktivitete nga plani 3-6-9, informoi Grupi ministror i punës për ndjekjen e zbatimit të këtyre masave. Me takimin e Grupit ministror, kryesoi kryeministri Zoran Zaev, ndërsa në të cilin u shqyrtuan aktivitetet për reformat në më shumë fusha me kompetencë të Qeverisë, në ministri të ndara dhe në agjenci dhe institucione të tjera qeveritare, të ndërlidhura me procesin për integrim euroatlantik të Maqedonisë. Grupi i punës ishte informuar se në vijim është realizimi edhe të 15 masave, prej të cilave një pjesë më e madhe nuk janë në kompetencë të Qeverisë. Implementimi i këtyre masave do të vazhdojë në periudhën e ardhshme, dje me atë masat e parapara në tre muajt e parë, do të realizohen tërësisht. Në seancën e sotme të Grupit punues ministror për ndjekjen e zbatimit të Planit 3-6-9, ishte konstatuar se edhe krahas fushatës parazgjedhore, fokusi i Qeverisë është drejtuar ndaj implementimit të masave dhe se nuk ka kurrfarë ngecje në procesin e zbatimit të prioriteteve reformuese urgjente. Në pajtim me rekomandimet e Komisionit Evropian, përkatësisht edhe të prioriteteve reformuese urgjente që dolën nga të dy raportet e KE-së, të udhëhequra nga grupi i ekspertëve në krye me Rajnhard Pribe, në tre muajt e fundit nga Plani 3-6-9 theks më i madh do të vendoset në reformat në gjyqësi, shërbimet e zbulimit dhe të sigurisë, administratën publike dhe reformat në fushën e mediave dhe shoqërisë civile.

Megjithëse disa herë është ndryshuar Ligji, Komisioni ende funksionon si i organ i varur nga shteti dhe partitë, prandaj është e domosdoshme të ndryshohet sistemi dhe mënyra e funksionimit të këtij organi shtetëror

Rrogë më të vogël për mjeken të cilës i vdiqën katër foshnja

Shkup, 9 tetor - Mjekja nga klinika e Shkupit për gjinekologji në kujdestari të së cilës vdiqën katër foshnja të porsalindura, ndërsa ajo nuk ishte në vendin e punës në atë moment, gjashtë muajve të ardhshëm do të merr 30 për qind rrogë më të vogël dhe do të punojë nën mbikëqyrje të një specialisti tjetër, ndërsa do t'i merret edhe subspecializimi për neonatologji.

Ky është vendimi i komisionit disiplinor, i formuar pasi që mjekja gjatë kohës së kujdestarisë ka lëshuar Klinikën dhe është kthyer madje kur është informuar për rastet. Nga Komisioni për mbikëqyrje profesionale më herët kanë konfirmuar se nuk bëhet fjalë për gabim mjekësor, por vendimi i masës disiplinore vjen pasi rasti është bërë publik.

Komisioni për Antikorrupsion të lirohet nga kthetrat partiake

Ligji aktual nuk e ndal dot korrupsionin!

"Jo vetëm Sllovenia, por edhe shumë vende tjerra të rajonit kanë ndryshuar modelin e funksionimit të Komisionit për antikorrupsion dhe janë shumë më përpara se modeli të cilin ende e zbaton për momentin Maqedonia. Është koha që edhe Maqedonia të vendos model të ri se si të luftojë korrupsionin me qëllim që në të ardhmen - të jetë një komision objektiv i pavarur dhe efektiv", deklaroi Kos

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 9 tetor - Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsion i Maqedonisë (KSHPKM) është në krizë si pasojë e Ligjit të vjetër. Megjithëse disa herë është ndryshuar Ligji, Komisioni ende funksionon si i organ i varur nga shteti dhe partitë, prandaj është e domosdoshme të ndryshohet sistemi dhe mënyra e funksionimit të këtij organi shtetëror. Kështu deklaroi Drago Kos, kryetar i OECD-së dhe ish kryetari i Komisioni për Anti korrupsion të Sllovenisë në konferencën që të hënën u mbajt në Shkup me temë "Modeli i trupit preventiv i antikorrupsionit, si funksionon modeli i tanishëm dhe a ka nevojë të ndryshohet ky model", organizuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe organizatës joqeveritare "Transparent Maqedoni". "Jo vetëm Sllovenia, por edhe shumë vende tjerra të rajonit kanë ndryshuar modelin e funksionimit të Komisionit për antikorrupsion dhe janë shumë më përpara se modeli të cilin ende e zbaton për momentin Maqedonia. Është koha që edhe Maqedonia të vendos model të ri se si të luftojë korrupsionin me qëllim që në të ardhmen - të jetë një komision objektiv i pavarur dhe efektiv", deklaroi Kos. Slagjana Taseva nga "Transparent Maqedonia", u shpreh se analiza e përgatitur nga QMBN dhe "Transparent Maqaedoni", ka për qëllim të zbulojë se sa Komisioni për Antikorrupsion ka qenë efikas në kryerjen e detyrave dhe sa ky institucion shtetëror ka qenë korrektor i pavarur ndaj politikave korruptive që i kanë zhvilluar funksionarë të lartë shtetëror. "Për fat të keq, dhjetë vitet e fundit kemi ngecje totale të punën e Komisionit për antikorrupsion. Ky konstatim është cekur edhe në raportin e fundit të Komisionit Evropian, prandaj dhe po shqyrtojmë modelet ekzistues se si funksionojnë Komisionet për antikorrupsion në disa vende të Evropës dhe në bazë të këtyre modeleve të përparuara, të bëhet ndryshimi i modelit ekzistues në Maqedoni se si duhet të funksionon KSHPKM-ja",deklaroi Taseva. Gjëja e parë, sipas Tasevës, duhet të përforcohen kapacitetet që njerëzit që punojnë në Komisionin për Antikorrupsion, të kenë integritet dhe të lirohen nga të gjitha ndikimet partiake. "Të eliminohen të gjitha mangësitë që i ka Ligji aktual, sepse këto 10 vite ka punuar në mënyrë selektive si pavarësi e pamjaftueshme e KSHPKM-së. Të bëjmë një model të ri dhe të kopjojmë model. Ky model i ri duhet të funksionojë sipas ligjeve tona", deklaroi Slagjana Taseva nga "Transparent Maqedoni". Marija Sazdevski nga QBMN para se të prezantojë rezultatet nga mbikëqyrja e punës së KSHPKM-së, deklaroi se komisioni duhet të merr masa ndaj të gjitha institucioneve shtetërore që nuk bashkëpunojnë me Komisionin për Antikorrupsion. "Raporti për periudhën janar-qershor tregon se Antikoprrupsioni i është përgjigjur 2686 kërkesave për dhënie të mendimit nga ana e institucioneve shtetërore për zbatimin e Ligjit për parandalimin e korrupsionit gjatë proceseve zgjedhore, ndërkaq nuk ka marrë masa konkrete për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e informatorëve. Vetëm 18 nga gjithsej 1291 institucione aktive në sektorin publik kanë dorëzuar raporte për gjysmëvjetorin e parë se kanë pranuar raporte të denoncuara nga informatorët, ndërsa në anën tjetër - 29 institucione e kanë plotësuar obligimin për dërgimin e informatave për persona të autorizuar të raporteve nga informatorët", deklaroi Sazdevski.

Kumanova, qyteti i problemeve të shumta në arsim

Mjekësia problem që rritet çdo vit

Krahas problemeve të shumta të pabarazisë në shkollat e mesme të Kumanovës, në këtë qytet vazhdon të rritet edhe një problem tjetër, ai i paraleleve të mjekësisë. Janë gjithsej 20 paralele të drejtimit motër medicinale, 12 në gjuhën shqipe dhe 8 në gjuhën maqedonase, të cilat funksionojnë në kuadër të shkollës së mesme teknike "Nace Bugjoni". Këtë fenomen e gjejmë edhe në Shkup, Gostivar, Strugë dhe Kërçovë

Koha Laura PAPRANIKU

Shkup, 9 tetor - Në kuadër të reformave të paralajmëruara në sistemin arsimor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të rregullojë edhe shpërndarjen e drejtimeve profesionale të shkollave të mesme, me theks të veçantë të drejtimeve mjekësore. Në një pjesë të madhe të qyteteve si Kumanova, Gostivari, Struga apo Kërçova - paralelet e mjekësisë formohen nëpër shkolla jomjekësore, Raste të këtilla ka edhe në Shkup, ku që për mungesë të hapësirave në shkollën e mesme të mjekësisë "Pançe Karagjozov", të formohen 12 paralele (sa edhe në gjuhën maqedonase) shumë paralele në gjuhën shqipe formohen në ish-shkollën e mesme tregtare "Cvetan Dimov" si dhe në shkollën e mesme të kimisë "Maria Kiri Skllodovksa".

Që cilësia e shkollimit nuk është e njëjtë si në shkollat mjekësore ashtu edhe në shkollat jo mjekësore, nuk ka nevojë për analizë shumë të thellë, pasi këtyre të fundit u mungojnë laboratorët dhe gjenden larg klinikave. Por pavarësisht kësaj, interesimi i nxënësve për të vijuar arsimin e mesëm shëndetësor është shumë i madh edhe në shkollat jo mjekësore. Në Kumanovë,

për shembull, për 102 vendet e paraleleve në gjuhën shqipe - ishin 154 kandidatë me mbi 65 pikë. Për shkak të numrit të kufizuar të paraleleve, na mbetën jashtë listave të pranimit shumë nxënës, gati dy paralele, pohon Nexhbedin Saliu, përgjegjës i paraleleve shqipe të teknikës dhe mjekësisë ën Kumanovë. "I fundit në listën e nxënësve të pranuar për paralelet e infermierisë është me 71.80 pikë", tregon ai, ndërsa vëren se edhe numri maksimal prej 34 nxënës në klasë është ngarkesë e madhe. Sipas tij, paralelet e këtilla duhet të shkojnë në histori dhe për këtë MASH duhet të nis zbatimin sa më të shpejtë të paralajmërimeve për formimin e paraleleve me maksimumi 24 nxënës në klasë. "Mësimi me grupe të vogla jo vetëm që e bën orën e mësimit më efektive, por e rrit cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies", shprehet më tej ai, ndërsa konsideron se janë të nevojshme edhe disa ndryshime në mënyrën e organizimit të paraleleve mjekësore dhe profileve të tyre. Për vitin shkollor 2017/2018, Saliu thotë se ishte kërkuar të ndryshohen profilet e drejtimeve mjekësore, me atë që në Kumanovë të mos hapen vetëm drejtime të infermierisë (motër medicinale), por të shkohet në kombinime varësisht nevojave të tregut. "Pra, jemi të mendimit se drejtimet e mjekësisë duhet të kombinohen, të kemi nga një paralele motër medicinave, laborantë dhe teknik dhëmbësh". Mirëpo, për këtë thotë se nuk morën një përgjigje pozitive nga MASH. Për pasojë, të gjitha paralelet u formuan në drejtimin motër medicinale. Këto paralele në Kumanovë formohen në kuadër të shkollës së mesme të teknikës "Nace Bugjoni", prej të cilave 3 në gjuhën shqipe dhe 2 në gjuhën maqedonase. Por, paralelet në gjuhën shqipe, si të mjekësisë ashtu edhe të teknikës, funksionojnë jashtë objekteve të shkollave amë që nga viti 2002. Tradicionalisht, në shkollat e mesme profesionale - numri i nxënësve shqiptarë është më i madh se sa numri i nxënësve maqedonas, por pavarësisht kësaj - të gjitha shkollat drejtohen nga maqedonasit dhe në të gjitha rastet - paralelet më mësim në gjuhën maqedonase gjenden në objektet e shkollave amë. Problemi qëndron në atë se është jashtëzakonisht i thellë dallimi në kushtet e punës dhe hapësirave që ofrojnë shkollat amë ku gjenden paralelet maqedonase, nga njëra anë dhe objektet e përkohshme ku janë vendosur paralelet me mësim në gjuhën shqipe. Në rrethana të këtilla, nuk mund të besohet as në idenë për shkëputjen e paraleleve të mjekësisë në një subjekt të veçantë juridik në Kumanovë edhe pse me gjithsej 20 paralele (12 në gjuhën shqipe dhe 8 në gjuhën maqedonase) do të funksiononte për mrekulli një shkollë e mesme e mjekësisë edhe në këtë qytet.

Dënimin me burg në Idrizovës e vuajtën pesë nga gjithsej 13 të akuzuar, me çka Sulejman Sulejmani, Samet Lutfiu, Hasan e Zenel Klaiqi dhe Shaban Limani, për shtatë vite rresht - nga viti 2003 e deri në vitin 2010 qëndruan në qeli

Vuajtjet e fshatarëve të Sopotit pritet të marrin fund

18 tetori vendimtar për Sopotin

Përveç shqyrtimit të plotë të lëndës, e cila pritet të bëhet brenda 10 ditëve, në seancën e caktuar për më 19 tetor, në Gjykatën Penale të Shkupit do të prezantohet si dëshmitar edhe Ramadan Bajrami, personi kyç që sipas aktakuzës, pranoi se policia me keqtrajtime dhe tortura e ka detyruar të firmos deklaratë me të cilën i ngarkon bashkëfshatarët e tij për vendosje të një mine në rrugën e fshatit Sopot, ku si pasojë ndërruan jetë dy ushtarë polak të KFOR-it dhe një përkthyes vendas

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 9 tetor - Ndryshimi i Këshillit Penal në rastin e "Sopotit" ishte arsyeja e radhës se pse procesi gjyqësor kundër banorëve të fshatit Sopot të Kumanovës u prolongua për datën 18 tetor. Pala mbrojtëse e të akuzuarve, në koordinim me përfaqësuesin e ri të Prokurorisë Speciale Publike, prokurorin Burim Rustemi, propozuan që seanca e ditës së hënë të shtyhet për javën e ardhshme. Avokati i të akuzuarve, Vullnet Paçuku, theksoi se me qëllim që i gjithë ky proces të mos zgjatët më tepër, ato kanë propozuar anulimin e seancës, me çka gjatë ditëve në vazhdim - përfaqësuesit e akuzës dhe Këshilli i ri penal, do të kenë mundësi të njihen nga afër me lëndën në fjalë. "Besojmë se në seancën e ardhshme do të bëhet koncentrimi dhe shqyrtimi i të gjitha dëshmive kryesore, me çka shpresat tona janë që ky proces përfundimit të përmbyllet atë ditë", tha avokati Paçuku. Mes tjerash, ai nënvizoi se para publikimi të "bombave", në të cilën dëgjohet se si ish-ministrja e MPB-së, Gordana Jankullovska dhe ish shefi i policisë sekrete, Sasho Mijallkov, flasin për atë se si është montuar "Sopoti", pala mbrojtëse e të akuzuarve në këtë lëndë prej fillimit ka qenë e bindur se bëhet fjalë për një proces të montuar gjyqësor. Në seancat gjyqësore, të cilët janë zhvilluar gjatë 15 viteve të kaluar, avokatët e të akuzuarve në rastin e "Sopotit" thanë se janë prezantuar me qindra prova dhe dëshmi se klientët e tyre fare nuk kanë lidhje me këtë rast. Përveç, shqyrtimit të plotë të lëndës, e cila pritet të bëhet brenda 10 ditëve, në seancën e caktuar për më 18 tetor, në Gjykatën Penale të Shkupit pritet të prezantohet si dëshmitar edhe Ramadan Bajrami. Ky person, sipas aktakuzës, është personi kyç në të gjithë këtë proces gjyqësor, i cili më pas e pranoi se policia e ka keqtrajtuar dhe torturuar me qëllim dhënien e deklaratës se të akuzuarit e "Sopotit", janë personat që e kanë vendosur minën në rrugën e fshatit Sopot, ku si pasojë ndërruan jetë dy ushtarë polak të KFOR-it dhe një përkthyes vendas. Ndryshe, dënimin me burg në Idrizovës e vuajtën pesë nga gjithsej 13 të akuzuar, me çka Sulejman Sulejmani, Samet Lutfiu, Hasan e Zenel Klaiqi dhe Shaban Limani, për shtatë vite rresht - nga viti 2003 e deri në vitin 2010 qëndruan në qeli.

PROKURORËT DHE GJYKATËSIT E RASTIT "MONSTRA" TË PËRMBAHEN NGA KOMENTET

Qëndrimet e gjykatësit hetues se në rastin "Monstra", palës mbrojtëse u janë dhënë për shqyrtim të gjitha dëshmive verbale dhe materiale, nuk janë të vërteta. Në kuadër të riaktualizimit të debatit për procesin gjyqësor për krimin në Liqenin e Smilkovës, të hënën - avokati Naser Raufi, tha se janë bërë shumë lëshime sa i përket të drejtës ligjore që ju takon të akuzuarve për t'u mbrojtur. "Pavarësisht faktit nëse ekzistojnë apo jo dëshmi shtesë për rastin 'Monstra', vlerësoj se shkeljet dhe lëshimet të cilët janë bërë në të gjithë procedurat gjyqësore, qoftë në shkallën e parë apo të dytë të gjykimit, mjaftojnë si fakt që e dëshmojnë pafajësinë e të akuzuarve. Ndërsa, për provat që i posedon PSP, mendoj se edhe më tepër do të ndihmojë në zbardhjet e plotë të këtij rasti", tha avokati Raufi. Ai apeloi që askush prej të implikuarve në procedurën gjyqësor për rastin "Monstra", qoftë prokurorja Gordana Geshovska apo gjykatësi hetues Vlladimir Tufegxhiq, nuk duhet të japin komente dhe sqarime të pabaza, për atë se çka ndodhur në fillim të këtij rasti, për shkak se i gjithë opinionin është në pritje të vendimit të Gjykatës Supreme.

Janeva: Lëshime të shumta në rastin "Monstra"

Shkup, 9 tetor - Përherë të parë po dëgjojë se të dënuarit për rastin "Monstra" do të lirohen dhe kjo nuk është punë e Prokurorisë Speciale të vlerësojë se duhet apo nuk duhet të lirohen. Puna e Prokurorisë Speciale është të analizojë që nga dita e parë kur kjo lëndë i kaloi Prokurorisë Speciale. Kështu ka thënë prokurorja speciale, Katica Janeva, në pyetjen e gazetarëve se a do të lirohen të dënuarit me burg të përjetshëm për rastin "Monstra". "Puna jonë është të analizojmë të gjitha bisedat e regjistruara. Nuk mund të themi se si po analizohen të gjitha rastet, e në veçanti për rastin 'Monstra'. Prokuroria publike nga ne ka kërkuar tua dorëzojmë bisedat e përgjuara deri të gjykata ose ne ta marrin këtë rast. Prokuroria publike kërkon që lënda të rikthehet nga fillimi për shqyrtim në procedurën e shkallës së parë, që të mund të eliminohen të gjitha shkeljet qenësore gjatë udhëheqjes së seancave të mëparshme. Sa kemi arritur të shqyrtojmë këtë rast, edhe ne kemi konstatuar se ka pasur shumë lëshime në udhëheqjen e procesit gjyqësor. Megjithatë, sado që të pyetni apo të shkruani për rastin, ekipi i Prokurorisë Speciale në krye me mua duhet të jemi të sigurt se si ti qasemi këtij rasti, pasi lënda mbeten te ne", deklaroi Janeva.

Kujdes në rrugët e Tetovës

Tetovë, 9 tetor - Rënia drastike e temperaturave, veçanërisht në orët e para të mëngjesit, por edhe në ato të mbrëmjes, por edhe paraqitja e mjegullës në disa pjesë të rajonit më të gjerë të Pollogut, përveç tjerash, edhe më shumë imponon nevojën e kujdesit gjatë vozitjes, por edhe përshtatjen e shpejtësisë me kushtet në rrugë. Për arsye se për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë, rrugës së lagësht dhe të rrëshqitshme, por edhe për shkak të mosrespektimit të shenjave të komunikacionit - këto ditë kanë ndodhur dhjetëra aksidente që janë shoqëruar me lëndime të rënda tek personat të cilët janë aksidentuar në komunikacion, por edhe me një dëm të konsiderueshëm, thekson Marjan Josifovski, zëdhënës i SPB-së në Tetovë.

"Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë apelon deri tek vozitësit, veçanërisht deri tek ato me më pak përvojë, pa nevojë të mos shpejtojnë si dhe vazhdimisht t'ju përmbahen kufizimeve të shpejtësisë, të mos parakalojnë në vende të palejuara, si dhe të ju ikin konsumimit të pijeve alkoolike, gjithmonë kur janë ose planifikojnë që të jenë para timonit. Në të kundërtën, vozitësve të cilët vozisin shpejtë, do t'ju përgatiten padi, si dhe do të ballafaqohen me gjoba që lëvizin nga 10 deri në 400 euro në kundërvlerë të denarit, varësisht asaj ku dhe si kanë tejkaluar shpejtësinë e lejuar, por edhe me masë të përkohshme, marrjen e lejes për vozitje nga 3 deri në 12 muaj.

Gjoba e paraparë ligjore për parakalimin e parregullt dhe të palejuar sërish është nga 20 deri në 300 euro në kundërvlerë të denarit, si dhe në masën e përkohshme gjithashtu marrjen e lejes për vozitje nga 3 deri në 12", thotë Josifovski.

Sipas tij, vozitësit të cilët do të drejtojnë automjetet e tyre nën ndikim të alkoolit i pret gjobë nga 200 deri në 375 euro në kundërvlerë të denarit, si dhe marrjen e lejes për vozitje në kohëzgjatje prej një viti. Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, gjithashtu rekomandon vozitësit të cilët me automjetet e tyre drejtohen apo lëvizin në drejtim të luginës së Radikës, të kujdesen nga rënia e gurëve, të cilët si zakonisht biejnë kur kemi të bëjmë me kohë me shi dhe kur temperaturat janë të ulëta. *(U.H)*

Kronikë

Shkup, 42 aksidente me tre të lënduar rëndë

Shkup, 9 tetor - Gjatë tre ditëve të fundit, në rajonin e SPB Shkup kanë ndodhur gjithsej 42 aksidente trafiku. Në tre prej tyre më rëndë janë lënduar tre persona, në 17 lëndime më të lehta trupore kanë marrë 34 persona, ndërsa 19 aksidente kanë kaluar vetëm me dëm material. Siç informon MPB-ja, të premten policia e trafikut ka kryer ekspertim në 18 aksidente, nga të cilat në një më rëndë është lënduar një person, në shtatë më lehtë janë lënduar 16 persona, ndërsa shtatë kanë kaluar vetëm me dëm material. Të shtunën është kryer ekspertizë në 14 aksidente. Në një prej tyre një persona është lënduar më rëndë, ndërsa në shtatë prej tyre lëndime të lehta trupore kanë marrë 13 persona. Në gjashtë është shkaktuar vetëm dëm material. Të dielën, në Shkup është kryer ekspertizë në 18 aksidente, nga të cilat në një më rëndë është lënduar një person, në shtatë më lehtë janë lënduar 16 persona, ndërsa shtatë aksidente kanë kaluar me dëm material. Gjatë fundjavës, policia ka zbuluar dhe sanksionuar shtatë shoferë të cilët nuk kanë respektuar kufizimet e lëvizjes së automjeteve, 10 shoferë që e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit dhe janë përjashtuar nga komunikacioni, nëntë shoferë të cilët kanë kaluar në dritën e kuqe, një shofer për tejkalim jo të drejtë, si dhe 20 shoferë që e kanë drejtuar automjetin pa leje të qarkullimit ose pa regjistrim. Janë hasur edhe 73 automjete të parkuara në mënyrë të papërshtatshme. Nga MPB-ja informojnë edhe se me ndihmën e automjetit special karrotrec, janë zbuluar 65 automjete.

Vjedhje e rëndë në Tetovë

Tetovë, 9 tetor - Të dielën në periudhën kohore mes orës 18 dhe 21.00, deri më tani persona të panjohur kanë kryer një vjedhje të rëndë në shtëpinë e tetovarit 53-vjeçar me iniciale J.J, e lokalizuar në rrugën "Vëllëzërit Milladinovci" në Tetovë. Në rrethana misterioze, ata kanë hyrë në shtëpi, kanë çkyçur kamerat e sigurisë, të cilat kanë qenë të vendosura në oborrin e shtëpisë, ku më pas brenda hapësirave të brendshme të shtëpisë në tërësi kanë kërkuar dy dhomat e gjumit, ku nga një komodinë kanë marrë 600 euro, 4 mijë denarë, 7 orë dore për femra dhe 10 komplete bizhuterie. Me gjësendet e vjedhura, me siguri përmes derës anësore - hajnat e kanë lëshuar shtëpinë duke përfituar në mënyrë të paligjshme rreth 88 mijë denarë, përderisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet të jetë rreth 2 mijë denarë. Është kryer hetim në vendngjarje dhe po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e plotë të vjedhjes së denoncuar, si dhe zbulimin e autorëve të kësaj vjedhjeje, njofton Policia e Tetovës. Vjedhje është regjistruar edhe në Gostivar, kur persona të panjohur kanë kryer një vjedhje në shtëpinë e 57-vjeçarit nga Gostivari me iniciale F.K e lokalizuar në rrugën "Lllazar LLazarevski" në Gostivar. Ata kanë vjedhur gjësende të ndryshme duke përfituar në mënyrë të paligjshme rreth 60 mijë denarë, përderisa dëmi i shkaktuar material kap vlerën e 3 mijë denarëve. Pas kryerjes së ekspertizës në vendngjarje, po punohet në zbulimin e autorëve të kësaj vjedhjeje.

Operatori i aeroportit tha se edhe më tej do t'i promovojë aeroportin e Shkupit dhe të Ohrit te kompanitë ajrore dhe tur-operatorët, me qëllim të mundësojë destinacione të reja dhe linja të reja ajrore për udhëtarët tanë

"Jugohrom" në mars ose prill fillon me punë!

Shkup, 9 tetor - Fabrika për ferrolegura "Jugohrom" në Jegunoc, e cila u mbyll për shkak të mos-ndërtimit të stacionit filtrues, sipas paralajmërimeve, sërish do të fillojë të punojë në mars ose prill të vitit të ardhshëm. Për këtë qëllim, sot në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë pritet të nënshkruhet marrëveshje me pronarin dhe me sindikatën e fabrikës. Këtë e paralajmëroi kryeministri dhe lider i LSDM-së Zoran Zaev më 5 tetor në tubim në Tetovë, duke theksuar se "Jugohrom"-i sërish do të punojë me kapacitet të plotë dhe sipas standardeve ekologjike. Më 2 nëntor të vitit 2016, "Jugohrom"-i tërësisht e ndërpreu procesin prodhues dhe rreth 800 persona mbetën pa punë. Udhëheqësia e kombinatit vendosi që ta zbatojë vendimin e fabrikës për shkak të mosrespektimit të afatit përfundimtar për ndërtim të stacionit filtrues i cili skadoi më 30 tetor të vitit 2016. Disa herë pastaj të punësuarit në "Jugohrom" protestuan duke kërkuar zgjidhje të problemit të tyre.

Dy aeroportet e TAV-it shënojnë rritje për 6 për qind

Për nëntë muaj, 1.6 milionë udhëtarë

Aeroporti i Shkupit sivjet e kishte gushtin më të qarkullueshëm deri më tani, duke shërbyer 216.409 udhëtarë, me rritje prej 23.7 për qind në qarkullimin e udhëtarëve dhe 22.4 për qind rritje të numrit të fluturimeve, duke arritur numra rekorde në komunikacion deri më tani, që ishte ndihmuar nga ngjarja sportive - UEFA Super kupa

Shkup, 9 tetor - Përmes dy aeroporteve të Maqedonisë Aleksandri i Madh dhe Shën Pali, në nëntë muajt e parë të vitit kanë udhëtuar 1.546.193 udhëtarë, që është për 12 për qind më shumë se në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Siç informojnë nga TAV Maqedoni, dy aeroportet nga janari deri në shtator të këtij viti kanë shërbyer gjithsej 13.752 fluturime, që është rritje për gjashtë për qind në nivel vjetor. Sipas statistikave të TAV për qarkullim të udhëtarëve, në nëntë muajt e parë, destinacioni më frekuent nga aeroporti i Shkupit është Stambolli (12.4 për qind), pastaj vijojnë Cyrihu (8.7 për qind), Vjena (6.8 për qind), Baseli (5.1 për qind), Malme (4.6 për qind) dhe Londra (3.9 për qind). Numër më të madh të udhëtarëve 57.5 për qind ka marrë Uiz er dhe pastaj vijojnë Turkish Erlajns me 8.5 për qind, Austrian Erlajns 6.8 për qind, Gjermania Flut 5.1 për qind dhe Pegasusu Erlajns me 4.5 për qind.

Aeroporti i Shkupit sivjet e kishte gushtin më të qarkullueshëm deri më tani, duke shërbyer 216.409 udhëtarë, me rritje prej 23.7 për qind në qarkullimin e udhëtarëve dhe 22.4 për qind rritje të numrit të fluturimeve, duke arritur numra rekorde në komunikacion deri më tani, që ishte ndihmuar nga ngjarja sportive - UEFA Super kupa. Dita më frekuente në aeroportin e Shkupit ishte 7 gushti kur janë transportuar 8.283 pasagjerë me 98 fluturime. "Rritja e transportit të udhëtarëve vazhdoi edhe në vitin 2017, edhe pse në gjysmën e parë të vitit kishin rritje relativisht më të vogël, por pas vendosjes së katër linjave nga aeroporti i Shkupit dhe fluturimeve të reja sezonale nga aeroporti i Ohrit, në gjysmën e dytë të vitit, sërish kemi vërejtur numra dyshifrorë në rritjen e numrit të udhëtarëve. Presim ta përfundojmë vitin me rritje solide të numrit të përgjithshëm të udhëtarëve", deklaroi Alper Ersoj, drejtor i përgjithshëm i TAV Maqedoni. Si operator i aeroportit TAV Maqedoni, shtoi, edhe më tej do t'i promovojë aeroportin e Shkupit dhe të Ohrit te kompanitë ajrore dhe tur-operatorët, me qëllim të mundësojë destinacione të reja dhe linja të reja ajrore për udhëtarët tanë. Këtë vit nga aeroporti në Shkup janë vendosur pesë destinacione të reja. Në prill filloi të qarkullojë linja e re deri në Budapest, ndërsa gjatë korrikut janë vendosur linjat deri në Romë, Maltë, Vaksjo dhe Doha. Uiz Er e vendosi aviacionin e katërt në bazën e aeroportit të Shkupit, ndërsa kompania ajrore Katar Eruejs, si brend i ri hyri në tregun e Maqedonisë. Në aeroportin në Ohër u vendos destinacioni i ri për Katovice, Poloni.

Kontejnerët nëntokësor "shndërrohen" në deponi mbi tokë!

Shkup, 9 tetor - Kontejnerët nëntokësorë të NP 'Higjiena Komunale', të cilat kohë më parë janë vendosur nëpër disa lokacione të kryeqytetit kanë për qëllim selektimin dhe grumbullimin e mbeturinave nën tokë me qëllim që të mos shpërndahet erë e keqe. Kohën e fundit në shumë lokacione mund të vërehet lloj-lloj mbeturine që grumbullohen përreth tyre. Mbeturinat në vend që të hidhen brenda tyre, i lënë anash, thonë nga NP "Higjiena Komunale". "Ekipet tona çdo ditë i mbledhin mbeturinat nga kontejnerët nëntokësor dhe përreth tyre. Problemi nuk është vetëm tek qytetarët dhe përdorimi i tyre në mënyrë të papërgjegjshme, por edhe tek institucionet dhe firmat që këto pajisje i përdorin gabimisht", thonë nga sektori për marrëdhënie me opinionin i kësaj ndërmarrje. Ndryshe, deri tani nëpër Shkup janë vendosur 118 kontejnerë nëntokësorë në 40 lokacione nëpër Komunën Qendër, Çair, Kisella Vode etj. Në ndërkohë, Asociacioni për menaxhim me rrjedha të veçanta të mbeturinave pranë Odës ekonomike të Maqedonisë ka kërkuar të ngrihet ndërgjegjja publike për selektim të mbeturinave tek popullata dhe angazhim më i madh nga ana e komunave dhe ndërmarrjeve komunale me qëllim që të krijohet sistem i integruar për menaxhim me hedhurina, kërkon, në të cilën tash për tash janë të anëtarësuar dhjetë kompani. Nga Asociacioni, në konferencën për shtyp në Odën ekonomike të Maqedonisë deklaruan se nevojitet përfshirje më e madhe e të gjitha subjekteve juridike në këtë proces me qëllim të që realizohen qëllimet nacionale deri në vitin 2020. "Komunat janë hallkë e rëndësishme në procesin e reciklimit. Besojmë se pas zgjedhjeve lokale me pushtet e reja vendore do të kemi bashkëpunim në pjesën e pjesëmarrjes së tyre në këtë aktivitetin tonë, sepse pa komunat dhe ndërmarrjet publike komunale nuk mund të kemi sistem efikas për grumbullim dhe reciklim të mbeturinave", theksoi Filip Ivanovski, kryetar i Asociacionit. Nga Asociacioni konsiderojnë se nevojitet që të bëhen fushata me të cilën do të ngrihet ndërgjegjja tek popullata, sepse selektimi dhe reciklimi i mbeturinave fillon nga shtëpitë. Një nga qëllimet e Asociacionit të këtij asociacioni të sapoformuar është që në tre vitet e ardhshme të investojnë më shumë mjete në enë për selektim të mbeturinave, sepse rezultatet e një hulumtim i tyre ka treguar se qytetarët dëshirojnë t'i selektojnë mbeturinat nëse ka mundësi dhe mjaftueshëm kontejnerë për këtë qëllim. Nga Asociacioni thonë se nevojitet që të ketë edhe eko-patrulla që do të kryejnë ekspertizë në gjendjen e enëve për selektim të hedhurinave.

Publicitet

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E KUMANOVËS

Sektori për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës

21-1733/19
Të datës 06.10.2017

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 199/14, 44/15, 193/15 ,31/16 dhe 163/16), nenit 50 paragrafi 1 pika 4 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02) dhe nenit 25 paragrafi 1 pika 7 e Statutit të Komunës së Kumanovës ("Fletorja zyrtare e Komunës së Kumanovës" nr. 13/03, 13/07 dhe 8/15), Kryetari i Komunës së Kumanovës në vijim publikon këtë:

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës publike dhe Prezantimit publik në lidhje me

1. Projektin arkitektonik urbanistik për ndërtim të G2 – industria e lehtë dhe jo ndotëse, qëllimi i ndërtimit përpunim dhe konservim të mishit në p. n e formuar nga PK 772/1 dhe PK 769/1 KK Dobërshan – Komuna e Kumanovës, dokumentacion i teknik nr. 95/16 të përpiluar nga NSHPI "PROSTOR" SHPK Kumanovë

Anketa publike dhe Prezantimi publik në lidhje me Propozim PAU-në do të realizohet përmes prezantimit të Propozim PAU-ve në Sirtarët e komunës në Sheshin e qytetit që gjendet tek ish "Tutun" – Kumanovë.

Anketa publike do të **zgjasë 5 ditë pune** duke filluar prej më **16.10.2017 deri më 20.10.2017.**

Për kohëzgjatjen e anketës publike subjektet e interesuara fizike dhe juridike informacione më të detajuara mund të marrin në Komunën e Kumanovës, Sektori për urbanizëm dhe veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës.

Gjatë anketës publike propozimet ose vërejtjet e tyre të gjitha subjektet e interesuara fizike dhe juridike mund ti parashtrojnë në letrat anketuese.

PREZANTIMI PUBLIK

Më **datë 18.10.2017 në ora 12^{00}**, në sallën e mbledhjeve në Komunën e Kumanovës organizohet Prezantim publik me prezantim profesional të Projektit arkitektonik urbanistik për ndërtim të G2 – industria e lehtë dhe jo ndotëse, qëllimi i ndërtimit përpunim dhe konservim të mishit në p. n e formuar nga PK 772/1 dhe PK 769/1 KK Dobërshan – Komuna e Kumanovës, dokumentacion i teknik nr. 95/16 të përpiluar nga NSHPI "PROSTOR" SHPK Kumanovë

Kryetari i Komunës
Zoran Damjanovski

Pas kalimit të kompetencave për të menaxhuar me objektet sportive, Komuna e Tetovës pret që të menaxhojë edhe me objektet e kulturës

Gati edicioni i 11-të i festivalit "Skupi Festival"

Shkup, 9 tetor - Nën moton "Për frymë të shëndoshë" nga 12 e deri 18 tetor do të mbahet Edicioni i 11-të i festivalit ndërkombëtar të teatrove "Skupi" në të cilin do të shfaqen shtatë shfaqje nga Shqipëria, Kosova, Rusia, Izraeli, Serbia, Irani dhe Bullgaria.

Festivali të enjten do të hapet me shfaqjen "Shtëpia e Bernarda Albës" nga Lorka në regji të Qëndrim Rijanit, të Teatrit "Andon Zako Çajupi" nga Korça, Shqipëri. Hapja do të jetë në Suli han në orën 20. Gjatë ditëve të ardhshme festivali do të mbahet në Qendrën Kulturore Rinore ku do të prezantohen shfaqjet: Bisha" e teatrit "U Musta" nga Perm, Rusi; "Martiri" i Teatrit të qytetit nga Gjakova, Kosovë; "Pi duhansi burrë" nga tel-Avivi - monodramë e inspiruar nga jeta e Frida kallos; "Vizione nga shekulli i argjendtë" i Qendrës për dekontaminim kulturor nga Beogradi; "Fol, Medeja" i kompanisë teatrore "Jirjirak" nga Teherani dhe, në ditën e fundit të festivalit - "Shërbëtoret" nga Teatri kombëtar "Ivan Vazov nga Sofja. "Do të përpiqemi ta mbajmë traditën dhe të prezantojmë teatro të cilët nuk i kemi parë deri tani, dhe disa që i dinim, ndërsa mendojmë se është mirë t'i shikojmë, ndërsa që nuk i keni parë në festivalet e tjera. Në këtë kuptim, kemi me të vërtetë se çka t'ju ofrojmë", tha seleksionuesi i festivalit Senko Velinov sot në konferencën për shtyp. Në program, tha ai, nuk vendosin shfaqje nga Maqedonia sepse publiku ato mund t'i shikojë në repertorin e rregullt të teatrove, ndërsa për to, ka edhe festival të posaçëm - FTM "Vojdan Çernodrinski". "Kur shfaqjet nga Maqedonia luajnë në festivale vendore do të thotë alibi. Festivalet plotësojnë hapësirë që t'i arsyetojnë disi edhe kohën, edhe të hollat", tha Velinov. "Këtë vit bëhet edicioni i njëmbëdhjetë i "Skupi Festival"-it, dhe nis me moton "Për shpirt të shëndoshë", ku në këtë edicion do t'ju sjellim shfaqe të ndryshme nga vende të ndryshme të botës, ndryshe nga herët e tjera, ku kemi tetarin nga qyteti i Korçës, kemi tetarin rus 'Në Urë', i cili teatër ka marrë disa çmime në vend, ku edhe njihet si teatër botëror, ndërsa është hera e dytë që ne e kemi prezent. Për herë të parë na vjen teatri i Iranit, pastaj kemi Izraelin, Serbinë, por përfundojmë me teatrin e Bullgarisë, ku vjen me shfaqen 'Shërbëtorët', që është e njohur për publikun tonë", tha koordinatori i festivalit, Osman Ahmeti. Si edhe në edicionet e kaluara, në "Skupi 2017" do të ndahet një çmim - Gran-pri për shfaqje më të mirë, për të cilin do të vendosë juria treanëtarëshe në përbërje të: Vebi Qerimit, Gjorgji Jolevskit dhe Lluka Kortinës. *(D.K)*

Gatishmëri ka, por jo edhe hapa konkret

Institucionet kulturore ende të centralizuara

Përderisa disa komuna kanë marrë nën kompetencë objektet e kulturës Komuna e Tetovës ende pret ndonjë vendim të kësaj ministrie apo qeverisë që të merr kompetencat dhe të menaxhojë me këta objekte

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 9 tetor - Komuna e Tetovës, edhe pse është një nga komunat më të mëdha në vend për nga numri i banorëve dhe territorit që mbulon, megjithatë në sferën e kulturës nuk ka asnjë institucion nën ingerencë të saj. Deri më tani, pothuajse të gjitha komunat më të mëdha në Maqedoninë perëndimore nuk menaxhojnë me institucionet e kulturës, edhe pse disa herë është kërkuar që në këtë sferë komunat janë të gatshme të menaxhojnë pa probleme të theksuara.

Për ministrin e Kulturës, Robert Allagjozovski, kalimi i kompetencave te pushtetet lokale të institucioneve kulturore është edhe në dobi të vet ministrisë së Kulturës, sepse nuk duhet për gjithçka të vendos ministria.

"Qëllimi jonë është që të vazhdojmë me nivelin e dytë të decentralizimit. Ne vlerësojmë se nuk ka nevojë që ministria të jetë përgjegjëse për Qendrën e kulturës në Tetovë dhe jo për Shtëpinë e kulturës në Gostivar, për Shtëpinë në Kavadar dhe jo për në Negotinë. Në këtë kuptim, ne do të inkurajojmë kryetarët e komunave, do të gjejmë mënyrë më adekuate për të financuar që ato institucione të kalojnë në nivel lokal dhe nuk do të rrezikohet funksionimi i tyre dhe frika e të punësuarve se nëse kalojnë nën ingerenca të pushtetit lokal më keq do të menaxhohet, janë të paarsyeshme dhe qëllimi ynë është që ne të përkujdesemi për më pak institucione nacionale dhe gjithçka që mund të merr pushteti lokal atë duhet ta merr nën kompetencë. Me një fjalë, nuk duhet që ministria të vendos për gjithçka në këtë shtet", ka deklaruar ministri i Kulturës, Robert Allagjozovski. Nga fazat e hershme të decentralizimit dhe ndarjes territoriale të vitit 2004, kjo komunë menaxhon vetëm me shkollat fillore dhe ato të mesme, kurse arsimi i lartë, mbrojtja sociale, shëndetësia, kultura ende janë nën kompetencë të pushtetit qendror, kurse edhe në fillim të këtij viti kaluan edhe objektet sportive. Institucionet e kulturës, me siguri do të presin akoma kohë më të mirë që t`i kalojnë në pronësi komunës.

Ndryshe, në Tetovë funksionojnë shumë institucione të kulturës, siç janë biblioteka, Qendra për kulturë, galeria e arteve, disa muze, të cilët ende menaxhohen nga pushteti qendror. Nga komuna e Tetovës janë shprehur se është kërkuar që të gjithë institucionet që janë në kompetencë të pushtetit qendror që janë në Komunën e Tetovës, të kalojnë në menaxhim të pushtetit lokal. "Realisht në qoftë se e keni fjalën për kulturën, duhet ta dini se interes parësor i Komunës është kultura dhe ne kemi dëshmuar kapacitete shumë serioze sa i përket kulturës dhe ajo është pjesë e procedurave të caktuara dhe ne ishim të gatshëm që të bëjmë të gjitha ato procedura që kërkohen me qëllim që të menaxhojmë edhe me këtë sferë të rëndësishme dhe shpresojmë se do të ketë një vullnet të mirë qeveritar për t`i kaluar institucionet e kulturës nëkompetence të pushtetit lokal", kanë thënë nga Komuna e Tetovës.

Pas kalimit të kompetencave për të menaxhuar me objektet sportive, Komuna e Tetovës pret që të menaxhojë edhe me objektet e kulturës. Përderisa disa komuna kanë marrë nën kompetencë objektet e kulturës, Komuna e Tetovës ende pret ndonjë vendim të kësaj ministrie apo qeverisë që të merr kompetencat dhe të menaxhojë me këta objekte. Edhe pse komuna dhe ministria tashmë janë shprehur të gatshëm që të ketë një lloj të transferimit të kompetencave nga pushteti qendror në atë lokal, për institucionet e kulturës megjithatë ky hap ende nuk është ndërmarrë.

Mërgimtarin manastiras nuk e harrojnë gjuhën amtare

Shkollë shqipe në Melburn të Australisë

Me të shkelur dhe vendosjen në tokën e aborixhinëve, më saktë në lagjen Dandenong të Melburnit, krahas punës nëpër uzinat e qytetit, Valeri fillon aktivitetet për hapjen e shkollës së parë plotësuese shqipe, me qëllim pengimin të asimilimit gjuhësor të vogëlushëve të lindur në Melburn

Koha Qenan HASANI

Manastir, 9 tetor - Në vitin 1975, në vlugun më të madh të shpërnguljes së shqiptarëve të Manastirit për në tokën e aborixhinëve, Australi, djaloshi i ri, Valer Selimi braktisi detyrën e arsimtarit të matematikës në Shkollën fillore tetëvjeçare të fshatit Këshavë dhe mori rrugën ndër këmbë për ta shijuar jetën e kurbetçarit. I shkolluar në Prishtinë (shkollën e mesme teknike), i brumosur në frymë patriotike, përcaktime këto që nuk i harroi as në Australi, atje ku nostalgjia për vendlindje dhe atdhe është edhe më e madhe, iu rrek aktiviteteve për të bashkuar kurbetçarët nga Manastiri të vendosur në lagjen Dandenong. Duke vërjetur se këtu shumë shpejtë fillon dhe përhapet procesi i asimilimit, duke harruar gjuhën shqipe, Valeri konstaton se vetëm shkrim leximi ruan gjuhën e bukur shqipe, duke u nisur nga fakti se, një gjuhë që nuk shkruhet e nuk lexohet - harrohet, ai bind bashkëvendësit e tij të hapin një paralele plotësuese në gjuhën shqipe. Pasi që sigurojnë hapësirën dhe inventarin e nevojshëm, nja 50 shqiptarë të vegjël, kryesisht këshavas, fillojnë ta mësojnë alfabetin e vendlindjes, Manastirit. Paralelja mbanë emrin e dikurshëm të shkollës së Këshavës "Emin Duraku". Paralelja procesin edukativ arsimor e zhvillon vetëm të shtunave e të dielave,atëherë kur prindërit janë të lirë dhe mund t'i dërgojnë fëmijët në shkollë. Arsimdashurinë, Valeri, siç shprehet ai vetë, e ka trashëguar nga gjyshi i tij, Rifati. "Gjyshi im ishte arsimdashës i flakët. Më 1945, ai çel shkollën të parë me mësim në gjuhën shqipe në fshatin Këshavë. Në mbrëmjen para fillimit të vitit të ri shkollor, forca politike antishqiptare e kanë djegur objektin e teqesë së fshatit, ku është dashur të mbahet mësimi, duke penguar kështu fillimin e vitit shkollor. Gjyshi im, për hir të fillimit të vitit të parë shkollor, për të parën herë në histori në gjuhën shqipe, ka lëshuar në përdorim shtëpinë e madhe familjare, në të cilën janë vendosur edhe nxënësit, edhe arsimtaret e para që kanë qenë nga Shqipëria. Pas kësaj, gjyshi im ka organizuar banorët e fshatit për të pastruar mbeturinat nga zjarri, për ta ndërtuar objektin e ri prej themeli, objekt ky që shërbeu si shkollë deri në vitin 1995-tën, kur u ndërtua shkolla e re dhe moderne. Unë me hapjen e shkollës së parë në gjuhën shqipe në Australi, e plotësova vetëm amanetin e gjyshit tim", shprehet Valeri.

Paralelja e hapur në Dandenong të Melburnit, edhe pas 42 viteash e vazhdon misionin të vet. Në masë të madhe ka kontribuar në ruajtjen e gjuhës shqipe në këtë kontinent, ku ekzistojnë të gjitha gjasat reale për t'u shuar. "Nuk e pata lehtë që ta realizojë këtë ide dhe veprim obligativ për secilin shqiptar. Ke shkuar si gurbetçar, punon edhe punë plotësuese në të mirë të ruajtjes së identitetit. Të gjithë punonin gjatë të shtunave dhe të dielave, duke fituar dy fish më shumë, unë punoja me fëmijët tanë, me më të dashurit", thotë Valeri me krenari, edhe pse e ka lënë anësh interesin material. Pas nja dy vitesh të kaluara në Australi, Valeri i shtyrë nga nostalgjia për prindërit, për vendlindjen, kthehet në Manastir, me qëllim që të mbetet. Mirëpo, edhe këtu nostalgjia nuk e lë të qetë, tani për nxënësit e paraleles, për bashkëvendësit në Australi. Pasi martohet dhe formon familje, së bashku me bashkëshorten, kthehet në Melburn ku edhe e vazhdon punën me nxënësit shqiptarë. Në kthimin të tij të sërishëm në Melburn në masë të madh ka ndikuar edhe fakti se si i shkolluar në Prishtinë, vazhdimisht ka qenë i përcjellë hap pas hapi. Nuk ka mundur të durojë një jetë nën kontroll, andaj vendos të rikthehet atje ku gëzon të gjitha të drejtat, atje ku sundon demokracia e vërtetë. "Erdha që të mos kthehem më në kurbet, në Australinë të largët, por ndjekja si shkollar i Prishtinës, trajtimi im nga organet e sigurimit si nacionalist e separatistë, ishte e pamundur të durohen, andaj pasi u martova, vendosa ta vazhdoj jetën e mërgimtarit, në vend të huaj", thotë Valeri.

Dy vite më parë, bashkia e njohu atë zyrtarisht si një artist rruge dhe prej një viti ai punon pranë departamentit të dekorimit. Gjatë kësaj kohe ai ka mundur të pikturojë disa nga veprat më të thella të tij si pjesë e planit të bashkisë për ta bërë qytetin më tërheqës

Artisti i rrugës

Franko Dine po i ndryshon faqen Tiranës

Franko Dine, artisti që ka mbuluar muret e kryeqytetit me grafiti që përcjellin mesazhe të ndryshme, tha për BIRN se synimi i tij është të hapë një rrugë edhe për të tjerët që duan të bëjnë grafiti.

Fatjona MEJDINI

Franko Dine, një 24-vjeçar nga Vlora, nuk e besonte kurrë që një ditë grafitit e tij do të mbulonin ndërtesa kyçe në kryeqytet, përpara syve të miliona personave. Artisti i rrugës ka punuar fort për t'ia dalë në një vend ku grafiti nëpër mure zor se kuptohet si art dhe thuajse nuk ka traditë të ekzistencës. Ai është tani një nga të parët artistë të punësuar nga bashkia e Tiranës dhe zyrtarisht i lejuar të pikturojë muret e qytetit, duke hapur një rrugë për praktikën e mirënjohur botërore të artit urban që të lulëzojë edhe në Shqipëri. Franko e zbuloi këtë rrugë instinktivisht. Ai ka qenë përherë i mirë në vizatime, la pas letrën dhe filloi të pikturonte muret e shtëpisë së tij kur ishte 16 vjeç dhe pa disa grafiti në internet për herë të parë.

"Nuk isha i sigurt se çfarë po bëja por pikturimi i mureve u bë një fiksim. Prindërit ishin të befasuar, dhe jo vetëm që më lanë të vizatoja në mure, por më liruan të gjithë dhomën që të mund të shprehesha lirshëm," tha ai për BIRN. Pasi gjeti një emër për pasionin e tij, ai vendosi të studiojë në Akademinë e Arteve në Tiranë ku mësoi më shumë për artin e grafitit të mureve.

"Por shpejt e kuptova që kjo ishte e pamundur… grafiti në mure nuk ishte lëndë në Akademi, ndaj vendosa të studioj dizajn," kujton ai.

Ndërkohë, ai filloi t'i kërkonte miqve që jetonin jashtë t'i blinin libra për të përmirësuar teknikën e tij dhe për t'i dërguar edhe mjetet e nevojshme që nuk mund të gjendeshin në Tiranë.

"Ishte e vështirë sepse po praktikohesha duke përdorur materiale ndërtimi në vend të bojërave profesionale që përdoren në botë për grafiti. Ato janë shumë të rrezikshme për shëndetin ngaqë përmbajnë shumë kimikate," kujton Franko. Sot ndërsa beson se studimi në Akademi nuk e ndihmoi shumë në aspektin e pasionit të tij të vërtetë, zhvendosja në Tiranë ia vlejti barra qiranë.

Ai njohu qytetin kur shumica e banorëve ishin në gjumë.

"Gjatë vitit të parë, dilja nga dhoma në orën 1 të natës për të lëvizur nëpër qytet për disa orë që ta njihja," tha ai.

"Eksplorova cepat më të errët të qytetit, fasadat më të rrënuara dhe caktova ato mure që mund të vizatoja," shtoi ai.

Në Tiranë, ai gjithashtu gjeti vendin e vet, që ishte puna me fëmijë të pambrojtur, – jetimë, të varfër, me nevoja të veçanta dhe të përjashtuar.

"Shihja sa shumë lypnin në rrugët e Tiranës dhe ndjeva se mund ta përdor artin tim për të protestuar në emër të tyre," tha ai.

Një nga grafitit e tij më të rëndësishëm në muret e qytetit u bë në mars, ditë kur në Shqipëri festohet dita e nënave dhe mësuesve.

"Vizatova një fëmijë me rroba të leckosura, që mbante në dorë një lule pa pasur askënd kujt t'ia jepte," kujton ai.

Ajo që ai bënte netëve në rrugët e qytetit nuk është më e paligjshme, megjithatë.

Franko kujton "aventurat" e pafundve kur në përpjekje për të vizatuar një mur, përfundonte duke u përballur me pronarë të zemëruar ndërtesash, policinë dhe madje edhe tufa qensh rruge.

"Por gjeta aleatë të mirë mes të pastrehëve," tha ai.

"Krijova shoqëri të mirë me ta dhe i kërkoja të mos mi shkatërronin grafitit. Në fund të fundit, janë ata që e 'sundojnë' qytetit natën", thekson ai.

Këta "njerëz të natës" jo vetëm e ndihmuan të punonte i pashqetësuar, por i mbrojtën grafitit e tij nga të tjerët që mund të donin t'i shkatërronin.

"Por për të hapur artin e tij në shkallë të gjerë, ai kishte nevojë për aleatë më të fuqishëm.

"Doja të kisha në krah bashkinë e Tiranë dhe u përpoqa fort për t'iu qasur atyre dhe për t'i prezantuar me artin tim. Por shpejt kuptova se ata kishin nevojë për mua dhe fuqinë e artit urban gjithashtu," kujton Franko.

Dy vite më parë, bashkia e njohu atë zyrtarisht si një artist rruge dhe prej një viti ai punon pranë departamentit të dekorimit. Gjatë kësaj kohe ai ka mundur të pikturojë disa nga veprat më të thella të tij si pjesë e planit të bashkisë për ta bërë qytetin më tërheqës.

"Jam shumë i lumtur që kam Vëllain e Madh [bashkinë] në anën time. Pres projekte të tjera," shtoi ai.

"Ëndrra ime është të vizatoj një grafiti sa më të madh të jetë e mundur. Do të doja shumë të bëja dizenjo të mëdha sa 10 kate – ose edhe më shumë," tha ai për BIRN.

Franko synon të bëhet një frymëzim për të rinjtë që të çojnë përpara këtë rrugë që ai po ndjek, duke theksuar gjithsesi se pavarësisht suksesit të tij, Shqipëria mbetet një vend ku kultura e grafitit është në fazë shumë të hershme.

"Kemi shumë për të bërë," tha ai. "Tirana ka ende shumë mure të zbrazëta," përfundoi ai. *(birn)*

Dashnorja e Ahmet Zogut që vrau burrin e saj?

Luksi dhe jeta franceze e spiunes më të bukur shqiptare

Sara u martua në një moshë fare të re me ushtarakun Selahedin Blloshmi, i cili kishte kryer Akademinë Ushtarake franceze të Sent Sirit. Martesa u dha një vajzë, Verën (1923- 1998), e cila më vonë do njihej për artin e bukur të saj, pikturën

Bukuria e saj ngeli gjatë në mendjen e shqiptarëve, aq sa emri i Sara Blloshmit nuk u harrua kurrë. Ajo vlerësohej se ishte femra më e bukur shqiptare në kohën e Ahmet Zogut. Përtej hireve të një femre joshëse e të bukur, thuhet se ka qenë kërcimtare shumë e mirë. Ajo ishte një ëndërr për meshkujt shqiptarë. Emri i saj nuk u përmend vetëm për bukurinë që kishte, por ajo përflitej edhe agjente të të gjitha shërbimeve sekrete të kohës së Zogut. Sara Blloshmi ishte mbesa e Ismail Qemalit (vajza e vajzës së tij). Disa zëra thonë që Sara ka qënë e dashura e Ahmet Zogut. Medje thonë se Zogu fjeti me Sarën një ditë përpara se të martohej me mbretëreshën Geraldinë. Sara shquhej edhe jetën e saj luksoze që bënte. Thuhet se ajo kishte një veshje moderne evropiane dhe parfumi i vinte nga Parisi.

Prej librit "Agjenti 333" i Dhimitër Karagunit, botuar nga shtëpia botuese "Naim Frashëri" më 1970-n, lexojmë se Mithat Frashëri ka qenë një tjetër lëvdues i heshtur i hireve të saj. Por vargu nuk mbaron me kaq… gjithnjë referuar librit dhe thashethemnajave që enden sot, kur në tavolina bie fjala për të, ziejnë sa e sa qeveritarë të kohës janë përkundur nën ojnat e Blloshmit.

Sara ka lindur në Stamboll, në vitin 1904. Ajo ishte fëmija i tretë i kolonelit Vehab bej Serdar, djalë i gjeneralit të famshëm Abdul Kerim Pasha, dhe i Mevedet H. Vlorës, vajzës së madhe të Ismail Qemalit. Pas Shpalljes së Pavarësisë, pasi kishte kaluar fëmijërinë në Stamboll, Sara u vendos bashkë me familjen në Francë e më pas në Shqipëri.

Sara u martua në një moshë fare të re me ushtarakun Selahedin Blloshmi, i cili kishte kryer Akademinë Ushtarake franceze të Sent Sirit. Martesa u dha një vajzë, Verën (1923- 1998), e cila më vonë do njihej për artin e bukur të saj, pikturën. Për një kohë të gjatë Sara jetoi në Bukuresht, ku Selahedin ishte ambasador i Shqipërisë, e më pas u kthyen në Tiranë. Sara, pas vdekjes së Selahedin Blloshmit, u njoh me ushtarakun anglez Vandeleur Robinson, i cili ishte atashe shtypi në misionin britanik në Shqipëri, me të cilin u martua më 1945.

Përflitej se kjo martesë u bë për arsye interesi, me qëllim për t'u larguar nga Shqipëria. 'Panorama' në një shkim thekson se edhe vdekja e të shoqit nuk kaloi fare në heshtje. Zëra të kohës thonë se Sara ishte përgjegjëse direkte për vdekjen e të shoqit, sado që asgjë e këtillë nuk u vërtetua ndonjëherë. Sidoqoftë, jeta e saj përfundoi larg Shqipërisë, me Robinsonin, sado kontraktuale që të ketë nisur martesa e tyre. Madje, edhe pas vdekjes së saj, për bashkëshortin e saj të fundit u kujdes e bija, piktorja Vera Blloshmi.

Ekspozitë

Lala Meredith-Vula, kujtesë gjaku nga atdheu

Një ekspozitë personale e Lala Meredith-Vulës, nën titullin "Urtësi sot e mot", që bart këta dy projekte, çelet në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi" në Shkodër më 20 tetor 2017

Fatmira NIKOLLI

Pajtimi i gjaqeve ka qenë për të një prej përvojave të paharrueshme në jetë. Kishte, sipas Lala Meredith-Vulës, një ndjenjë kolektive shprese - se në rrethana shtypëse, ne, së paku kemi njëri-tjetrin. Kishte njëherësh një farë përshtypjeje se po krijohej historia dhe se secili po merrte pjesë në një moment madhështor, "si të ishte, ma merr mendja, momenti kur Ismail Qemali para grumbullit të njerëzve e shpalli pavarësinë". Ka qenë për artisten moment vërtet frymëzues. Në një rrëfim në "Kosovo 2.0", artistja me baba shqiptar e nënë angleze, kujton rininë e largët ku nisi dokumentimin në imazhe të pajtimit të gjaqeve disavjeçare, herë-herë shekullorë në Kosovë, kur ende ishte gjallë e i qe kushtuar këtij "pajtimi kombëtar" Andon Çeta. Atëkohë, e re dhe pothuaj "e huaj" sa i takon njohjes së traditave shqiptare, ajo e ndiqte çdo gjë me kureshtjen e një të sapoardhuri. "Procesi i pajtimit të gjaqeve, niste me identifikimin e hasmërive të llojllojshme brenda fshatit dhe pastaj grupi lokal i pajtimit shkonte dhe i vizitonte familjet e përfshira në përpjekje për t'i pajtuar gjaqet. Caktohej data dhe dy familjet takoheshin në ceremoninë publike të pajtimit. Në këto ceremoni kishte lexime, dhe aty merrnin pjesë Anton Çeta dhe profesorë e personalitete të tjera të respektuara. Pastaj një nga një, familjet e ndryshme dilnin përpara dhe përqafoheshin apo i shtrëngonin duart derisa të pranishmit duartrokisnin", - ka kujtuar ajo në "Kosovo 2.0". Ato imazhe më vonë u bënë pjesë e projektit të saj Blood Memory (Kujtesë Gjaku).

Një tjetër projekt me të cilin ajo është shfaqur në disa ekspozita është ai i mullarëve të barit nëpër fshatra, "Haystacks". Për të, mullarët dukeshin si pikë e mrekullueshme qendrore e peizazhit. "Përfaqësonin aq shumë: bëhen nga njeriu, mirëpo janë me material të natyrës. Janë ushqim themelor për kafshët, rezervë për dimër. Më bëjnë të mendoj për vargun biblik - 'i gjithë mishi është bar' - që na përkujton se duhet t'i çmojmë jetët tona dhe t'i vendosim gjërat në perspektivë, të përqendrohemi në çështjet e rëndësishme të jetës sa jemi gjallë. Ka shumë lidhje, anekdota dhe frazeologji që kanë të bëjnë me mullarë edhe në shqip edhe



në anglisht, e kjo është vetëm njëra prej tyre", - ka sqaruar ajo.

Urtësi sot e mot

Një ekspozitë personale e Lala Meredith-Vulës, nën titullin "Urtësi sot e mot", që bart këta dy projekte, çelet në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi" në Shkodër më 20 tetor 2017. E kuruar nga Monika Szewczyk, një ndër më të mirat sot në fushën e artit bashkëkohor, një njoftim i "Marubit" shënon se fjalët që karakterizojnë ekspozitën e Lala Meredith-Vula në Muzeun Marubi në Shkodër i gjejmë të shkruara mbi një pankartë, në njërën nga fotografitë që artistja shqiptaro-angleze shkrepi në Vranjevc të Prishtinës, më 4 maj 1990. Ato shprehin parimet që udhëheqin një transformim historik delikat brenda një komuniteti. Këto fjalë duket sikur përkojnë me të gjithë punën artistike të Meredith-Vula- e cila na paraqitet në të njëjtën kohë imediate dhe e çdokohshme, duke u integruar me proceset e ngadalshme që kërkojnë një shoqëri të gatshme për të pranuar një ndryshim të tillë si dhe bashkëveprim me tokën, duke përfshirë këtu edhe materialet natyrore që ajo ofron. Në gusht 1988, katër ditë pas instalimit të ekspozitës së famshme, Freeze me studentët e artit të Goldsmith, Lala Meredith-Vula la Londrën (qytet ku ishte vendosur në moshën katërvjeçare pas ikjes nga Sarajeva) për të shkuar në fshatrat kosovare, ku ajo filloi të fotografonte mullarët. Në këto forma agrare, ajo kishte gjetur "thelbin e veprës së artit". E nëse dëshironte të rilidhej me atdheun e saj, një dëshirë e tillë abstrakte duhej të rrënjosej diku thellë në tokë, ashtu si vetë mullarët. Pas tri dekadash dhe qindra fotografish, projekti vazhdon akoma. Por roli i Meredith-Vula si dëshmitare u transformua kur në vitin 1990, ajo mësoi mbi planet e pajtimit të gjaqeve në rajonin ku kishte fotografuar mullarët. Duke vënë mënjanë për pak kohë magjepsjen nga skulpturat rurale, ajo e orientoi objektivin e saj drejt qindra njerëzve që grumbulloheshin nën drejtimin e folkloristit dhe studiuesit Anton Çeta (1920-1995), për të përmbyllur në mënyrë ceremoniale, gjakmarrje që kishin vazhduar për shekuj të tërë, duke paralizuar kështu edhe komunitetet.

Dy seritë më përfaqësuese të Lala Meredith-Vula - Haystacks (Mullarët) dhe Blood Memory (Kujtesë Gjaku)- janë sjellë për të ndërvepruar me hapësirën e Muzeut Marubi. Përzgjedhje fotografish nga këto dy punë janë ekspozuar në Athinë dhe Kassel, në kuadër të ekspozitës ndërkombëtare "documenta 14". Megjithatë, ekspozita që po ju paraqesim, përbën një rast unikal për t'i parë të dyja seritë të ekspozuara së bashku. Përtej tyre, një imazh historik - ai i fotografisë së Kel Marubit në ceremoninë e ngritjes së flamurit në Kalanë e Shkodrës më 19 mars 1914, pjesë e ekspozitës "Rroftë!", kuruar nga Blerta Hoçia - është përfshirë këtu për të hapur një dialog mes imazheve unike të Meredith-Vula me trashëgiminë e pasur të dinastisë Marubi si dhe me historikun e ekspozitës të këtij muzeu, të themeluar në nderim të tyre. Bashkëbisedimet e hapura janë shumë të rëndësishme për artin dhe për ndërtimin e ekspozitave. Edi Hila, piktori i mirënjohur shqiptar komenton: "Lala ndërton një dialog me secilin nga mullarët. Ata personifikojnë atë çfarë Lala ka parë dhe ç'ka i kanë thënë asaj." Ndërkohë, pjesëmarrja e Meredith-Vula në "documenta 14" si dhe ekspozita e saj në Muzeun Marubi u mundësua falë Erzen Shkollollit, i cili në rolin e tij si këshilltar kuratorial në "documenta 14" ishte i pari që ia prezantoi punën e fotografes, ekipit të kuratorëve të "documenta 14".

Mbi artisten

Lala Meredith-Vula ka lindur në Sarajevë në 1966 nga një baba kosovar dhe një nënë angleze. Në vitet '70 u zhvendos në Britaninë e Madhe. Studioi Artet e Bukura në "Goldsmiths' College" pranë Universitetit të Londrës (1985/88). Ekspozita e saj e parë u organizua në kuadër të ekspozitës "Freeze" të artistit të mirënjohur britanik Damien Hirst (Londër 1988), ekspozitë e famshme kjo për lançimin e artistëve të rinj britanikë. Ajo ka përfaqësuar Shqipërinë në Bienalen e 48-të të Venecias në vitin 1999. Ka punuar për shumë ekspozita vetjake, përfshirë këtu Photographers' Gallery, Londër si dhe ekspozita të tjera në Gjermani, Itali e Shqipëri.

Meredith-Vula ka marrë pjesë edhe në ekspozita në grup në Britaninë e Madhe, SHBA, Kinë dhe vende të tjera europiane. Në vitin 2016 ka qenë një ndër kandidatet e përzgjedhura për Deutsche Börse Foundation Photography Prize 2016 për ekspozitën e saj "Kujtesë gjaku" në Galerinë e Arteve të Kosovës. Në vitin 2017 punët e saj u përzgjodhën për "documenta 14" në Athinë dhe Kassel.

(gazeta shqiptare)

Triumfi i Andriqit dhe mohimi i Kadaresë

Udhërrëfyesi i gjithë shkrimtarëve që krijuan në epokën e kampit komunist, mbetet shkrimtari i madh rus, disidenti Aleksandar Solzhenjicin. Ky i fundit fitoi Nobelin për letërsi në vitin 1970, derisa kundërshtonte zemrën e perandorisë komuniste dhe gjithë jetën e kaloi në kampin më mizor të botës në Gulagun siberian

Bajram MJEKU

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, u spekulua shumë se sponsor i Andriqit për Nobelin ishte shefi i Jugosllavisë komuniste, Josip Broz Tito. Në fakt, raportet e Josip Brozit me Andriqin ishin të ngrira për bindje politike. I pari komunist, i dyti monarkist me prirje shoviniste. Ky i fundit, Josip Brozin e injoroi deri në përbuzje, përkundër fuqisë politike që kishte shefi i Jugosllavisë komuniste gjatë 35 vjetëve të sundimit të tij.

Josip Broz u përkushtua që për Nobelin të promovonte një shkrimtar tjetër, mikun e tij Mirosllav Kërlezha. Synimi i tij nuk u realizua kurrë. E kundërta e Andriqit, kroati Kërlezha shkroi në mënyrë afirmative për shqiptarët dhe i vlerësoi jashtëzakonisht mirë. Gjatë dy viteve sa kam jetuar në Oslo, nuk kam mundur të kuptoj miqësinë e madhe serbe me shtetet skandinave, në veçanti me Mbretërinë norvegjeze. Një mbrëmje dhjetori të vitit 2000, isha mysafir i dramaturgut norvegjez, Erling Kittelsen. Oslo, në prag të ndërrimit të mileniumeve dhe festave të Krishtlindjeve ishte dekoruar aq bukur, sa gjithë jetën do t'më ndjell magjia e saj. Dramaturgu Kittelsen gjatë bisedës thoshte se gjithë ajo që dinte për letërsinë shqiptare ishte shkrimtari Ismail Kadare, pasi kishte lexuar disa nga romanet e tij. Derisa shëtisnim, u gjendëm përballë godinës së mrekullueshme Nobel Peace Center. Ishte rast i mirë të flitnim për Andriqin dhe çmimin prestigjioz, të cilit i ishte ndarë tre vjet para se të lindja unë. Siç asnjëherë nuk mora përgjigje për miqësinë serbe me popujt skandinavë, nuk mora përgjigje as për Andriqin dhe Çmimin Nobel për letërsi që iu dha atij.

Kur Evropa në gjysmën e dytë të shekullit njëzet shquhej për të drejta e liri njerëzore, projektuesi i elaboratit për zhdukjen e shqiptarëve u laurua me Nobel. Ndodhi në dhjetor të vitit 1961, kur në Pallatin e Akademisë suedeze në Stokholm, Ivo Andriqit, Nobelin për letërsi ia dorëzoi anëtari i Akademisë suedeze, dr. Anders Esterling. Edhe në pesë dimrat e ardhshëm, bashkëkombësi i tij, ministri famëkeq i Punëve të Brendshme në Federatën jugosllave Aleksandar Rankoviq, vriste e torturonte mijëra shqiptarë në Kosovë sipas elaborateve të Andriqit. Komiteti i Nobelit, shpalli dje mbasdite laureatin e ri të Çmimit për Letërsi, shkrimtarin britanik Kazuo Ishiguro. Kumtesa e shkurtër e Akademisë thotë: "Çmimi Nobel për Letërsi për vitin 2017 i jepet autorit anglez Kazuo Ishiguro, i cili te romanet me fuqi të madhe emocionale, ka zbuluar honin nën ndjesinë tonë iluzore të lidhjes me botën".

Kriticizmi jashtëletrar dhe Kadare

Mentor NAZARKO

Kadare shkëlqen edhe në mosmarrjen e çmimit prestigjioz, edhe për faktin se ai është i vetmi që nga viti 1975 që konsiderohet nga juria e Nobelit si një nga mëtuesit kryesorë

Tani kur shkuan huq të gjitha bastet e atyre që parashikonin se Kadare do të rrëmbente Çmimin Nobel për letërsi, ky, sidoqoftë, paraqet një rast të mirë për të reflektuar me thjerrëz introspektive për figurën e tij dhe kontributin në kulturën kombëtare. Kadare shkëlqen edhe në mosmarrjen e çmimit prestigjioz, edhe për faktin se ai është i vetmi që nga viti 1975 që konsiderohet nga juria e Nobelit si një nga mëtuesit kryesorë. Në një bisedë të paradokohshme telefonike që kisha me Kadaranë në lidhje me disa diatriba që i bëheshin atij për 'flirtin' me diktaturën, unë i thashë atij se duhet të ndihet mirë nga fakti që kritiku i tij më i madh është Fatos Lubonja. Ky i fundit është dikush që në jetën e vet ka treguar integritet të lartë moral, duke rrezikuar jetën e vet në burg, i cili me të gjitha dritëhijet dhe konfliktualitetin e tij me politikën vazhdon të jetë një figurë e respektueshme në agorën tonë publike. Në bisedë e sipër i thashë Kadaresë se për shkak të përmasës së tij ndërkombëtare, një kritik i brendshëm, që ka këtë gëzof publik si Lubonja, vetëm sa i bën nder përmasës së tij. Ai u përgjigj se problemi kryesor ishte se kritikët e tij merreshin me shpifje, duke e shembulluar këtë me një keqinterpretim të fjalëve të tij për kulturën dhe gjuhën serbe.

Shkrimtari gjirokastrit më pati shpjeguar në intervistë se asnjëherë nuk ka thënë se serbishtja është gjuhë jevge, por kishte cituar dikë tjetër që e konsideronte gjuhën serbe si të tillë. Ky, sipas Kadaresë, ishte një nga shembujt se si shpifin detraktorët e tij. Por cila është hisja e kriticizmit shqiptar në mosmarrjen e Çmimit Nobel? Ka marrë përmasën e një besëtytnie bindja jonë shqiptarocentrike se gjithçka thuhet e shkruhet për Kadarenë në Shqipëri do të ndikojë në formësimin e mendimit të atyre që japin Çmimin Nobel për Letërsi. Prej kohësh ka bërë vend një farë paranoje se sapo avitet koha e ndarjes së çmimit të madh për letërsi, një kritikë shumëzërëshe në Shqipëri dhe jashtë saj ngre për një oktavë më shumë tonet kundër Kadaresë për të treguar se ky njeri, për shkak të 'flirtit' me diktaturën, nuk e meriton një çmim të tillë. Unë nuk mund të jap një gjykim mbi rëndësinë e zërave të tillë jashtëletrarë në verdiktin e jurisë së Nobelit, por e them me siguri se ndarja e këtij çmimi nuk duhet të personalizohet si nderim për Kadarenë, por si një e mirë kombëtare, një kontribut i paçmueshëm për imazhin e shqiptarëve në botë.

Konsiderata ime e dytë është se Kadareja, ashtu siç e ka pohuar edhe vetë, nuk ka qenë disident. Kjo ka qenë një mënyrë elegante që ai të shmangë intensistetin e kriticizmit për raportet e tij me diktaturën. Sipas meje, Kadareja bën deri diku modestin kur thotë që nuk ishte disident. E vërteta është që ai me veprën e tij

Shpresa jonë më e mirë kundër luftës bërthamore

David IGNATIUS

ekspertët ligjorë argumentojnë se Mattis do të duhej të ndiqte urdhrat e komandantit të tij në krye. Kështu funksionon sistemi ynë. Nëse përpjekjet e Mattisit për të bindur presidentin do të dështonin, ai mund të jepte dorëheqjen. Por nëse ai qëndronte në detyrë dhe refuzonte një urdhër ligjor të ligjshëm, ai mund t'u shkarkohet

Mendoni atë që është për momentin vetëm një pyetje krejtësisht hipotetike: Çfarë mund të bëjë sekretari i Mbrojtjes, Jim Mattis nëse ai merr një urdhër nga Presidenti Trump për të nisur një sulm bërthamor mbi Korenë e Veriut për hakmarrje, për shembull, për një provë me bombë me hidrogjen që kishte shkuar keq? Siguristht, Mattis mund të përpiqet të bind presidentin të anulojë sulmin, nëse ai mendon se ky veprim është i pamatur. Ai mund të kërkonte kohë për t'u përgatitur për rastet e paparashikuara ose për të mbledhur informacione. Ai mundet, madje, të argumentojë se ky veprim ka pasoja ligjore, sepse mund të shkaktojë viktima joproporcionale civile në Korenë Veriore dhe Jugore dhe në këtë mënyrë të shkelen ligjet e luftës. Megjithatë, në fund, ekspertët ligjorë argumentojnë se Mattis do të duhej të ndiqte urdhrat e komandantit të tij në krye. Kështu funksionon sistemi ynë. Nëse përpjekjet e Mattisit për të bindur presidentin do të dështonin, ai mund të jepte dorëheqjen. Por nëse ai qëndronte në detyrë dhe refuzonte një urdhër të ligjshëm, ai mund t'u shkarkohet.

"Pikëpamja e presidentit, dhe çfarëdo urdhrash rrjedhin nga ajo pikëpamje, vendosin fatin e gjërave," shkroi Jack Goldsmith, një profesor i Universitetit të Harvardit dhe një autoritet i respektuar gjerësisht mbi ligjin e sigurisë kombëtare, në një postim të fundit në blogun e Lawfare. (Studentja e drejtësisë së Harvardit Sarah Grant, bashkë-shkroi postimin). Por, shikoni më nga afër nëse shqetësoheni se vendimet impulsive të Trump mund të çojnë anijen e shtetit drejt shkëmbinjve. Hulumtimi zbulon disa raste interesante kur një tjetër president i çrregullt, Richard Nixon, u kontrollua nga vartësit e tij.

Le të fillojmë me një konfrontim pak të njohur që përfshin, përsëri, Korenë e Veriut. Më 14 prill 1969, luftëtarët e Koresë së Veriut hodhën poshtë një aeroplan të zbulimit të marinës EC-

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 9 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

ka staturën e një disidenti të madh. Le ta sqaroj këtë me një shembull nga jeta ime: Diku kah viti 1983 po bashkëbisedoja me një shok timin të gjimnazit, babai i të cilit ishte sekretar partie në një shkollë të mesme. Në bisedë e sipër, ai më tha se 'Kadareja është shkrimtar armik'. Imagjinojeni këto fjalë të thëna nga goja e një 17-vjeçari! Ky, në të vërtetë, nuk ishte reflektim i pafajshëm i një të riu, por një jehonë kumbuese e atyre që dëgjonte të fliteshin në shtëpinë e tij. Vepra e Kadaresë ishte nxitëse e disidencës dhe mendimit ndryshe. Ky shembull tregon se edhe brenda familjeve të kuadrove komuniste, vepra e Kadaresë shihej si jashtë mendimit mbizotërues. Ka pasur shumë njerëz që janë frymëzuar për oponencën e tyre ndaj regjimit pikërisht nga opusi shkrimtaresk i Kadaresë. Në gjithnajën e kësaj galerie personazhesh që vinin nga e ashtuquajtura botë borgjeze dhe mikroborgjeze që ishte përmbysur, spikaste ajo që Kadare e kishte quajtur si humbje e sensit, meqë ata pritën për 50 vite rravgimin e një zbarkimi anglo-amerikan në Shqipëri.

Kjo humbje e sensit të realitetit ishte vetë ana groteske e tyre. Ky është një moment për të thënë se Kadare me gjenialitetin e tij ka ofruar personazhe dhe mendim që kishin natyrë sferike, me gjuhë të kuptueshme dhe rezistente ndaj dhëmbit të kohës. Dhe ky ishte gjenialiteti kadarean: një vepër që kapërcen kufijtë e Shqipërisë dhe lartëson kombin e tij. Është e pamohueshme që një shkrimtar i tillë në ecajaket e tij mund të ketë pasur edhe kompromiset e detyruara, ashtu siç ka pasur raste të shumta me shkrimtarë të tjerë përballë regjimesh e diktaturash. Kadare kritikohet për glorifikimin e figurave të komunizmit, si fjala bie, shëmbëllesa e Enver Hoxhës te 'Dimri i Madh'. Ky lartësim, që bënte që sedra e regjimit të ndihej e mikluar, mund të ketë përcaktuar fatin e Kadaresë. Por ky është një lexim së prapthi i dikujt si Enveri, i cili prej vitit 1961 nuk e pa më me sy Perëndimin dhe botën. Në paranojën e tij, ai nuk e kuptonte se prishja me sovjetikët se ç'kishte edhe një anë mosmirënjohjeje fodulle: fundja, Bashkimi Sovjetik kishte ndikuar vendimtarisht në paprekshmërinë e kufijve shqiptarë dhe integritetit territorial të Shqipërisë. Ajo ishte një aventurë rrezikzezë, jo për të mbrojtur sovranitetin shqiptar sikundër thonë apologjetët e regjimit, por për të ruajtur pushtetin personal. Në këtë kuptim, Enveri i Ismail Kadaresë nuk është ai sikundër përjetohej nga ideologët e regjimit, por një njeri qesharak që i shkërbente një personazhi tjetër të Kadaresë, Belul Gjonomadhi, ku përmes ca vargjeve labe endej parodia për absurdin shqiptar: "O Behlul, o trim i marrë/ zure inat me radarë".

Kadare me veprën e tij ka ngritur dyshime për soliditetin e shoqërisë komuniste. Në gjykimin tim, sado që letra e tij drejtuar Enverit përdoret për të trashur dosjen kundër Kadaresë, ajo flet saktësisht për të kundërtën: fakti që Kadare nuk e kishte të sigurt pozicionin e tij në një balet të rrezikshëm mbi akull. Në këtë kuptim, përpjekjet për ta paraqitur Kadarenë si pjesë organike të pushtetit komunist janë një lloj letërsie politike që nuk ka të bëjë aspak me të vërtetën. Me këtë nuk po them që ai ishte një figurë puritane, por që vepra e tij është më e madhe sesa vetë ai, një yshtëse e përjetshme e disidencës. Ata që e njohin Kadarenë dhe veprat e tij e dinë se kritika jokorrekte ka pasur edhe për kinezët te romani 'Koncert në fund të dimrit', apo edhe te një personazh tjetër që ironizonte me homoseksualët apo hebrenjtë. Ne nuk e dimë se cili ishte mekanizmi analitik në gjykimin e anëtarëve të Nobelit, por dhënia e këtij çmimi në të ardhmen do të përbënte një të mirë të madhe për kulturën dhe letërsinë shqiptare. Kadare, në një mënyrë ose tjetrën, e ka sakrifikuar marrjen e Çmimit Nobel në favor të kombit të tij.

Përfshirja e tij në polemika të dendura me shkrimtarë serbë gjatë konfliktit në Kosovë, është bërë vetëdijshëm edhe me riskun e 'cenimit' të imazhit si shkrimtar ndërkombëtar. Por Kadare zgjodhi në mënyrë 'shqiptarocentrike' që të bëhet kalorës i kauzës kombëtare, më parë sesa të merrej me grumbullimin e pikëve të korrektesës politike për çmimin të madh. Përtej faktit se ka një mobilizim të qëllimshëm të kritikëve të tij apo elozheve të dashamirëve të tij, duhet thënë që ky mobilizim është irracional dhe letërësi politike. Le ta marrim si shembull Fatos Lubonjën. Ai nuk fiton në pikëpamje të reputacionit të tij nëse vazhdon me diskursin antikadarean, sepse kjo edhe i ka sjellë plasaritje jo të vogël imazhit të tij. Pa asnjë prapamendim për të shkuptimësuar kritikën e mirëfilltë antikadareane, primadona e stihisë kundër Kadaresë është si një liliput mbi shpinën e një elefanti. Në madhësinë e tij, Kadare mund t'i ketë cenet e tij, por edhe liliputët në vogëlsinë e tyre spikasin shpesh edhe me dashakeqësinë dhe mërinë morbide... *(konica)*

---

121 mbi ujërat ndërkombëtare, duke vrarë të gjithë 31 anëtarët e ekuipazhit. Nixon donte të hakmerret ushtarakisht, ashtu siç edhe këshilltari i tij i sigurisë kombëtare, Henry Kissinger. Por Sekretari i Mbrojtjes Melvin Laird ishte i kujdesshëm, duke pasur frikë se Shtetet e Bashkuara nuk ishin gati për pasojat që mund të vinin. Pra, Laird ngadalësoi procesin. Ai vonoi veprimin. Ai paraqiti studime. Ai ndaloi fluturimet e mbikëqyrjes shtesë të nevojshme për të mbledhur informacione para një sulmi. Duke cituar një studim të logjistikës të Pentagonit, ai i tha Nixonit se dyshonte "nëse kemi aftësinë tani për të trajtuar një konfrontim të madh në Kore". Dhe Laird mbizotëroi. Sulmi hakmarrës i Nixon nuk ndodhi kurrë. Duke lexuar memoriet nga Richard Hunt, i botuar nga Zyra Historike e Sekretarit të Mbrojtjes, duket se Laird realizoi një rast klasik të pengesave burokratike. Nixon mund të bënte deklarata të ashpra dhe të paqarta, ashtu si Trump. Në gusht të vitit 1969, terroristët rrëmbyen një fluturim të TWA dhe fluturuan në aeroplan në Damask, Siri. Sipas Evan Thomas të "Being Nixon", presidenti mori lajmin ndërsa ai po pinte kokteje në San Clemente, Kaliforni. "Bombardoni aeroportin", urdëroi Nixon. Këtë herë, Kissinger ishte i kujdesshëm. Thomas citon se ai vendosi "t'i japë presidentit mundësinë për të pasur mendime të dyta". Kissinger ngadalësoi lëvizjen e transportuesve të avionëve në Mesdheun lindor. Laird ishte gjithashtu i kujdesshëm. Ai planifikoi të përdorte "vonesat e motit" për të ndalur transportuesit edhe më shumë. Të nesërmen në mëngjes, ndërsa u informuan për lëvizjen e transportuesit, Nixon i kërkoi Kissingerit nëse kishte ndodhur "diçka tjetër". Kissinger tha: "Jo," dhe Nixoni u përgjigj: "Mirë." Kissinger më vonë shkroi se "kurrë nuk dëgjoi ndonjë fjalë për bombardimin e Damaskut". Një shembull i fundit i shfryrjes së dëshirës për hakmarrje presidenciale vjen nga Jeffrey H. Smith, një ish këshilltar i përgjithshëm i CIA-s, i cili gjatë epokës Nixon ishte një avokat i ri i ushtrisë. Smith kujtoi në një postim të kohëve të fundit për "Just Security" se në vitin 1974, pak ditë para dorëheqjes së Nixonit, iu shfaq një mesazh nga kryetari i Shefave të Shtabit të Përbashkët për komandantët vartës, duke këshilluar që nëse ata kishin marrë ndonjë urdhër të Shtëpisë së Bardhë "për të përdorur forcën", ata duhet ta konfirmonin atë së pari me kryetarin ose sekretarin e mbrojtjes. Thomas shpjegon në librin e tij: "Të shqetësuar se presidenti mund të bëjë diçka të dëshpëruar, Sekretari i Mbrojtjes James Schlesinger kaloi fjalën se të gjitha urdhrat nga Shtëpia e Bardhë për trupat duhet të kalojnë përmes tij." Schlesinger më vonë pretendoi se ai vetëm donte të përforconte zinxhirin e komandës. Ky episod është hulumtuar gjithashtu nga Garrett Graff të Politico. Çfarë mund të bënte Mattis-i ynë imagjinar nëse ai provonte metoda të ngjashme të parandalimit, por presidenti akoma donte të lëshonte atë që Mattis dhe komandantët e tij e konsideronin si një sulm të pamatur? Epo, ka një ilaç për këtë në Kushtetutën tonë. Amendamenti i 25-të parashikon që nënkryetari dhe shumica e zyrtarëve të Kabinetit mund të informojnë Kongresin se presidenti nuk është në gjendje të "kryejë kompetencat dhe detyrat" e zyrës së tij. Nënpresidenti do të merrte përsipër detyrën, përveç nëse më shumë se një e treta e Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit mbështesnin presidentin. Por mos harroni, kjo është e gjitha hipotetike. Siç tregimet mbi Nixon tregojnë, madje edhe presidentët më të zjarrtë zakonisht përfundojnë duke dëgjuar këshillat e Pentagonit. *(lexo.al)*

Europa ime: Ballkani im i lëndueshëm

Lindita ARAPI

Ballkani ende është i ndarë në llogoren - ana ime është vetëm viktimë, fajtor janë të tjerët. E ngrirë në një reduktim të tillë e pa vetëreflektim e shkuara bllokon të ardhmen, e këtu në Mostar vetiu pyet veten: Ballkani im, po kur do të trokasë më në fund e ardhmja jote

Jemi mësuar të lëvizim nëpër botë bashkë me imazhet tona të parapërgatitura për vende e popuj, deri sa realiteti na i vë në sprovë. Sapo kisha mbërritur në Split, për të qenë pjesë e Festivalit Ndërkombëtar të Letërsisë, „Poligon" në Split e Mostar, kur imazhi im për qytetin bregdetar kroat iu nënshtrua realitetit.

Split: Shoferi kroat që do të duhej të më çonte në hotel, më përshëndeti e kur iu afruam automjetit, ai hapi derën dhe u fut i pari në anën, që në fakt duhej të ngjitesha unë. „Dera nga ana ime nuk hapet", u justifikua si në faj ai. Ulur në makinë pashë derën gjysmë të shkatërruar të mbuluar nga brenda me plastmasë. „Ne këtej përpiqemi të mbijetojmë", ishin fjalët e para të tij, sapo u nisëm. Nga dritarja në anën time të rrugës pashë si më buzëqeshte Heidi Klum nga një poster gjigand, me mbishkrimin: „Let's make wow!" Por në këtë moment Gjermania, m'u duk si një planet i largët, i përkëdhelur nga fati.Jam në Kroaci, anëtaren më të re të BE-së me njerëz të pashpresë, që grinden me vete gjithë ditën e zotit për „gabimin e vetëm në jetë, që nuk ikën jashtë shtetit", siç më tha edhe shoferi kroat. „Por Spliti është i bukur, diell, det, kafenetë plot, shëtitorja Riva", i thashë unë. „Jobs, jobs", përsëriste shoferi kroat, e unë kuptova se ajo ndjesia e dielltë e jugut ngroh më shumë zemrat e turistëve se të vendalinjve. Po marrëdhëniet me fqinjët, doja të dija unë më shumë. Shoferi tundi kokën i menduar e tha „e dini, politika nuk ka interes për këtë, ata i bëjnë të tjerët të këqinj, herë janë serbët, herë boshnjakët, pala tjetër kundërpërgjigjet...e kështu vazhdon kjo tek ne". Shoferi kroat do t'i kishte fshirë vrullshëm me forcën e realitetit të tij të përditshëm fjalitë e bukurmenduara të shkrimtarëve nga Europa në takimin e Splitit...por ai më la mua para hotelit e vazhdoi rrugën e tij. Atë darkë fjalët e mia mu dukën fraza boshe.

Mostar: Ndjehem disi fajtore, sa më shumë i afrohem këtij qyteti...ndoshta sepse unë jetoja qetë, kur këtu dergjeshin kufoma në rrrugë, kur u shkatërrua ura e Mostarit, kur banorët e këtij qyteti, me ëndrra ashtu si dhe unë, panë se si ato iu zhdavaritën para syve. Në një rrugë anësore renditen varreza djemsh, të rinj, të shuar në vitin 1992. Ka qenë viti, kur unë studioja...si do të kishte qenë jeta ime, sikur unë thjesht të kisha lindur në këtë qytet? Për fat luftë nuk ka më, qyteti është rinovuar, turistët shëtisin lart e poshtë urës së Mostarit, tani breshëri aparatesh fotografikë, ndërtesat e shkatërruara të lëna si në kohën e luftës janë sot një motiv i preferuar fotosh...me sa duket edhe lufta një ditë kthehet në një atraksion turistik. Veçse plagët jo. Nga kaq shumë turistë para syve fillimisht nuk të shkon mendja tek ato...por ato ekzistojnë, bëjnë jetën e tyre...disa janë shëruar ndoshta, disa janë vulosur në emër të së ardhmes, të tjerat trajtohen enkas me merak për të mos ndalur kurrë së dhemburi, për të mos e shuar kurrë kujtimin e armikut në anën tjetër.

Kështu rrodhi koha e Mostari, thirret sot qyteti i ndarë mes boshnjakëve e kroatëve. Trauma e luftës e përjetësuar në aktualitet. Konkurrencë viktimash. „Ne jetojmë në një atmosferë të keqardhjes e mëshirimit, njëri është më shumë viktimë se tjetri, madje kemi të bëjmë edhe me një komercializim të vuajtjes", thotë Mirko Bozic, shkrimtar që jeton në Mostar." Ky reduktim vetëm në vetëdijen e viktimës ul viktimat e luftës, është i mendimit shkrimtari. Ballkani im, je ende kaq i lëndueshëm! Edhe kjo sigurisht një traumë e luftës. Problematike është, kur lëndueshmëria instrumentalizohet duke penguar kështu të ardhmen, si në Mostarin e ndarë. ...e në një farë mënyre të gjithë janë në Ballkan të lëndueshëm, kaq shpejt të lëndueshëm, saqë mjafton edhe një provokim i vogël që emocionet të ziejnë, një provokim mund të kthehet në aferë shtetërore, si në rastin e flamujve shqiptarë të hedhur në stadiumin e Beogradit para pak vitesh. Sepse ende Ballkani është i ndarë në llogoren - ana ime është vetëm viktimë, fajtor janë të tjerët. E ngrirë në një reduktim të tillë e pa vetëreflektim e shkuara bllokon të ardhmen, e këtu në Mostar vetiu pyet veten: Ballkani im, po kur do të trokasë më në fund e ardhmja jote?

Në kthim nga Mostari më çoi në aeroport një djalë i ri mysliman, që nuk ishte asnjë mik kroat. *(DW)*

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

KA FEMRA QË PRANOJNË TË JENË "STOLI DEMOKRATIKE"

Pasi u martova dhe pas shpërnguljes time ne Shkup, fati deshi të vazhdoje shkollimin e lartë që e pata filluar qysh ne Tetovë dhe paralelisht me të edhe të punësohem si mësuese, por edhe ta vazhdoja aktivitetin tim shoqëror në shkollën e lagjes së varfër dhe të famshme të Dizhonit, ku bashkë me koleget e mia u ballafaquam me sfida të ndryshme të kohës së monizmit dhe diferencimit. Shkeljes së paparë të drejtave të njeriut të shqiptarëve. Vështirësitë, rreziqet dhe padrejtësitë që i përjetuam bashkë me banorët e kësaj lagjeje, mua më kaliti e rriti edhe më guximin, më forcoi dhe më bëri mos të heq dorë nga mbrojtja e të drejtave të njeriut, sidomos të grave, dhe të bëhem zëri i të pazëshmëve

Koha — Delvina KËRLUKU

KOHA: Zonja Nebiu, keni ngritur zërin për të drejtat e grave. Si nisi kjo iniciativë për vajzën, për gruan, për nënën?

NEBIU: Jam e bindur se kjo ndodhi shumë herët në moshën time 18-19 vjeçare, pas kryerjes së shkollës së mesme pedagogjike, pasi u punësova si mësuese në shkollë fillore, të një lagjeje shumë të varfër (në atë kohë), në periferi të Tetovës. Ishte ky një zë që vinte nga zemra, por jo shumë e artikuluar dhe emëruar si vetëdije për të drejtat e grave. Thjesht, angazhim spontan për përfshirjen sa më të madhe të vajzave në shkollim. Më vonë kjo ndjenjë vazhdimisht u rritë dhe bë ideali dhe ëndrra ime jetësore. Arsye për të vazhduar aktivitetin tim 25 vjeçar fokusuar në dobi të balancës gjinore, për një shoqëri më humane më të drejtë, ku femrat dhe meshkujt do të kenë të drejta, mundësi dhe obligime të barabarta. Shoqëri, që do të dijë t'i shfrytëzojë edhe aftësitë, shkathtësitë dhe kapacitetin intelektual edhe të 50%-shit të dytë të hapësirës qiellore, që Zoti i plotfuqishëm i lindi të barabartë, ndërsa njeriu u kujdes t'i ndaj rolet e tyre gjinore, obligimet dhe të imponojë kufizime dhe qasje të pabarabarte në fuqi dhe resurse.

Them se kjo u zhvillua spontanisht, pasi shkaku kryesorë ishte një praktikë e asaj kohe që prindërit mos të vinin t'i regjistronin fëmijët në shkollë, por këtë e bënim ne mësueset/it me vizita shtëpiake. Këto vizita luajtën një rol të rëndësishëm në jetën time. Më ndihmuan të ballafaqohem me realitete shumë të hidhura. Me pozitën e mjerueshme ekonomike dhe kushtet e jetesës së familjeve, por edhe dominimi fuqishëm i vlerave patriarkale, ku një pjese e konsiderueshme, refuzonin vajzat t'i regjistronin në shkollë ose u ndërpritnin shkollimin pas kryerjes të klasës së katër fillore. I dhimbshëm ishte fakti kur në sytë e nënës shihja frikë dhe shpresë, por jo edhe zë, guxim dhe fuqi vendosëse për ardhmërinë e bijës së saj. Fjalën kryesore e kishin anëtaret meshkujt, sidomos gjyshi. Kjo ishte një sfidë e madhe për mua. Duhet shpenzuar shumë energji t'i bindnim prindërit që kundërshtonin, diku korrnim sukses, por në raste specifike dhe jo. Atë vit unë me kolegen time, vendosem të mos dorëzohemi lehtë.

Tre muaj vere vazhduam të jemi "mysafire të rregullta" në familjet e njëjta ku rezistenca ishte e madhe. E fituam besimin e një pjese të prindërve, por jo dhe të gjithë. Unë për herë të parë ndjenja një fitore që me plotësoi mua, sidomos ai gëzim dhe lumturi që e shihja në sytë e vogëlusheve dhe nënave të tyre. Kjo ishte një përvoje që më trimëroi më dha shpresë dhe guxim të vazhdojë. Thjeshtë këtë e përjetova si obligim dhe pjesë e punës time. Atë kohë nuk isha shume e vetëdijshme, se kjo është fillimi i luftës time dhe përcaktimi im jetësor në dobi të gruas dhe barazisë gjinore. Pasi u martova dhe pas shpërnguljes time ne Shkup, fati deshi të vazhdoje shkollimin e lartë që e pata filluar qysh ne Tetovë dhe paralelisht me të edhe të punësohem si mësuese, por edhe ta vazhdoja aktivitetin tim shoqëror në shkollën e lagjes së varfër dhe të famshme të Dizhonit, ku bashkë me koleget e mia u ballafaquam me sfida të ndryshme të kohës së monizmit dhe diferencimit. Shkeljes së paparë të drejtave të njeriut të shqiptarëve. Vështirësitë, rreziqet dhe padrejtësitë që i përjetuam bashkë me banorët e kësaj lagjeje, mua më kaliti e rriti edhe më guximin, më forcoi dhe më bëri mos të heq dorë nga mbrojtja e të drejtave të njeriut, sidomos të grave, dhe të bëhem zëri i të pazëshmëve.

KOHA: Sot gratë kudo në botë gëzojnë më shumë liri dhe janë më të përfshira se kurrë më parë, në nivel bazë. Por, duke përfaqësuar rreth 50 për qind të popullsisë dhe shumë vite më parë pasi fituan të drejtën e votës, me përjashtim të pak vendeve - aksesi i tyre në jetën publike dhe vendimmarrje është duke u rritur shumë ngadalë?

NEBIU: Ky është një fenomen i përgjithshëm botëror, sidomos në vendet me demokraci të brishtë. Janë bërë hapa të guximshme. Konteksti dhe gjendja faktike ka ndryshuar mjaftë edhe tek ne, si rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe aktiviteteve lokale të OJQ-ve. Niveli i balancës gjinore në shumë sfera të marrjes së vendimeve të vendeve anëtare të Këshillit të Europës është rritur ndjeshëm 25 vitet e fundit. Megjithatë, progresi nuk ka shënuar kudo të njëjtat arritje. Disa vende anëtare te Unionit Evropian i kanë transformuar rrënjësisht strukturat e marrjes së vendimeve dhe ekonomitë e tyre, kurse të tjerat kanë hasur në barriera. Pariteti gjinore në vendimmarrje mbetet pothuajse, kudo ende një ëndërr. Shkëmbimi i përvojave dhe bashkëveprimi i integruar i OJQ, për të drejtat e grave me vendosmëri sfidojnë këtë çështje. Sfera ku balanci gjinor mungon në rend të parë është vendimmarrja - gratë në pozita të larta udhëheqëse, por jo vetëm kaq. Gratë përfaqësojnë gjysmën e talenteve dhe aftësive

potenciale të njerëzimit dhe në përfaqësimi tyre në marrjen e vendimeve është një humbje për shoqërinë në tërësi. Pozitën e pabarabartë të gjinive e vërtetojnë edhe hulumtimet dhe analizat gjinore. Në bazë të këtyre aprovohen konventa, dokumente dhe instrumente ndërkombëtare, si masa për zvogëlimin/ eliminimin/ e diskriminimit gjinore. Një ndër dokumentet bazike është edhe Deklarata e Pekinit dhe platforma për veprim, Konventa CEDAW, Rezoluta 1325 SCR –UN, "Konventa e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftë kundër dhunës ndaj grave", e njohur si Konventa e Stambollit dhe një varg ligjesh që i detyron shtetet anëtare të OKB të inkorporojnë në legjislativën vendore.

Megjithatë zbatimi praktik i tyre në masë të madhe mungon. Këtu merr pjesë edhe R. Maqedonia e cila synon të jete anëtare e Bashkësisë Evropian. Në Maqedoni ekzistojnë mekanizma të instaluara. Ligji për Mundësi të barabarta dhe një numër i madh i strategjive dhe planeve të veprimit, por edhe mekanizma institucionale(në nivel qendror dhe lokal). Mirëpo zbatimi dhe ndikimi i tyre është shumë i vogël. I vetmi rezultat është zbatimi i Kodit zgjedhorë për zgjedhjet parlamentare dhe ato lokale ku ka masa afirmative – kuota prej 40% që i obligon partitë politike në listat zgjedhore të sigurojnë këtë përqindje për kandidatë të gjinisë më pak të përfaqësuar. Kjo masë në parim respektohet. Megjithatë në mungesë të mekanizmave adekuate mbrojtëse numri i grave në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë momentalisht është 34,6. Dekurajues është fakti se ky rezultat arrihet fal

kuotave , dhe jo për shkak të vetëdijesimit dhe ndërrimit të mentalitetit patriarkal, kulturor dhe vullnetit të mirë të partive politike. Tek ne, çështja e balancit gjinor nuk njihet si vlerë dhe drejtësi. Aty ku mungojnë kuotat, mungojnë edhe gratë. Në qeveri prej 22 ministrive vetëm në 4 prej tyre udhëheqin femrat. Prej 80 kryetareve të komunave, momentalisht vetëm 4 janë femra. Listat e partive politike për kryetarë në Zgjedhjet lokale 2017, janë diskriminuese për femrat. Partitë politike duhet të kenë të qartë se pjesëmarrja e femrave në politikë dhe në pozita vendimmarrëse, nuk është vetëm respektimi i interesave të veçanta të femrave, por kjo është një parakusht i domosdoshëm për përmbushjen dhe revitalizimin e demokracisë, si dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

KOHA: Gratë në Maqedoni akoma janë të diskriminuara dhe larg nga realizmi i potencialeve të tyre?

NEBIU: Përveç në vendimmarrje dhe pozita të larta në udhëheqje, diskriminimi gjinor është i pranishëm edhe në sfera tjera të jetës private dhe shoqërore. Kjo gjendje është prezent në punësim si dhe qasje në tregun e punës; posedimi i pronës në emër të gruas; trashëgimia e pronës dhe ndarja e pabarabarte e pronës nga ana e prindërve, dhe një sferë veçanërisht delikate ku shkelet e drejta më bazike e grave, dhe kjo ka të bëjë me përjetimin e dhunës, qofte ajo: fizike, psikike apo seksuale. Shumë prezent në të gjitha vendet e botës, sidomos tek ne me një përqindje rreth 85%. Një prej dukurive është edhe femiciti – vrasja e grave nga bashkëshortet partneret e tyre që merr përmasa brengosëse. Numri i grave jo aktive në tregun e punës është i madh, mbi 67%. Kjo do të thotë se gratë e një moshe aktive për punë, nuk paraqiten në Agjencionin për punësim si kërkuese aktive ose pasive të punës. Ato nuk figurojnë fare si të papunësuara dhe nuk mund t'i shfrytëzojnë beneficionet e masave aktive për zbutjen e papunësisë. Këtu në rend të parë janë gratë e grupeve etnike jo shumicë, ku marrin pjesë edhe gratë shqiptare.

KOHA: Shumë barriera ekzistojnë si: politike, ligjore, kulturore, ekonomike, etj. Këto shkojnë nga mosimplementimi i ligjeve të barazisë, mungesa e besimit apo mbështetjes familjare, kultura politike mashkullore jomiqësore ndaj grave, duke përmendur disa prej tyre?

NEBIU: Është sfidë e madhe për të gjithë, sidomos ne që angazhohemi për ndryshime, e kemi të qartë se çështja për një shumicë të burrave, por edhe të grave është e padukshme për shkak të kulturës patriarkale, stereotipave, paragjykimeve dhe miteve ekzistuese gjinore. Ndonëse të armatosur me argumente, hasim një sërë vështirësish në realizimin e synimeve tona. Çmimi i ndryshimit të statuskuos është i lartë dhe për të gjithë ne, që aspirojmë për të bërë këtë ndryshim, nuk e nënvlerësojmë forcën e atyre që e shohin ndryshimin si një kërcënim të raporteve konvencionale të pushtetit, edhe pse ajo shpeshherë nuk shprehet në mënyrë të hapur.

Duke u bazuar në problemet dhe sfidat ekzistuese Rrjeti IQF ANTIKO, të cilën e udhëhoqi, por jo vetëm ajo, punojmë paralelisht në disa fusha të ndikimit. Si në vetëdijesimin dhe fuqizimin e grave në teren, por edhe në krijimin dhe zbatimin e politikave të ndjeshme gjinore. Avokojmë dhe lobojmë në institucionet e sistemit në nivel qendror dhe lokal, por edhe i ndihmojmë atyre me ekspertizë në krijimin dhe zbatimin e politikave dhe buxheteve gjinore. Ajo që dua të theksoje është se: barazia gjinore nuk është vetëm çështje e grave, por është problem shoqëror shumëdimensional, gjegjësisht sistemor, andaj edhe duhet pasur një qasje sistemore dhe intersektoriale, me inkuadrimin e institucioneve, gjegjësisht edhe të burrave në zbutjen e problemit të balansit gjinorë. Sistemi i arsimor në të gjitha nivelet duke filluar prej kopshteve fëmijërore është posaçërisht i obliguar dhe i rëndësishëm në eliminimin e vlerave patriarkale, prej së cilës determinohet dhe diskriminimi gjinor, dhe prej ku duhet të fillojnë ndryshimet sistemore.

KOHA: Rritja e numrit të grave të zgjedhura në procese të fushave të ndryshme, ka qenë dhe vazhdon të jetë e limituar, nga mungesa e specifikimeve, iniciativat e dobëta për partitë politike apo?

NEBIU: Në këtë drejtim është shumë i rëndësishëm roli i partive politike, sepse ato paraqesin një filtër në përgatitjen e mandateve për përfaqësuesit e tyre në pushtetin lokal dhe qendror. Andaj, rëndësi të veçantë ka vendosja e mekanizmave brenda partiake që do ta përforcoj pozitën e gruas në të. Rol të rëndësishëm ka edhe parlamenti dhe administrata publike, e cila duhet të krijojë akte normative dhe mekanizma që do të mundësojnë harmonizimin e jetës familjare me atë profesionale dhe shoqërore. Gruaja në krahasim me burrat ka rol të trefishtë. Ajo reproduktive që është e stërngarkuar me punë të pa paguar shtëpiake, pastaj puna e paguar profesionale jashtë shtëpisë dhe ajo publike. Mossigurimi e serviseve të ndryshme të shërbimit që do ta lehtëson gruas barrën nga një pjesë e obligimeve shtëpiake në mungesë të kulturës dhe mentalitetit punët e shtëpisë të jenë obligim i gruas.

Mirëpo jo vetëm kjo, ka edhe shumë faktorë të tjerë ndikimi që krijon bllokada objektive dhe subjektive në rritjen e numrit të grave në fusha të ndryshme të jetë e limituar, sidomos gratë shqiptare, për të cilën bëhet fjalë edhe në raportin dhe rekomandimet e CEDAW Komitetit për KB për Maqedoninë. Një pjesë e madhe e fajit është edhe tek femrat e partive politike, të cilat janë të heshtura dhe pranojnë të jenë "stoli demokratike", dhe jo fuqi e mirëfilltë e partisë, e cila vjen me vizion të qartë dhe nuk e lejon veten të margjinalizohet dhe të trajtohet në mënyrë të pabarabartë. Përfaqësimi i drejtë i grave si kryetare komune, nuk është vetëm një çështje gjinie, por një tregues i nivelit të civilizimit të një komuniteti.

Gratë që të jenë të suksesshme, duhet të promovojnë një qasje shumë më ndryshe. Sepse pranimi i pakushtëzuar, degradues dhe i margjinalizuar i angazhimit politikë në një afat më të gjatë, është vetëshkatërrim, dhe ka ndikim negativ për të gjithë femrat tjera që kanë kapacitet dhe duan të angazhohen në politikë. Gratë duhet të jenë të vetëdijshme, mos të pranojnë pozita dhe role nënçmuese, të veprojnë bashkëristh, të bëjnë rezistencë dhe të sigurojnë përfaqësim sa më të mire, jo vetëm për vete, por edhe për gratë tjera të partisë. Në fushatat parazgjedhore të ofrojnë agjendën e tyre që do ta përmirësojë pozitën kategorive të ndryshme të grave në komunitet dhe në përgjithësi të qytetarëve.

KOHA: Në dekadat e fundit gratë kanë arritur suksese të dukshme. Kanë avancuar në studimet universitare, në nivelin e punësimit, kanë hyrë në fushat e dominuar nga burrat. Por, është hutues fakti, sepse ende gratë nuk po bëjnë ndonjë progres të vërtetë në majat e industrisë?

NEBIU: Shumë e vërtetë kjo! Hulumtimet dhe dëshmitë tregojnë se numri i femrave dhe suksesi i tyre në arsimimin superior është shumë më i lartë në krahasim me meshkujt. Por gjatë punësimit dhe pozitave

vendimmarrëse, si dhe profesioneve më të paguara ato "treten" dhe janë shumë të padukshme. Pikërisht këtu haptas detektohet ndikimi i kulturës, traditave, roleve dhe përvojave prej nga determinohen profesionet e ndara gjinore të rezervuara veçmas për meshkujt dhe femrat. Femrat janë të angazhuara më tepër në profesione që janë të bazuara në kujdes dhe dhënien e shërbimeve elementare , ndërsa meshkujt profesione që kanë të bëjnë me krijimtari, inovacione, ndërtim, industri dhe shërbime intelektuale, ku edhe pagat janë dukshëm më të larta.

KOHA: Gratë ballafaqohen me pengesa në botën profesionale, diskriminimin dhe barriera shoqërore, kjo e pengon avancimin e saj apo e forcon?

NEBIU: Vetë pozita e saj në familje dhe angazhimet që i ka në shtëpi, lindja dhe kujdesi ndaj fëmijëve dhe anëtareve tjerë të familjes, dhuna gjinore, paragjykimet, traditat, kufizimet e imponuara nga familja ose rrethi, shkalla e vetëbesimit, josiguria e saj në hapësira publike, mosbesimi i shoqërisë në aftësitë e saja se mund të jetë profesionaliste po aq e mirë sa edhe meshkujt janë kërcënime dhe barriera që e pengojnë afirmimin dhe avancimin e saj në jetën profesionale, në krahasim me meshkujt që nuk i kanë këto brenga dhe barriera.

KOHA: Ju zonja Gyner, duke qenë një grua, që i përkushtoheni po kësaj qenie, si arrini t'i përballeni barrierave, duke pasur parasysh faktin, se gratë në Maqedoni, thënë kushtimisht kanë qenë të shtypura, përvuajtura? Cili është rrëfimi juaj si vajzë, si nxënëse, studente, pra edhe si grua, si nënë?

NEBIU: Sa për ilustrim, unë i takoj gjeneratave të para ku në shkollimin e mesëm për here të parë ka pasur një pjesëmarrje më e madhe e vajzave të regjistruara ne gjimnazin e Tetovës. Ishim 12 vajza. Nëntë (9) tetovare në paralelen pedagogjike dhe 3 në paralelen e gjimnazit, dhe më pas u bashkëngjitën edhe 5 shoqe të tjera nga Kërçova, Dibra dhe Manastiri, gjithsej 17. Kjo përfshirje e vajzave për atë kohë llogaritej si sukses i madh. Në kontekstin e tanishëm fjala sukses tingëllon si joreale. Ishin kohëra sa të bukura aq edhe të vështira. Ishim vajza që kishim fat, sepse nuk patëm pengesë nga prindërit ta vazhdojmë shkollimin, mirëpo duhej të jemi të përkryera për rrethin që na shikonte vazhdimisht me sy shumë kritik. Duhej çdo sjellje çdo fjalë të matej mirë. Na thonin se është obligim dhe përgjegjësi të shërbejmë si rol model për vajzat dhe prindërit e gjeneratave të ardhshme, që shkollimin ta vazhdojnë edhe ato. Fat i mirë ishte ajo që profesorët tanë ishin personalitete me përgjegjësi dhe profesionistë të vërtetë. Kriteri i vlerësimit si në shkollën fillore, ashtu edhe në të mesmen ishte shumë i rreptë, shprehitë dhe disiplina e punës gjithashtu. Nuk ishte fare e rëndësishme se ne jemi vajza në një numër simbolik, dhe se kriteri i vlerësimit duhet të jetë më fleksibël, përkundrazi ishte shumë i rreptë, s'ishte fare rëndësi që notat tjera i ke të larta, nëse nuk je përgatitur në një ose dy lëndë profesionale shumë lehtë përsëritej klasa. Krahas arsimimit shumë e rëndësishme ishte edhe edukata dhe vetëdijesimi për rolin dhe pritjet nga ne.

Të jemi të gjithanshme në shume sfera të zhvillimit edukativo - arsimore , kulturor dhe kombëtar. Qasje që tani më duket se mungon. Ndikim të madh në jetën time kishin pikërisht prindërit e mi, prej të cilëve kisha përkrahje dhe besim të plotë. Sa të "rrepte" në edukimin tim për virtytet njerëzore , por aq edhe liberal në zgjedhjet dhe shtigjet e mia jetësore. Pas martesës (ndonëse në moshë shume të re për kontekstin e tanishëm), përkrahja, mirëkuptimi dhe ndihma e bashkëshortit tim ishte dhe akoma është shumë e vlefshme për atë që sot jam. Kontributi dhe mbështetja e tij ka vlerë të madhe për mua si në sferë e aktivitetit tim shoqëror ashtu edhe në sferën private, sidomos në kujdesin dhe edukimin e tre fëmijëve tanë. Kemi pasur fat që edhe ata gjithnjë ishin shembullorë gjatë shkollimit, por edhe në jetën e përditshme.

Janë të pavarur, profesionist të mirë. Në një moshë shumë të re krahas shkollimit, u punësuan. Jetën dhe shkollimin e tyre e siguruan vet me punën e tyre. Ata dhe bashkëshorti im janë për mua gjithçka që kampërkrahës, shokë, miq, adhurues dhe kritik objektiv, gjë qe ka pasur rol të rëndësishëm në jetën dhe aktivitetin tim.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një interviste për Radion Evropa e Lirë ka thënë se vazhdimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duhet të jetë shërbim për popujt, pra të mos mbetet dialog vetëm i liderëve

Përfshirja amerikane në dialogun Kosovë-Serbi, e domosdoshme

Deri më tani Prishtina dhe Beogradi kanë arritur një varg marrëveshjesh në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, përfshirë edhe marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve në prill të vitit 2013, e cila parasheh formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Qëllimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sipas Bashkimit Evropian, është relaksimi i raporteve ndërmjet dy vendeve në mënyrë që Kosova dhe Serbia të vazhdojnë tutje me procesin e integrimit evropian

Analistët politikë në Prishtinë, mundësinë e përfshirjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e shohin si të rëndësishëm dhe një mundësi të mirë që procesi të japë rezultate pozitive. Naim Rashiti, drejtor i Grupi Ballkanik për Politika në Kosovë, konsideron se pjesëmarrja eventuale e SHBA-së në dialog, është tejet e rëndësishme, pasi që, sipas tij, do të ndihmojë që procesi të shkojë më shpejt drejt përfundimit. "Tash, faza tjetër e dialogut që duket të jetë një fazë shumë më e komplikuar dhe më e rëndë sepse dëshirohet një marrëveshje më gjithëpërfshirëse.Me çdo kusht Kosova insiston në rolin e SHBA-së dhe angazhimin në dialog, por me gjasë edhe zonja Mogerini e ka kuptuar këtë çështje dhe ajo ka pasur një takimi me zëvendëspresidentin Pence për të gjetur modalitetet e angazhimit të SHBA-së në procesin e dialogut. Unë besoj që krahas tyre edhe Gjermania do të ketë një rol më të intensifikuar në procesin e dialogut", thotë Rashiti. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë vizitës së tij të fundit në New York, ka kërkuar përfshirjen e SHBA-së në procesin e dialogut Prishtinë-Beograd. Thaçi në takimi me zëvendëspresidentin e Mike Pence ka thënë se "përfshirja direkte e SHBA-së në këtë fazë përfundimtare, është përcaktuese për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare, të zbatueshme për të dy palët". Rashiti thotë se kërkesa e presidentit Thaçi është e drejtë. "Është e drejtë kërkesa dhe besoj se do të rezultojë me një angazhim më të theksuar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës", vlerëson Rashiti.

Kurse, analisti tjetër politik, Imer Mushkolaj, thotë se në fazën e ardhshme të dialogut me Serbinë, përveç SHBA-së mund të pritet të përfshihet edhe Gjermania, por siç thotë ai, edhe Rusia mund të kërkojë të njëjtën gjë. "Shtetet e Bashkuar të Amerikës besoj se do të përfshihen gjithsesi, natyrisht se mbetet të shihen modalitetet se në çfarë forme do të përfshihen. Por, nëse përfshihen Shtete e Bashkuara në të njëjtin nivel apo të njëjtin modalitet unë pres të përfshihet edhe Rusia. Përndryshe nuk pres që vetëm SHBA-ja të jetë pjesë e dialogut", vlerëson Mushkolaj. Përfshirja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialog, thotë Mushkolaj, do t'i jepte një ritëm më të shpejtë zbatimit të marrëveshjeve dhe vetë procesit. "Përfshirja e ndonjë përfaqësuesi të administratës amerikane, besoj se do të mund t'i jepte një impuls të ri dialogut dhe të mos zvarritet edhe më tej siç ka ndodhur që nga viti 2011 me dialog teknik e më pastaj edhe politik. Por, është krejt çështje tjetër se si do të përgjigjet SHBA-ja dhe nëse në të vërtetë e shohin të nevojshme që në këtë fazë, me gjithë ato probleme që i kanë në vendet e tjera të botës, të përfshihen edhe në përfundimin e dialogut të Kosovës me Serbinë", thekson Mushkolaj. Përfaqësues të organizatave joqeveritare në Kosovë kanë thënë se pas gjashtë vjetësh që nga fillimi i dialogut në Bruksel, përveç ngecjes në planin e zbatimit të marrëveshjeve, raportet në mes Kosovës dhe Serbisë janë tensionuar. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në një interviste për Radion Evropa e Lirë ka thënë se vazhdimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duhet të jetë shërbim për popujt, pra të mos mbetet dialog vetëm i liderëve. Kurse, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë thënë se ky institucion duhet të ketë një rol shumë më aktiv në proces. Deri më tani Prishtina dhe Beogradi kanë arritur një varg marrëveshjesh në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, përfshirë edhe marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve në prill të vitit 2013, e cila parasheh formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Qëllimi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sipas Bashkimit Evropian, është relaksimi i raporteve ndërmjet dy vendeve në mënyrë që Kosova dhe Serbia të vazhdojnë tutje me procesin e integrimit evropian.

Ja në cilin qytet të Shqipërisë jetohet më gjatë

Instituti i Statistikave i Shqipërisë ka sjellë një skamin të të dhënave demografike në vend, që nga viti 2012 e deri në vitin 2016. Sipas INSTAT, mosha mesatare e vdekjeve për vitin 2016 është 73.7 vjeç. Qarku i Kukësit ka një shmangie të dukshme, duke u klasifikuar kështu në qarkun me moshën mesatare më të ulët të vdekjeve, 70.7 vjeç. E kundërta ndodh me Qarkun e Gjirokastrës, që gjithashtu ka shmangie në drejtim të kundërt, me një moshë mesatare vdekjeje 76.7 vjeç. Qarqet e tjera të vendit janë ndarë në numër të barabartë, 5 me 5 mes vlerës mesatare kombëtare, por luhatja është mjaft e vogël. E njëjta gjë mund të thuhet për Tiranën dhe Durrësin, dy qarqet ku është përqendruar pjesa më madhe e popullsisë. Në vitin 2016, në totalin e popullsisë mesatare të Shqipërisë, të rinjtë 0-14 vjeç zënë rreth 18% të totalit, ndërsa popullsia në moshë pune 15-64 vjeç zë rreth dy të tretat, 69%, duke lënë kështu vetëm 13% të popullsisë mbi moshën 65 vjeç.

Publicitet

ФОНД ЗА ИНОВАЦИИ И ТЕХНОЛОШКИ РАЗВОЈ

Ftesë për punëtori

Për përgatitje të Thirrjes publike për financim të projekteve

Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik (FIZHT), në bashkëpunim me Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor përgatitë Thirrje publike për financim të projekteve për zgjidhje teknologjike për ulje të ndotjes së ajrit.

Në pritje të finalizimit të Rregullores për thirrjen, formulari aplikues dhe buxhetor, kriteret për vlerësim dhe elementet tjera relevante organizojmë punëtori me aplikuesit dhe partnerët potencial që dot ë mbahet më **12 tetor 2017 (e enjte), në ora 11.00, në Zyrën publike në Shkup.**

Mundësia për pjesëmarrje në punëtori kanë të gjithë individët kreativ, organizatat joqeveritare dhe subjektet afariste, me kapacitet dhe gatishmëri të ofrojnë zgjidhje teknologjike ose metodologji të re që në mënyrë të drejtpërdrejtë do të kontribuojë në uljen e ndotjes së ajrit.
Për informacione shtesë dhe paraqitje për pjesëmarrje mund të drejtoheni tek z-nj Neda Ikonomova Gavrilloska (e-mail: neda.ikonomova@fitr.mk dhe tel. 02/ 3223 - 373)

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL
Kërkesë për ndërrimin e A – lejes së integruar ekologjike
për VE-GRUPA DOOEL Radovish

Në përputhje me nenin 95 pika 1, nenin 99 dhe nenin 116 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 51/11, 123/2012, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, dhe 39/16), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar kërkesë për ndërrim të A – lejes së integruar ekologjike nr. për ndërrim nr. 11-4576/1 nga data 07.07.2016.

Dorëzues i kërkesës:
VE – GRUPA DOOEL – Radovish
Bul. Aleksandar Makedonski nr. 2-1/7
Radovish
Republika e Maqedonisë

Koordinatat e lokacionit sipas sistemit nacional koordinativ:
N 42 08870
E 21 78164

Personi për kontakt:
Ana Gigovska
E-mail: vegrupainfo@gmail.com

Kategoria e institucionit:
Shtojca 1 pika
3. Industria e mineraleve
3.5 Bazat stacionare të asfaltit

160 t/orë Kapaciteti i projektuar

Lloji i aktivitetit:
Prodhimi i asfaltit me pajisjet shoqëruese

Kërkesa në formë të shtypur, do të jetë e ekspozuar për shqyrtim për të interesuarit në afat prej 15 ditëve që nga dita e daljes së kësaj Shpallje në shtypin ditor, në lokalet e:

Zyrës për komunikim me publikun pranë
Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
Kej Dimitar Vllahov nr. 4, kati 1 (objekti i vjetër i Bankës komerciale)
1000 Shkup,
Çdo ditë pune prej ora 10:00 deri në ora 16:00

dhe në hapësirat e: Komunës së Kumanovës prej ora 10:00 deri në ora 16:00

Në të njëjtën kohë kërkesa në formë elektronike do të jetë e vendosur edhe në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor www.moepp.gov.mk
Të interesuarit informatat më të detajuara në lidhje me kërkesën do të mund të marrin në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në tel. 076 456 717 (e-mail: f.baliu@moepp.gov.mk).
Të interesuarit në afat prej 30 ditëve nga data e shpalljes së kërkesës për ndërrim, kanë të drejtë të parashtrojnë vërejtje dhe komentet e tyre në formë të shkruar deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 (ndërtesa e RTM-së), 1000 Shkup.

URGJENTISHT
Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi.
Kontakt telefoni 072/643 093

Çdo deklaratë e pavarësisë së Katalonjës nuk do të ketë efekte. Kryeministri spanjoll Mariano Rajoy paralajmëroi se do të përdorë çdo fuqi kushtetuese për të anuluar autonominë e rajonit

Uraganet shkurtojnë mijëra vende puneuraganeve

Në Shtetet e Bashkuara u shënua një rënie me 33 mijë vende pune në shtator për shkak të uraganeve Harvey dhe Irma, që mbyllën me mijëra biznese në Teksas dhe Florida dhe detyruan evakuime në masë. Kjo është rënia e parë mujore në afërsisht shtatë vjet. Sot Departamenti i Punës njoftoi se shkalla e papunësisë ra në 4.2 për qind nga 4.4 për qind, niveli më i ulët që nga shkurti i vitit 2001. Duke parë ndikimin e uraganeve, tregu i punës dhe ekonomia përgjithësisht duken të shëndetshëm. Rritja e vendeve të punës ka gjasa të rikthehet në muajt e ardhshëm, ndërsa pritet të rihapen bizneset në rajonet e prekura dhe kompanitë e ndërtimit të rrisin volumin e punës. Rënia e muajit të kaluar u nxit nga humbje të mëdha në restorante dhe bare, që shkaktoi humbjen e 105 mijë vendeve të punës, një shenjë e dëmtimit të industrisë së turizmit në Florida. Sipas qeverisë rreth 1.5 milionë njerëz nuk patën mundësi të punojnë muajin e kaluar për shkak të motit, më shumë se në 20 vjet. Shkalla e papunësisë ra sepse llogaritet bazuar në një studim të veçantë të ekonomisë familjare. Ky anketim i numëron njerëzit si të punësuar edhe nëse ata nuk kishin mundësi të punonin për shkak të stuhive. Si rezultat rënia e papunësisë është një shenjë e përmirësimit të tregut të punës jashtë zonave të goditura nga stuhia.

Nisin leksionet e para për gratë në timon

Tre ditë pas dekretit të Mbretit Salman, që iu mundëson prej qershorit të ardhshëm grave pajisjen me patenta, Faisal BaGugaish nuk mendoi dy herë dhe dërgoi bashkëshorten e tij në një parkim të një qendre tregtare për t'i dhënë mësimet e para në drejtimin e automjetit. Kjo për shkak se një gjë e tillë vijon të jetë e ndaluar në rrugët kryesore të vendit. Pas këtij veprimi, dyshja e bashkëshortëve, duke buzëqeshur, publikoi një foto "selfie" në rrjetin social "Twitter". Një gjest që shkaktoi polemika mes sauditëve konservatorë. "Turp të kini", ishte sulmi më i rëndë që morën mes reagimeve të shumta. "Cicërima" e këtij skandali kishte këtë përmbajtje: Sapo nisa t'i mësoj gruas sime të drejtojë makinën në një parkim, në mënyrë të sigurt dhe ligjore, në pritje që ligji të hyjë në fuqi", shkroi në llogarinë e tij analisti i një shoqërie nafte dhe gazi në Dhahran, në lindje të Arabisë Saudite. Ky postim u ripublikua mijëra herë, por reagimi ishte i imagjinueshëm. Madje edhe i dhimbshëm, pasi demonstroi edhe njëherë sesa kontroverse është çështja në fjalë, për të cilën sovrani vijon të këmbëngulë se është e ndaluar për femrat të marrin timonin nën kontroll, një rast unik në të gjithë botën dhe që i ka rrënjët dekada më parë. Dikush ka provuar edhe ta miratojë këtë veprim të "përjetësuar" në një foto "Twitter"-i, por shumica e atyre që reaguan vërshuan me një "lumë" kritikash: Turp të kini!

Brazili si Katalonja, anketë për krijimin e një shteti të ri në jug

Votuesit në jug të Brazilit janë pyetur në një anketë joformale nëse ata do të donin të ishin pjesë e një vendi të ri. Sondazhi u organizua një javë pas një referendumi të ngjashëm të ndodhur në Katalonjë, nga lëvizja separatiste e quajtur "Jugu është vendi im"

Referendumi për pavarësi në Katalonjë ka frymëzuar një grup separatist brazilian të shtrojë pyetjen për shpalljen e një shteti të ri në jug të vendit. Brazilianët jugorë shprehen të zhgënjyer nga skandalet korruptive të politikanëve si dhe nga dështimet e vazhdueshme të qeverisë federale në mposhtjen e dhunës dhe recesionit që ka kapluar vendin. Votuesit në jug të Brazilit janë pyetur në një anketë joformale nëse ata do të donin të ishin pjesë e një vendi të ri. Sondazhi u organizua një javë pas një referendumi të ngjashëm të ndodhur në Katalonjë, nga lëvizja separatiste e quajtur "Jugu është vendi im". Sipas liderit të grupit, synimi është mbledhja e 3 milionë votave. Shumë brazilianë shprehen të zhgënjyer nga qeveria federale dhe skandali korruptiv ku janë përfshirë dhjetëra politikanë dhe anëtarë të elitës së biznesit. Të tjerë thonë se jugu i Brazilit ka përfituar shumë pak nga kthimi i taksave të cilat kryesisht shkojnë në rajonet më të varfra në veri të vendit, që kanë të drejta më të mëdha votimi sesa jugu. Tendencat separatiste nuk janë të huaja për këtë pjesë të Brazilit. Lëvizja "Jugu është vendi im" organizoi një votim të ngjashëm edhe një vit më parë. Sidoqoftë, pak brazilianë besojnë se lëvizja separatiste do të jetë e suksesshme, teksa sondazhi përbën një tjetër tregues të zemërimit drejt qeverisë federale që nuk ka arritur të ndalë dhunën përqark vendit dhe nuk ka mundur të luftojë recesionin më të rëndë në mëse një shekull. Analistët thonë se skandali korruptiv gjithashtu ka shkatërruar mbështetjen për klasën qeverisëse politike.

DO TË ANULOJ AUTONOMINË E KATALONJËS

Çdo deklaratë e pavarësisë së Katalonjës nuk do të ketë efekte. Kryeministri spanjoll Mariano Rajoy paralajmëroi se do të përdorë çdo fuqi kushtetuese për të anuluar autonominë e rajonit. Duke folur për gazetën spanjolle "El Pais" ai tha se nuk përjashton asgjë brenda ligjit. "Do të ishte ideale nëse nuk do na nevojitet implementimi i zgjidhjeve ekstreme, por që kjo të mos ndodhë, gjërat duhet të ndryshojnë". Rajoy gjithashtu hodhi poshtë çdo ndërmjetësim për te zgjidhur krizën. Kryeministri tha se ai planifikonte të mbante policinë e vendosur në Katalonja përpara referendumit, deri ne përfundimin e krizës politike. Ai shtoi se nuk do të thërriste zgjedhje të parakohshme kombëtare. Presidenti katalanas Carles Puigdemont pritet t'i drejtohet parlamentit rajonal të martën në 18:00 me orën lokale (16:00 GMT) pasi Gjykata Kushtetuese e Spanjës më parë pezulloi seancën e parlamentit katalanas, që ishte planifikuar për të hënën. Ka spekulime se parlamenti do ta shpalle pavarësinë në mënyrë të njëanshme në seancën e ardhshme.

Gjermani i arrestuar në Turqi kërcënohet nga 15 vite burg

Për një kohë nuk vinte asnjë lajm nga Turqia pas arrestimit të aktivistit gjerman për të drejtat e njeriut, Peter Steudtner. Tani aktpadia e prokurorisë ka mbërritur tek avokatët

Tre muaj pas arrestimit të aktivistit gjerman për të drejtat e njeriut, Peter Steudtner, të dielën prokuroria turke kërkoi sipas një raportimi të agjencisë së lajmeve DPA bazuar në agjencinë Dogan dhe CNN Türk, deri në 15 vjet burg për Steudtner. Por edhe 11 aktivistë të të drejtave të njeriut të arrestuar në Turqi, ndër ta edhe drejtoresha e Amnesty International në Turqi, Idil Eser, kolegu suedez i Stedtner, Ali Gharavi etj. Akuza e prokurorisë është anëtarësi në një "organizatë të armatosur terroriste". Avokatët konfirmuan për agjencinë gjermane të lajmeve DPA, se aktpadia ka mbërritur, por nuk jepnin dot të dhëna të sakta për masën e dënimit.

Pas një viti të vështirë në marrëdhëniet gjermano-turke, ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu kërkoi normalizimin e marrëdhënieve me Gjermaninë në një intervistë për revistën gjermane "Der Spiegel" të shtunën. Qeveria gjermane reagoi fillimisht e përmbajtur ndaj këtyre toneve. "Gjermania ka qenë, është dhe mbetet e gatshme për dialog", tha ministri i shtetit në Ministrinë e Jashtme, Michael Roth gazetës "Welt am Sonntag". "Por ne nuk mund të heshtim, kur qytetarë gjermanë, si Deniz Yücel arrestohen pa faj. Këtu ne duhet të gjejmë zgjidhje".

Ftesa e Schumanit u mirëprit menjëherë nga Adenaueri dhe nga qeveritë e Beneluksit dhe Italisë. Në 18 prill 1951, në Paris, u firmos traktati themelues i Komunitetit, që hyri në fuqi në 23 korrik 1952

Lufta e Vietnamit në vetëm katër pyetje-përgjigje

PSE SHPERTHEU? Interesat amerikane në Vietnam shkonin pas një dekadë në kohë, para se Presidenti Johnson të dërgonte trupa. Ngjitja e komunistëve në Vietnamin verior, të udhëhequr nga Ho shi Mini, në vitet 1950 e kish kthyer një vend të ndarë, në një fushëbetejë të Luftës së Ftohtë. Duke qenë se SHBA besonte që, nëse një shtet binte nën komunizmin, të tjerë do e pasonin - "Teoria e Dominosë" - ata duhej që të përfshiheshin.

KUSH FITOI? Sigurisht jo SHBA, që u tërhoq në vitin 1973 e poshtëruar, me psikikën kombëtare dhe ekonominë në vështirësi për shumë vite që do të vinin, dhe më shumë se 58 mijë të vdekur. Vietnami e pësoi edhe më keq, teksa miliona vdiqën dhe vendi ishte në rrënim. Megjithatë Vietnami verior i kish qëndruar një fuqie botërore dhe e kish detyruar të sprapsej.

KUSH ISHTE ARMIKU? SHBA duhej të luftonte të dyja, ushtritë e Republikës Demokratike të Vietnamit (veriu) dhe komunistët e zellshëm në jug, të njohur si Vietkongë. Të gjithë këta merrnin mbështetje nga Kina dhe Bashkimi Sovjetik. Më pas, teksa lufta zgjatej, një tjetër armik u shfaq: një lëvizje e fortë kundër luftës në Amerikë.

SI U LUFTUA? Trupat amerikane, të rinj në moshë e pa përvojë shumë shpejt u gjenden përballë forcave guerilase në xhunglën me një të nxehtë të padurueshëm, dhe terrene kënetore. Ata u demoralizuan gjithnjë e më shumë, në misionet kërko dhe shkatërro, apo duke u përdorur si karrem për fuqinë nga ajri. Ndonëse raporti i të vrarëve ishte një me dhjetë, amerikanët nuk mund të çrrënjosnin vullnetin e komunistëve për të luftuar.

U desh qymyri dhe çeliku, për të ndërtuar të parën Evropë të bashkuar

Duke i mëshuar idesë së hekurit dhe çelikut, u bë e mundur që të liheshin pas krahëve shekuj të tërë me konflikte. Krijuesi ishte Jean Monnet, politikani francez që sipas Keynesit "e shkurtoi me një vit Luftën e Dytë Botërore". Duke vepruar i vetëm, me bashkëpunimin e pak miqve

Lufta e Dytë Botërore varrosi përfundimisht sistemin evropian të shteteve. Këta ishin bërë, siç do të shkruante më vonë Luigi Enaudi, "pluhur pa substancë". Ishte më se evidente rruga që duhej të ndiqej për rindërtimin e Evropës, por ajo që është evidente nuk mjafton gjithmonë për të treguar aksionin politik që duhet ndjekur. Rindërtimi i menjëhershëm i Evropës kërkonte burime shumë të mëdhenj, që asnjë shtet nuk i kishte. Për të shpëtuar Kontinentin e vjetër ndërhynë menjëherë SHBA me planin Marshall, që përshpejtoi rimëkëmbjen ekonomike dhe rikthimin tek normaliteti.

MONNET DHE SCHUMAN

Qeveria e Uashingtonit nuk i kurseu ndihmat, por u kërkoi evropianëve që të paraqisnin një plan të koordinuar për të parandaluar konfliktet si dhe për të nisur, mbi themele të fortë, bashkëpunimin e tyre. Por, kur qeveritë evropiane paraqitën kërkesat e tyre, pa marrë parasysh ftesën e amerikanëve, Uashingtoni nuk mund të bënte ndryshe përveçse të impononte pikëpamjen e tij, duke ia besuar menaxhimin e ndihmave një organizmi të ri, OECD-së (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik në Evropë). Përtej problemeve ekonomikë që shqetësonin shoqërinë evropiane, perceptohej një rikthim i ngutshëm tek nacionalizmi, gjë që do të kishte rindezur përplasjen franko-gjermane, me riskun e një konflikti të ri. Ai që, në ato momente arriti të shohë më larg se të gjithë, si dhe të kërkojë me një guxim të palodhur një zgjidhje, ishte Jean Monnet. Ky personazh unik ka lënë një gjurmë të pashlyeshme në historinë e Nëntëqindës: "Me aksionin e tij personal", ka thënë filozofi Mario Albertini duke komentuar kujtimet e Monnet, "ka dhënë një kontribut vendimtar për fitoren e Aleatëve në Luftën e Parë Botërore, ka shkurtuar me një vit Luftën e Dytë Botërore (pohim i Keynesit) si dhe ka nxitur unitetin e rezistencës franceze në Algjer. Ai i ka arritur këta rezultate - që i japin madhështinë e një burri shteti - pa patur pushtet, duke vepruar i vetëm, me bashkëpunimin e pak miqve apo personave që i frymëzonin besim".

HAPAT E PARË

Një sintoni e thellë me rrugën që kish marrë historia, i mundësoi të kuptonte përpara të gjithë të tjerëve rrezikët që kalonte Evropa dhe të nuhaste rrugën për t'i shmangur. Një herë, Uinston Churchilli kishte thënë: "Një pesimist sheh vështirësi në çdo shans. Një optimist sheh një shans në çdo vështirësi". Jean Monnet i përkiste kategorisë së dytë të personave, jo sepse ishte i dhënë pas optimizmit në vetvete, por sepse ishte i angazhuar aktivisht në zgjidhjen e problemeve më të mprehtë të kohës së tij. Dhe ai evropian sigurisht që ishte një i tillë. Sipas tij, i duhej dhënë opinionit publik evropian - sidomos atij francez dhe gjerman - një mesazh i fortë, në gjendje të varroste një herë e mirë të kaluarën dhe të hapte një epokë të re. Në 4 maj 1950 i dërgoi kryeministrit francez, George Bidault dhe ministrit të Jashtëm, Robert Schuman, një memorandum të mbushur me fjalë që shprehnin shqetësim: "Në situatën aktuale të botës, ngado që të kthehesh, shihen vetëm rrugë qorre, qoftë kur bëhet fjalë për tërheqjen nga një luftë që konsiderohej e pashmangshme, e problemit të Gjermanisë, apo e vazhdimësisë së rritjes së Francës, apo organizimit të Evropës, apo vendit të vetë Evropës dhe të Francës në botë. Ka vetëm një mënyrë për të dalë nga një situatë e tillë: me një veprim konkret dhe të vendosur mbi një temë të limituar por decizive, që të sjellë një ndryshim themelor për këtë temë dhe të modifikojë në mënyrë progresive vetë termat e tërësisë së problemeve". Këto fjalë shoqëroheshin nga një projekt që mori formën e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut. Një projekt kompleks si federata evropiane - i vetmi institucion që do të shkonte në rrënjë të të gjithë problemeve - do të kishte ndeshur probleme të pakapërcyeshëm në të ardhmen e afërt ("Është i domosdoshëm", nënvizonte në memorandumin e tij, "një veprim i thellë, real, i shpejtë dhe dramatik që të ndryshojë gjërat dhe të shndërrojë në realitet shpresat, tek të cilat popujt nuk po besojnë më"). Monnet ideoi atëherë një formë të re bashkëpunimi mes vendeve evropianë, "Komunitetin", që në sytë e tij nuk përfaqësonte një alternativë ndaj federatës, por hapin e parë drejt një procesi që do të çonte pashmangshmërisht tek bashkimi politik. Komuniteti evropian i qymyrit dhe çelikut vinte theksin në industrinë e çelikut dhe hekurit, kolona tradicionale e fuqisë gjermane. Bashkimi në një autoritet të vetëm i prodhimit francez dhe gjerman, bashkë me atë të vendeve evropianë që do i bashkoheshin projektit, kishte një domethënie të saktë: zona më e tronditur e kontinentit linte pas krahëve shekuj të tërë luftërash, duke nisur kështu një rrugë të përbashkët.

Ishte ky pra "veprimi konkret dhe deciziv mbi një temë të limituar por decizive" për të cilin kishte folur Monnet. Projekti i tij kishte implikime të rëndësishëm politikë, por këta zbeheshin përballë domethënies historike. Në pasditen e vonë të 9 majit 1950, Robert Schuman bëri deklaratën solemne që i hapte rrugën pajtimit franko-gjerman dhe lindjes së Komunitetit. "Paqja botërore nuk mund të ruhet përveçse me përpjekje kreative, në përpjesëtim me rreziqet që e kanosin", deklaronte Ministri i Jashtëm i Francës, duke shtuar: "Kontributi që një Evropë e organizuar dhe vitale mund t'i sjellë qytetërimit është i domosdoshëm për ruajtjen e marrëdhënieve paqësore. Franca, duke shërbyer prej më shumë se njëzetë vitesh si një pararendëse e një Evropë të bashkuar, ka patur gjithmonë si objektiv që t'i shërbejë paqes. Evropa nuk u bë: kemi patur luftën". Ftesa e Schumanit u mirëprit menjëherë nga Adenaueri dhe nga qeveritë e Beneluksit dhe Italisë. Në 18 prill 1951, në Paris, u firmos traktati themelues i Komunitetit, që hyri në fuqi në 23 korrik 1952. Autoriteti i Lartë që e drejtonte kryesohej nga Jean Monnet. Nisi kështu jeta e Komunitetit Evropian, që vazhdon ende. *(Sette)*

Në gjenezën e saj morfologjike dhe mishërimin shpirtëror, Reshat Ameti me të vërtetë i takon rrethit mesdhetar të pikturës moderne, nga Shkolla e Parisit e viteve të pesëdhjeta dhe të gjashtëdhjetë të shekullit XX

Duke kërkuar dritën

Më duket se Ameti është një nga ata artistë për të cilët pikturimi paraqet një aventurë, pasion dhe eksperiment, dhe që kurrë nuk lodhen në kërkimin e tyre për mundësi të reja të pikturës

Në gjenezën e saj morfologjike dhe mishërimin shpirtëror, Reshat Ameti me të vërtetë i takon rrethit mesdhetar të pikturës moderne, nga Shkolla e Parisit e viteve të pesëdhjeta dhe të gjashtëdhjetë të shekullit XX, të tilla si Pierre Tal-Coat, Jean Le Moal dhe André Lanskoy ose piktorët italianë të sintezës abstrakte -lirike si Renato Birolli, Giuseppe Santomaso, madje edhe idetë e strukturave të gjeometrizuara në pikturat e Emilio Vedova të viteve të gjashtëdhjeta

Iva KÖRBLER

Vepra në lëmin e pikturës e piktorit të shquar bashkëkohor nga Maqedonia Reshat Ameti, nuk mund ta lë indiferent vëzhguesin, sepse aktualisht na lidh jo vetëm me pikturën e peizazhit modern dhe bashkëkohor kroat të Jugut, por, gjithashtu, edhe me shumë opuse të rëndësishme me abstraksion koloristik dhe lirik që thellësisht na është rrënjosur në përvojën vizuale-kulturologjike. Ky artist për të parën herë prezantohet përpara audiencës kroate të artit figurativ me tre cikle gjithëpërfshirëse të pikturave: "Nga Tradita", "Gjeometria lirike" dhe "Dialogu", të cilat në kontinuitet u shfaqën në dhjetë vitet e fundit.

Më duket se Ameti është një nga ata artistë për të cilët pikturimi paraqet një aventurë, pasion dhe eksperiment, dhe që kurrë nuk lodhen në kërkimin e tyre për mundësi të reja të pikturës. Është evidente se nuk e intereson efekti sipërfaqësor dekorativ i pikturës, por ai zhytet më thellë në artikulimin e ndërlikuar të strukturës së pikturës, në dualitetet kompozicionale të cilat burojnë nga gjesti i kontrolluar dhe spontan i pikturës, duke krijuar një armaturë të fortë në pikturë dhe shtresat e buta, të athëta, spontane të pigmentit, në gjurmën e sugjerimit divizionistik të peizazhit: si atij tokësor, ashtu edhe të atij qiellor. Reshat Ameti e kupton se si në pikturë mund të përcillet jeta, ndërsa ajo, nga ana tjetër, përbëhet nga shtresa racionale dhe emocionale, një kaos paksa i kontrolluar, dhe nga ideja e një rendi kozmik. Megjithatë, piktori rrënjësisht dhe në mënyrë të qartë pozicionohet si një artist i cili e feston jetën, vitalizmin dhe rritjen, dhe ku euforia paraqet gjendje natyrore të shpirtit - pavarësisht nëse do të gjejmë frymëzim në natyrën, dashurinë ndaj disa njerëzve apo ide/përvoja të Zotit. Kjo vepër pasionante e artit figurativ do të na kujtojë pjesërisht edhe pikturën e tonit Vatrosllav Kulish, por, gjithashtu, edhe Mesdheun e Matko Trebotiq, ku secili në mënyrën e vet e lidh pjesën gjestuale të pikturës me përvojën e abstraksionit lirik ose koloristik, dhe ku shpesh në një dialog të tensionuar apo harmonik takohen shtresa ikonike strukturore e pikturës, shenja dhe sipërfaqja, me fjalë të tjera, tekstura e lyer apo e tejdukshme e shoqëruar me lëvizjet gestuale- dinamike të furçës.

Në gjenezën e saj morfologjike dhe mishërimin shpirtëror, Reshat Ameti me të vërtetë i takon rrethit mesdhetar të pikturës moderne, nga Shkolla e Parisit e viteve të pesëdhjeta dhe të gjashtëdhjetë të shekullit XX, të tilla si Pierre Tal-Coat, Jean Le Moal dhe André Lanskoy ose piktorët italianë të sintezës abstrakte - lirike si Renato Birolli, Giuseppe Santomaso, madje edhe idetë e strukturave të gjeometrizuara në pikturat e Emilio Vedova të viteve të gjashtëdhjeta. Mundemi pak edhe të ekzagjerojmë dhe të themi se të gjitha këto fenomene dhe stile artistike kanë rrënjët e tyre te Klee, Kandinsky dhe Ernst Wilhelm Nay, ose te piktori abstrakt i Vienës të viteve të njëzeta të shekullit të kaluar, Herbert Boeckl. Nuk guxojmë t'i injorojmë as depërtimet kushtimisht enformelovike në trajtimin reliefik të sipërfaqes së pikturës, kokërrzat abstrakte të pigmentit, ngjitjen e letrës dhe kartonit (cikli "Nga tradita"), të cilat do të na asociojnë sipas përvojave të pikturës së Tapies - por të gjitha ato kahëzime që ne i identifikojmë nuk e zvogëlojnë inventivitetin e botës figurative të Reshat Ametit.

Prandaj, historiania e artit Ana Frangovska vë në dukje se "asociativiteti i i gjurmës enformelit dhe abstraksionit lirik e vendosin këtë artist në kontekstin mesdhetar, duke e definuar atë si një piktor nga trevat tona", e jep kornizën bazë të këtij pikturimi, që jashtëzakonisht në mënyrë komplekse dhe proporcionalisht lëviz midis polaritetit të shenjës dhe gjesteve nga njëra anë, dhe fishekzjarreve të pastra të pigmentit dhe dritës nga ana tjetër. Kjo është një pikturë që është "larë" në përvojën e peizazheve me diell - taksative dhe metaforike- simbolike - ku ndihen fragmente nga tradita etno dhe folklorike e Maqedonisë. Por, në kodin e tij të pastër piktoral, piktura e Ametit ka tendencë që të artikulojë energjitë vitale, me përvoja të ndryshme të ndritshme dhe të errëta, në këndimin piktoral që shënon peizazhin mesdhetar, gjurmët e arhekraolikut (shpirtit), emanacionin e Dritës. Mund të ngajsojë, në momente, se pikturat e Ametit tregojnë qartë për atë dualitet, disonancë të botës ku jemi ne për momentin, por - siç vuri në dukje njëherë kritiku Carmelo Strano për pikturat e Kulmer - edhe te ky artist "ngjyrat, në përmbushjen e vet, gjithmonë janë në funksion të rregullave të harmonisë, ndërsa devijimi është në një lojë të lirë midis shenjave, lëvizjeve dhe materies ". Në kompleksitetin e saj, piktura e Reshat Ametit pasqyron një pamje të balancuar në mënyrë ideale të botës.

Shkrimtari që e refuzoi Çmimin Nobel

Në vitin 1964, Çmimin Nobel për Letërsi, Akademia Suedeze ia dha shkrimtarit francez Zhan Pol Sartër, për veprën e tij, e cila, e mbushur me frymën e lirisë dhe kërkimin për të vërtetën, ka ushtruar një ndikim shumë të gjerë në kohën tonë

Në një njoftim publik, të botuar në "Le Figaro" të datës 23 tetor 1964, Sartri shprehu keqardhjen e tij, bashkë me arsyet e refuzimit të çmimit, dhe dëshironte që ato të bëheshin të ditura. Ai kishte dërguar një letër në adresë të Akademisë Suedeze, për të penguar zgjedhjen e tyre. Në këtë letër, ai specifikoi se refuzimi i tij nuk vinte për shkak të Akademisë Suedeze, por ishte i bazuar në arsye personale dhe objektive të tijat.

"Më vjen shumë keq, për faktin se incidenti është bërë pjesë e një skandali: Çmimi u dha, por unë nuk pranoj atë. Kjo ndodhi sepse unë nuk isha i informuar më herët, për atë që ishte në proces", thuhet në letrën e Sartrit drejtuar Akademisë Suedeze.

Autori e përshkruan veten si një person me bindje socialiste, derisa thekson se është rritur në një familje borgjeze. Ai flet pikërisht për kontradiktat mes lindjes dhe perëndimit.

"Beteja e vetme e mundshme sot në frontin kulturor, është beteja për bashkëjetesën paqësore të të dy kulturave, asaj të Lindjes dhe të Perëndimit. Unë nuk po them që ato duhet ta përqafojnë njëra-tjetrën – unë e di se konfrontimi i këtyre dy kulturave nuk duhet që domosdoshmërish të marrë formën e një konflikti – por ky konfrontim duhet të ndodhë mes njerëzve dhe midis kulturave, pa ndërhyrjen e institucioneve.

Unë vetë jam thellësisht i prekur nga kontradikta mes dy kulturave: Unë jam i përbërë nga kontradikta të tilla. Simpatitë e mia të pamohueshme shkojnë drejt socializmit dhe atij që quhet blloku Lindor, por unë jam lindur dhe rritur në një familje borgjeze dhe në një kulturë borgjeze. Kjo më lejon që të bashkëpunoj me të gjithë ata që kërkojnë të afrojnë të dy kulturat", shkruan autori.

Roboti humanoid i quajtur "Pepper" u hodh në veprim gjatë ekspozitës më të madhe japoneze të arkivoleve dhe objekteve të tjera mortore, ku u shfaq i veshur me një rrobë të gjatë murgu

Mercedes AMG A45, vetura më e shpejtë në botë në kategorinë "hot hatch"

Gjenerata e ardhshme e Mercedes AMG A 45 do të jetë prapë vetura më e shpejtë në botë në këtë kategori, duke kaluar Audi-në RS 3 e ri 2018 që ka 394 kuaj fuqi. AMG ka pasur sukses të madh me versionin e tanishëm të A 45 që ka 376 kuaj fuqi, por me modelin e tanishëm pritet të kenë sukses edhe më të madh në kategorinë e veturave të shkurta me performanca të fuqishme. AMG A 45 i tanishëm ishte "hot hatch" më i shpejtë në botë, me motorin 2.0 litërsh me katër cilindra turbo. Ndërsa tani me modelin që prodhon mbi 400 kuaj fuqi pritet të jetë prapë vetura më e shpejtë në botë në këtë kategori. Mercedes AMG A 45 pritet të dal në shitje në fund të vitit 2018 me një çmim fillestar prej rreth 50 mijë euro.

Ky është Google Pixel 2

Thuhet se pasardhësi nuk është kurrë aq i mirë sa origjinali, por pas daljes së një nga telefonave më të mirë të 2017, Google pretendon të godasë dhe një herë tjetër me Pixel 2. Kompania po punon me HTC-në sërish, dhe suksesi i vitit të kaluar të Pixel, ka qenë një forcë drejtuese në vendimin e tij për të blerë divizonin mobile të kompanisë në fillim të këtij viti. Pixel 2 nuk është shumë larg nga rrënjët e vitit të kaluar, përsa i përket dizajnit. Vitin e kaluar kompania arrit të prodhonte një produkt me pamje mjaft të mirë, një gjë e rrallë në botën e smartphone. Telefoni do të dalë në shitje më 17 tetor dhe do të kushtojë 649 dollarë thotë TechCrunch.



Murgjit japonezë do mbeten pa punë, krijohen robotët priftërinj

Kompania japoneze "Nisseieco Co. Ltd." prezantoi robotin-prift, të programuar për të dhënë një dorë ndihme në tempujt budistë, ku mund të kryejnë detyra të ndryshme, përfshirë atë të leximit të shkrimeve të shenjta gjatë funeraleve. Roboti humanoid i quajtur "Pepper" u hodh në veprim gjatë ekspozitës më të madhe japoneze të arkivoleve dhe objekteve të tjera mortore, ku u shfaq i veshur me një rrobë të gjatë murgu. Sipas këshilltarit ekzekutiv të kompanisë, Michio Inamura, roboti do të jetë në gjendje të përmbushë të gjitha ato detyrime fetare që po neglizhohen çdo ditë e më shumë nga shoqëria. "Numri i familjeve që shkojnë nëpër tempuj e dhurojnë parà është në rënie, e kjo vihet re sidomos në zonat rurale. Një situatë e tillë ka prekur mënyrën e jetesës së priftërinjve, shumë prej të cilëve janë detyruar të gjejnë punë 'part-time' e kështu nuk kanë kohë të lexojne 'sutra'-t në mëngjes e në mbrëmje. Ndaj menduam se 'Peperi' mund ta bënte fare mirë këtë punë", tha Michio Inamura, nga kompania "Nisseieco Co. Ltd.". Roboti, - shton Inamura, - do të ishte edhe një opsion më i lirë për familjet, duke qenë se kushton 50 mijë jenë apo 457 dollarë për funeral, krahasuar me koston tipike të mbi 240 mijë jenëve apo 2.194 dollarëve të kërkuar zakonisht nga priftërinjtë për një ceremoni mortore. Kurioziteti i vizitorëve ka qenë i madh, megjithatë një pjese të tyre sërish nuk i bind ideja që detyrimet fetare mund të përmbushen nga një robot.



90.600 euro kushton Audi A8

Audi ka bërë të ditur çmimin e modelit të ri A8, i cili në Gjermani mund të porositet prej datës 5 tetor. Në fillim do të jenë në dispozicion motorët benzinë 3.0 TFSI dhe dizel 3.0 TDI. Motori benzinë vjen në konfigurimin V6 dhe prodhon 340 kuaj fuqi. Audi A8 me këtë motor nga 0 deri 100 km/h arrin për 5,6 sekonda. Ata që përcaktohen për motorin dizel, po ashtu, mund të llogaritin në agregatin V6, me 286 kuaj fuqi. Audi A8 3.0 TDI nga 0 deri 100 km në orë arrin për 5,9 sekonda. Më vonë, në ofertë do të jetë edhe motori me 4.0 TDI, me 320 kuaj fuqi dhe 4.0 TFSI me 338 kuaj fuqi. Audi A8 kushton në Gjermani 90.600 euro.

Një robot për të kënduar ninullat

E vendosur në qendër të kritikave nga aktivistët, kompania Mattel është tërhequr nga ideja e prodhimit dhe hedhjes në treg të një "kujdestareje fëmijësh" inteligjent. Bëhet fjalë për një pajisje hi-tech e aftë të dallojë gjendjen e fëmijës dhe të reagojë sipas situatave të përshtatshme. Kështu, nëse foshnja qan, atëherë pajisja e quajtur "Aristotle" e porositur nga Mattel do të këndonte ninulla për ta rivënë në gjumë. Projekti është bërë publik

që në muajin janar, por kritikat dhe fushata e aktivistëve detyruan kompanine që të anulonte disa herë hedhjen e saj në treg deri në vendimin e marrë së fundmi për të hequr krejtësisht dorë nga ky projekt. "Aristotle është dizenjuar me një qëllim dhe mision specifik për të ndihmuar prindërit me teknologjinë më të avancuar, që ata ta kenë më të lehtë për të mbrojtur dhe zhvilluar fëmijën e tyre", deklaronte Mattle disa muaj më parë. Megjithatë, aktivistët këmbëngulën dhe në fushatën e tyre e cilësonin joetike përdorimin e inteligjencës artificiale për të rritur fëmijët, qoftë edhe për pak kohë.



Jo, nuk e kam plan shumë të shpejtë që të bëhem trajner, por dua t'i zotëroj. Pak a shumë e tillë ka qenë kjo periudhë për mua, me disa udhëtime të ndryshme nëpër disa vende të botës

Cana tregon sekretet e karrierës

"Kam shfrytëzuar detin që pas Evropianit e deri në vitin e ri për të pushuar me familjen. Që nga janari kam nisur projektin e fondacionit "Lorik Cana 5", i cili ka startuar në Shqipëri dhe shumë shpejt do të ketë degë edhe në Kosovë. Është diçka që më ka marrë pjesën më të madhe të kohës. Gjithashtu, këta 15 muaj i kam shfrytëzuar për të përfunduar edhe dy diplomat e para të UEFA-s për trajner", pohon Cana

Një jetë në futboll, një jetë për Kombëtaren. Legjendat që kanë bërë historinë e futbollit janë të shumtë dhe kanë pak a shumë të njëjtat karakteristika: Kanë mbetur në zemrat e tifozëve, janë shkaktarë të emocioneve të forta, të rrahjeve të shpeshta të zemrës, të brohoritjeve. Njëri prej tyre, që më shumë sesa legjendë e futbollit, është legjendë e Kombëtares shqiptare, i cili të hënën shkelmoi për herë të fundit topin duke i dhënë lamtumirën futbollit të luajtur pas 388 ndeshjeve si futbollist profesionist në klube dhe 93 përballjeve me fanellën e Kombëtares, si asnjë tjetër deri më tani. Lorik Cana, në një rrëfim për "Panorama Sport", para ndeshjes me Italinë që u zhvillua mbrëmë, cek thuajse të gjithë etapat e jetës së tij futbollistike. Nga trajneri me më shumë kontribut në karrierën e tij, te raporti special me De Biazin. Nga momenti më i veçantë, tek emocionet e jashtëzakonshme në Evropian, pengu në atë kompeticion e deri te njeriu special që do ta shoqërojë në fushë kur ai të zbresë për shkelmimin e fundit të topit si futbollist përballë publikut shqiptar.

- Si është jeta e Canës rreth 15 muaj pasi ka lënë futbollin?

CANA: Jeta është e thjeshtë, me familjen, duke kaluar maksimalisht kohë me të. Është mes Italisë dhe Shqipërisë, si dhe vizita më të shpeshta në Kosovë. Kam shfrytëzuar detin që pas Evropianit e deri në vitin e ri për të pushuar me familjen. Që nga janari kam nisur projektin e fondacionit "Lorik Cana 5", i cili ka startuar në Shqipëri dhe shumë shpejt do të ketë degë edhe në Kosovë. Është diçka që më ka marrë pjesën më të madhe të kohës. Gjithashtu, këta 15 muaj i kam shfrytëzuar për të përfunduar edhe dy diplomat e para të UEFA-s për trajner.

- Pra, menjëherë si trajner?

CANA: Jo, nuk e kam plan shumë të shpejtë që të bëhem trajner, por dua t'i zotëroj. Pak a shumë e tillë ka qenë kjo periudhë për mua, me disa udhëtime të ndryshme nëpër disa vende të botës.

- A jeni penduar që e mbyllët kaq shpejt karrierën dhe a do të donit që të luanit edhe pak kohë, apo rrethanat ishin aq të forta sa e mundën dëshirën?

CANA: Arsyet janë shumë të thjeshta dhe kryesorja ishte që për probleme shëndetësore mu desh që të mbyllja karrierën më herët. Nuk e kisha menduar që të ndodhte në moshën 33-vjeçare, pasi besoja që mund të luaja edhe dy apo tre vite, të paktën fizikisht kisha akoma mundësi, pavarësisht se nisa që t'i ndiej vitet. Kisha regjim dhe përkushtim në punë si dhe një formë fizike, e cila më lejonte të luaja deri në moshën 35-36 vjeç. E mbylla me 33 thjesht për arsyen se futbolli i niveleve të larta nisi të bëhet i rrezikshëm për shëndetin, i cili është mbi të gjitha, prandaj e mora këtë vendim.

- Keni bërë njoftimin se do të dilni për herë të fundit para tifozëve në fushë. Çfarë ndjesie kishit përpara saj?

CANA: Në fakt, dëshira ka qenë që të bëhet më herët. Fillimisht ideja ishte që të bëhet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, për faktin se ceremonia e lamtumirës bëhet afër kohës kur e lë futbollin. Tani ka kaluar shumë kohë. Dëshira ishte që të bëhej gjatë një miqësoreje, një takim i posaçëm i përfaqësueses që të isha disa minuta në fushë duke luajtur herën e fundit që do të lija futbollin. Mirëpo, kompeticioni, planet dhe programi nuk e mundësuan diçka të tillë. E morëm vendimin, maksimumi brenda një muaji për ta organizuar duke folur me familjen, me federatën dhe me miqtë. Është vonë, por e bëra se duhej të bëj një përshëndetje me njerëzit në ndeshjen e fundit që u luajt në vendin tonë.

- Pas njoftimit, grupimi "Tifozat Kuq e Zi" bënë një letër të hapur ku ju kërkuan ta shtynit për shkak të bojkotit të tyre. A keni biseduar me ta?

CANA: Patjetër që kam komunikuar. Arsyeja pse nuk u jam drejtuar me letër publike është fakti që i njoh ata djem dhe kam preferuar të sqarohem vetë me ta pse ishte vendosur kjo ndeshje dhe pse nuk mund të shtyhej, si dhe pse ky vendim është marrë kaq vonë. Nuk është se e kemi ditur para disa muajsh që do të bëjmë këtë ceremoni. Jam sqaruar me ta për arsyet pse u vendos në moment të fundit për faktin që kjo ceremoni, ose mund të bëhej tani, ose nuk mund të bëhej më fare. Ndeshja e fundit me shumë njerëz në stadium ishte kjo kualifikuese me Italinë, pasi në nëntor nuk dihet në do të kemi apo jo miqësore, me cilin kundërshtar dhe nëse do të jetë brenda apo jashtë vendit tonë. Ndeshja e madhe me Italinë është i vetmi organizim apo manifestim ku mund të bëhet lamtumira. Arsyeja pse nuk mund të shtyhej ishte vetëm për faktin se edhe 15 muaj pasi e kam lënë futbollin, është shumë vonë e jo më ta shtyjmë për vitin e ardhshëm që nuk ka më sens.

- Si ishte reagimi i tyre?

CANA: Sigurisht ata shprehën keqardhjen që kanë vendosur brenda grupimit që të vazhdojnë me qëndrimin që kanë. Është absolutisht e drejta e tyre. Unë ua kam thënë me mirënjohje që të gjithë atë mbështetje që kemi pasur prej tyre, madje unë e ndiej vetë veten "Tifoz Kuq e Zi". Jam i pari që do të doja të ishin në stadium, pasi edhe në ndeshje, ku nuk ka pasur gati asnjë tifoz, ata kanë qenë prezent në stadium duke na mbështetur dhe duke përfaqësuar vlerat dhe dëshirën e çdo shqiptari. Ata kanë pozicionin e tyre. Unë u mundova që t'ua ndërroj mendjen dhe që nuk do të jetë e njëjta pa ata, mirëpo e mirëkuptoj pozicionin e tyre dhe absolutisht që vlerësimi për ta nuk do të ndryshojë. Mendimi im për ta nuk do të lëvizë fare.

- Si e keni parë Kombëtaren kohët e fundit, çfarë po bën mirë dhe ku po çalon?

CANA: Në aspektin teknik, besoj që Kombëtarja ka disa baza dhe siguri, e cila e bën një kombëtare të mirë në skenën evropiane. Këtë e ka demonstruar këto katër vitet e fundit, ku ka treguar se është një përfaqësuese që ka bazë solide dhe mbetet kundërshtar i fortë. Mirëpo, deri edicionin e kaluar dhe në miqësoren kundër Luksemburgut, gjërat nuk shkonin siç ishte planifikuar, sidomos në aspektin e rezultateve. Por ekipi tregoi shumë karakter dhe kuptoi që ka me të vërtetë detyrime dhe kërkesa e më pas bëri një kthesë të jashtëzakonshme në Izrael duke treguar disa vlera, duke u bazuar në forcat e saj dhe duke luajtur të gjithë me të njëjtin mentalitet.

- Duke qenë se e njihni mirë shkollën italiane, si e keni parë Panuçin në këto tri ndeshje të para?

CANA: Shkolla italiane e trajningut është ndër më të mirat në botë dhe jo rastësisht ka trajnerë italianë që drejtojnë klube brenda dhe jashtë Italisë. Kemi pasur një eksperiencë shumë të mirë me Xhanin, i cili ka ndikuar që Shqipëria të bëjë disa hapa përpara dhe të arrijë për herë të parë që të kualifikohet. Më tej, i është besuar një trajneri italian, i cili është në nisjen e karrierës së tij dhe besoj që e ka marrë me shumë dëshirë dhe me shumë zemër punën me Kombëtaren. Absolutisht, duket në mënyrën se si flet, se si punon dhe që e ka me shumë dëshirë që të arrijë të tregojë veten nëpërmjet Shqipërisë. Duke parë që ndeshjet e para ishin të tilla që fillimisht ai nuk e njihte ekipin dhe mundohej që të bënte një ide sa më të mirë të grupit duke e kryer detyrën sa më mirë dhe duke fituar kundër Lihtenshtejnit. Kundër Maqedonisë nuk kam qenë në stadium, por e kam ndjekur në televizion. Aty trajneri duhet të tregojë se në çfarë mënyre ai mundet që të ndikojë sa më mirë në skuadër në momente të vështira gjatë ndeshjes, por edhe me një rezultat që them se na mundëson të rrimë në vendin e tretë. Gjithsesi, çdo ndeshje ka të mira dhe gjëra për të përmirësuar, por është detyra e tij që të marrë sa më shumë informacione dhe të përgjigjet sa më mirë gjatë ndeshjeve.

- Lorik, cilin veçoni si momentin më të bukur në karrierë?

CANA: Momenti më i bukur në karrierë patjetër që është kur u kualifikuam me Shqipërinë në Evropian. Sidomos pas një rrugëtimi të gjatë dhe pas një faze kualifikueses të Evropianit që ishte me emocione të ndryshme, të jashtëzakonshme plot me hidhërime dhe momente të veçanta. Kur u kualifikuam në Armeni, ishte diçka speciale në karrierë. Patjetër që kur mbërrin në Evropian është ajo për çfarë ke luftuar dhe është me të vërtetë një arritje e jashtëzakonshme. Ka pasur shumë momente, por këto me Kombëtaren i veçoj, pasi çdo ndjenjë dhe çdo emocion është i shumëfishuar.

- Cilën veçoni, Armeninë (ndeshja që na kualifikoi) apo Rumaninë (fitorja e parë në Evropian)?

CANA: Besoj që të dyja janë të veçanta. Armenia ka qenë fryti dhe arritja e një ëndrre e të gjithë lojtarëve. Kanë qenë dy emocione të ndryshme, pasi e para ka qenë një shpërthim emocionesh të vite e vite pune dhe ëndrre për t'ua realizuar njerëzve mundësinë për të parë vendin e tyre atje. Kur e di që e ke realizuar, në fillim është më e vështirë sa u përket emocioneve dhe prandaj ke ndjenja më të forta. Me Rumaninë ka qenë më shumë një gëzim dhe duke e shijuar atë që arritëm. Është njësoj sikur një person, pas një pune shumë të madhe, në fund e shijon. Ajo ishte një festë me gati 30 mijë shqiptarë në stadium, si një skenar, si një ëndërr e shkruar. Fatkeqësisht, nuk na mjaftoi që t'i kalonim grupet, ku mund edhe të kishim pretenduar, por besoj se e kemi bërë një punë të mirë.

- Cilin trajner veçon Lorik Cana gjatë karrierës?

CANA: Do të mundohem të gjej nga një në dy drejtimet. Trajneri në klub, i cili ka bërë shumë, kam pasur një lidhje të fortë në përvojë dhe eksperiencë ka qenë Erik Gerets, trajneri belg kur isha te Olimpik Marseja. Në Kombëtare ka qenë Xhani, pasi, përveç raportit, është kurorëzuar edhe me një arritje të madhe. Këta janë dy trajnerët që i veçoj në karrierën time.

- Kur do ta shohim sërish Lorikun në Kombëtare?

CANA: Për të pasur një rol, për momentin nuk është absolutisht në planet e mia. Nëse një ditë do të vendos, do të kem dëshirë që të bëhem trajner i përfaqësueses dhe gjithashtu mundësinë që ta drejtoj një Kombëtare, do ta bëj me gjithë qejf. Mirëpo, ajo do të vijë vetëm nga dëshira ime dhe nuk do të vijë nëse mendohet se Loriku do të vijë. Jo, Loriku duhet ta ketë dëshirë vetë kur të mendojë se është i aftë për ta bërë diçka të tillë. Vetëm në këtë rast do të kandidoj, por për momentin nuk e kam as dëshirën dhe as nuk mendoj se jam mjaftueshëm i kualifikuar.

Republika e Maqedonisë
Ministria e shëndetësisë

Nr. _____
_____2017

Shkup

Ministria e shëndetësisë
50-ta Divizija pn,
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë
Tel. (02) 3112 500
Sajt: www.moh.gov.mk

Në bazë të nenit 55 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të drejtorisë shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) Ministria e shëndetësisë në vijim ka sjellë

Në pajtim me **Programin për mbrojtje të banorëve nga HIV/SIDA në Republikën e Maqedonisë për vitin 2017** (Gazeta Zyrtare e RM nr. 118/17), Ministria e shëndetësisë publikon

Thirrje publike
Për shprehje të interesimit për pjesëmarrje në shoqata të qytetarëve në realizimin e Programit për mbrojtje të banorëve nga HIV/SIDA në Republikën e Maqedonisë për vitin 2017

Lloji i aktiviteteve të cilat do të mbështeten

Mjetet të cilat janë siguruar në kuadër të Programit për vitin 2017 paraqesin bashkëfinancim së bashku me mjetet e siguruara në kuadër të projektit Mirëmbajtje të prevalencës së ulët të HIV-it në RM, zhvillim të qëndrueshëm, të financuar nga donator të jashtëm – Fondi global për luftë kundër HIV/SIDA-s, tuberkulozit dhe malaries dhe në atë drejtim tragetet e vendosura kanë të bëjnë me nivelin nacional dhe të njëjtat do të realizohen në korrelacion me projektin e Fondit global. Në kuadër të kësaj Thirrje publike në mënyrë financiare do të mbështeten aktivitet programore në sferat e veprimit në vijim;

1. Preventiva nga HIV tek grupet e ekspozuara ndaj rrezikut më të madh

1.1 Preventiva nga HIV mes MSM (meshkujve që bëjnë seks me meshkuj),
1.2 Preventiva nga HIV mes PID (personave që injektojnë droga)
1.3 Preventiva nga HIV mes PS (punëtorëve të seksit)

2. HIV Testimi dhe Këshillimi

3. Diagnoza dhe trajtimi me ITS (infektimet e transmetuara seksuale)

1.1. Preventiva nga HIV mes MSM – Në kuadër të kësaj sfere të veprimit, janë ndarë gjithsej **951.000 denarë.** Me të njëjtat është paraparë të përfshihen me pako themelore të shërbimit (prezervativ, lubrikant dhe material edukativ), gjithsej 2.173 persona (MSM) prej të cilëve 110 të rinj (të përfshirë për herë të parë). Aktivitetet të cilat financohen duhet të jenë të orientuara në drejtim të rritjes së shtrirjes së kësaj popullate, aktiviteteve që kanë të bëjnë me funksionimin e këshillimores në Shkup: këshillim të drejtpërdrejtë, përmes info linjës dhe ueb portalit, mbështetjes psikosociale për personat, si dhe aktivitete në terren në Shkup dhe në katër qytete tjera në shtet. Me këtë aktivitet janë të nevojshme të ndahen gjithsej 9.780 prezervativë, 7.600 lubrikante dhe 4.350 materiale edukativo-informative.

1.2 Preventivë nga HIV mes PID – Në kuadër të kësaj sfere të veprimit janë ndarë gjithsej **3.060.000 denarë**. Me të njëjtën janë paraparë të përfshihen me pakon themelore të shërbimit (set prej një gjilpëre dhe një shiringu, prezervativë dhe material edukativ) gjithsej 2.140 persona nga popullata e synuar, prej të cilëve 170 të rinj (të përfshirë për herë të parë) në kuadër të programeve tash më të vendosura për uljes së dëmeve nga përdorimi i drogave gjegjësisht programeve për shkëmbim të gjilpërave dhe shiringjeve, gjithsej 16: 3 (tre) në Shkup dhe nga një në 13 qytetet e tjera edhe atë Tetovë, Gostivar, Manastir, Ohër, Strugë, Veles, Kërçovë, Prilep, Kavadar, Shtip, Strumicë, Gjevgjeli dhe Kumanovë. Me këtë aktivitet është e nevojshme të ndahen 222.680 sete të gjilpërave dhe shiringjeve, 13.250 prezervativëve dhe 5.000 materialeve edukativo-informative. Për secilin program janë paraparë mjete financiare në shumë prej **191.250** denarë.

1.3 Preventiva nga HIV mes PS – Në kuadër të kësaj sfere të veprimit janë ndarë gjithsej **1.316.000 denarë**. Me të njëjtën është paraparë të përfshihen me pako themelore të shërbimit (prezervativë, lubrikant dhe materiale edukative) gjithsej 758 persona nga popullata e synuar prej të cilëve 67 të rinj (të përfshirë për herë të parë), në programet tash më të vendosura në 7 qytete nëpër Maqedoni: Shkup (dy), Tetovë, Gostivar, Ohër, Manastir, Strumicë dhe Gjevgjeli. Me aktivitetin është e nevojshme të ndahen gjithsej 35.750 prezervativë, 11.900 lubrikante dhe 4.550 materiale edukativo-informative. Për secilin program veç e veç janë paraparë mjete financiare në shumë prej 165.000 denarë.

2. HIV Testimi dhe Këshillimi – Në kuadër të kësaj sfere të veprimit janë ndarë gjithsej **1.440.000 denarë** dhe do të mbështeten aktivitete në lidhje me këshillimin dhe testimin në terren, realizimi përmes dy makinave mobile për terren, të pajisura për atë qëllim, të organizuara në gjithsej 106 ndërrime, si dhe përmes testimit. Me të njëjtën është paraparë të përfshihen 684 persona me pako themelore të shërbimit (para këshillimit, testimit me test të shpejtë për HIV dhe pas këshillimit) në Shkup dhe në 13 qytete të tjera të vendit: Tetovë, Gostivar, Veles, Kërçovë, Prilep, Ohër, Manastir, Kavadar, Shtip, Strumicë, Gjevgjeli dhe Kumanovë. Aktivitetet të cilat financohen duhet të orientohen kryesisht në drejtim të rritjes së shtrirjes së personave përfaqësues të popullatës së synuar të cilët janë të testuar për HIV edhe atë: MSM (336 persona), Të dënuar (60 persona), PID (204 persona) dhe PS (84). Këshillimi dhe testimi duhet të jetë vullnetar dhe i besueshëm dhe të realizohet nga persona të cilët kanë kaluar trajnim paraprak për Këshillim dhe testim. Ekipet në terren është e nevojshme të jenë të përbërë prej tre personave (këshillues, laborant dhe gejtkiper)

3. Diagnoza dhe trajtimi me ITS (infektimet e transmetuara përmes seksit)

Me këtë aktivitet do të mbështetet funksionimi i shërbimeve shoqërore për shëndet seksual dhe reproduktiv (SHSR) në Shkup. Me të njëjtit planifikohet të rritet mundësia për të patur qasje në shërbime kualitative për SHSR të njerëzve nga popullatat kyçe (MSM, PID, PS dhe personat të cilët jetojnë me HIV dhe partnerët e tyre). Me këtë aktivitet është e nevojshme të përfshihen 180 klientë nga popullata e synuar: MSM (80), PS (90) dhe PID (10) dhe të bëhen gjithsej **280** teste për ITS (sifiliz, gonorreja, hepatiti B dhe hepatiti C, klamidia dhe trikomonas), dhe **180 HIV** teste të shpejta klientët të fitojnë edhe HIV testim dhe këshillim. Për këtë aktivitet programor janë ndarë gjithsej mjete financiare në shumë prej **630.000 denarë**.

4. **Korniza kohore dhe gjithsej mjetet e parapara/të mundshme**

Mjetet janë planifikuar për periudhën tetor-dhjetor të vitit 2017. Mjetet duhet të shfrytëzohen vetëm për qëllimet dhe do të specifikohen në mënyrë të detajuar në marrëveshjen mes shoqatës dhe Ministrisë së shëndetësisë.

5. Kriteret e përgjithshme që duhet t'i përmbushin shoqatat të cilat marrin pjesë në këtë thirrje janë:

Organizata qytetare të ketë regjistrim me qëllime dhe veprimtari përkatëse në regjistrin e Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione

- Të disponojë me kushte përkatëse kadrovike dhe hapësinore,
- Të ketë punë aktive në sferën e preventivës nga HIV së paku tre vjet nga dita e themelimit.

6. Për themelimin e aktiviteteve për preventivë nga HIV mes grupeve me rrezik të posaçëm nga HIV (meshkuj që bëjnë seks me meshkuj, punëtorët/et e seksit dhe personat që injektojnë drogë), shoqatat qytetare duhet të përmbushin së paku një prej kushteve të posaçme në vijim:

- Të kenë të realizuar së paku tri projekte, gjegjësisht së paku një projekt shumëvjeçar me kohëzgjatje jo më pak se tre vjet nga sfera e preventivës ndaj HIV mes grupit përkatës nën rrezik, në mënyrë të pavarur ose në partneritet të përfshirë, udhëheqje me shërbime stacionare dhe/ose në terren,
- Të kenë të realizuar së paku një projekt me kohëzgjatje jo më pak se dy vjet nga sfera e preventivës nga HIV mes grupeve me rrezik, duke përfshirë udhëheqje me shërbime stacionare dhe/ose në terren, nëse bëhet fjalë për organizatë të vet bashkësisë.

7.Dokumentacioni i nevojshëm që shoqatat duhet të parashtrojnë

Krahas formularit të unifikuar të plotësuar në mënyrë kompjuterike, të nënshkruar nga përfaqësuesi i shoqatës dhe të vulosur me vulë të shoqatës, shoqata është e obliguar që të parashtrojë në mënyrë të bashkëngjitur edhe:

7.1 Gjendjen aktuale nga Regjistri qendror (jo më të vjetër se 6 muaj);
7.2 Statutin e shoqatës;
7.3 Programin për punë ose kornizë strategjike të shoqatës;
7.4 Dëshmi për ekspertizë përkatëse në problematikën për të cilën është parashtruar kërkesa për mjetet financiare, gjegjësisht dëshmi për përmbushje të së paku një prej kushteve të posaçme për realizimin e aktiviteteve për preventivë nga HIV mes grupeve të synuara të Programit:
7.5 Kopje të marrëveshjes/ve të lidhur/a për realizim të projektit/ve nga sfera përkatëse me donator/ë të projektit/ve
7.6 Kopje të llogarisë përfundimtare;
7.7 Dëshmi për përmbushje të kushteve për hapësirë përkatëse për punë – Kopje të listës pronësore/listës poseduese ose kopje të marrëveshjes për qira të pronës;
7.8 Dëshmi për përmbushjen e kushteve për kushte kadrovike – Deklaratë të shoqatës për personel të angazhuar; biografi profesionale të personave të cilët do të jenë të angazhuar në realizimin e projektit (në formularin e përcaktuar që është pjesë e kësaj thirrje publike);
7.9 Së paku një mendim/referencë nga partnerë ose donatorë për realizim të projekteve të mëhershme dhe
7.10 Mbështetje me shkrim nga organizata të tjera ose institucione për të cilat është planifikuar të marrin pjesë në realizimin e projektit (kjo ka të bëjë nëse projekti realizohet në partneritet me organizatë/institucion tjetër).

8. Afatet për realizimin e procedurës

8.1. Thirrja publike zgjatë 5 ditë nga dita e publikimit;
8.2. Afati përfundimtar për parashtrimin e dokumentacionit të nevojshëm është deri në ora 15 të ditës së fundit të thirrjes publike;
8.3. Komisioni për zgjedhje të shoqatave që do të realizojnë aktivitete të Programit për mbrojtje të banorëve HIV/SIDA në Republikën e Maqedonisë për vitin 2017 që është formuar me Vendim të Ministrisë së shëndetësisë është përgjegjës për përzgjedhje të aplikuesve.
8.4. Komisioni për zgjedhje të shoqatave, të cilat do të realizojnë aktivitete të Programit për mbrojtje të banorëve nga HIV/SIDA në Republikën e Maqedonisë për vitin 2017 sjellë vendim për zgjedhje të shoqatave në afat prej 10 ditëve nga afati përfundimtar i thirrjes publike;
8.5. Ministri i shëndetësisë në afat prej 5 ditëve pas sjelljes së mendimit nga ana e Komisionit, sjellë vendim për zgjedhje dhe ndarje të mjeteve dhe me shkrim do t'i informojë të gjithë aplikuesit për zgjedhjen.

9. Mënyra e parashtrimit të fletëparaqitjeve

Dokumentacioni i tërësishëm duhet të parashtrohet përmes postës në zarf të mbyllur në adresën: Ministria e shëndetësisë, 50 Divizija 6, 1000 Shkup përmes arkivit të Ministrisë së shëndetësisë deri në ora 15 (me shenjë – Sektori për mbrojtje primare dhe preventive shëndetësore – Fletëparaqitje për thirrje publike).

Shoqatat pjesëmarrëse në thirrjen publike do të informohen për rezultatet në afat prej 5 ditëve nga dita e sjelljes Vendimit për zgjedhje dhe ndarje të mjeteve nga Programi për mbrojtje të banorëve nga HIV/SIDA në Republikën e Maqedonisë për vitin 2017, dedikuar për financim të aktiviteteve programore të shoqatave.

Formuari për aplikim dhe formulari për biografi profesionale të personave të angazhuar për propozim projektin, janë të mundshëm në internet faqen e Ministrisë së shëndetësisë www.moh.gov.mk

Pyetje për qartësim mund të parashtrohen me shkrim ose në mënyrë elektronike deri tek Nermina Fakoviq, Sektori për mbrojtje primare dhe preventive shëndetësore.

Kontakt tel. +38923112500 lokal 123 e-mail: nermina.fakovic@zdravstvo.gov.mk

Adresa: Ministria e shëndetësisë, 50 Divizija 14, 1000 Shkup

Propozim projektet e aplikuesve që nuk i përmbushin kriteret themelore në lidhje me ekspertizën për HIV nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

I jam shumë mirënjohës Bajernit dhe drejtuesve të tij. Kjo është skuadra që më bëri ky që jam sot. Bajern Munih është një skuadër me shumë potencial dhe kualitet. Kam bindjen dhe besimin se tani skuadra do të tregojë një profil krejt të ndryshëm

Sarri qëndron me këmbë në tokë

Juventusi mbetet favorit

Juventusi aktual është nga më të fortat e 7-8 viteve të fundit dhe mbetet favorite. Do të ishte mendjemadhësi të krahasohesh me ta, padiskutim që janë të një niveli tjetër", pohon trajneri i Napolit

Këtij Napoli që ka magjepsur tashmë jo vetëm tifozët e saj me serinë e fitoreve dhe me sulmin më të mirë prej 25 golash e me një lojë të shkëlqyer në fushë, i qëndron me këmbë në tokë Maurizio Sarri, i cili predikon të ruhet qetësia dhe modestia pasi pavarësisht gjithë ecurisë mbresëlënëse të skuadrës së tij favoritja e Serisë A mbetet Juventusi. "Juventusi aktual është nga më të fortat e 7-8 viteve të fundit dhe mbetet favorite. Do të ishte mendjemadhësi të krahasohesh me ta, padiskutim që janë të një niveli tjetër", pohon trajneri i Napolit. Edhe pas 7 fitoreve radhazi në kampionat njëherazi në vitin e dytë të radhazi pjesëmarrës në "Champions", janë tregues se projekti i Sarrit po jep frytet e tij, ndaj lind pyetja nëse Napoli do të vijojë të jetë pjesë e planeve të tij. "Të flasësh që tani për kryesimin e kampionatit është diçka relative, sepse rruga që kemi përshkruar është shumë e shkurtër për t'u konsideruar si tregues. Gjithashtu është folur shumë për klauzolën në kontratën time, është e vërtetë që ekziston, por për momentin e ardhmja nuk është prioritet në mendimet e mia. Gjithsesi, mund të them se ndihem shumë i lidhur me këtë grup dhe me këtë qytet, do të preferoja që t'i lija gjërat të ecnin në mënyrë natyrale. Një falënderim shkon edhe për Presidentin De Laurentis, i cili më mbështeti që në fillim", shton më tej Sarri. Nuk entuziazmohet lehtë 58-vjeçari edhe pse për sfidën me Romën pretendon se edhe pse një skuadër e fortë Napoli i tij ka marrë një tjetër hov krahasuar me ta. Lidhur me mundësinë se mund të kishte qenë trajneri i Milanit nëse Berluskoni do të kishte marrë në konsideratë fjalët e Arrigo Sakit, Maurizio Sarri deklaron. "Si fillim bashkëpunimi ynë nuk do të kishte zgjatur. Nëse gjithçka që thuhet për të si President ka qenë e vërtetë. Gjithsesi, një President që nuk di të sillet zor se merr fitore dhe në të vërtetë sukseset e Berluskonit kanë qenë të shumta, ndaj mendoj se kjo është më shumë legjendë urbane se sa e vërteta. Sa i takon Sakit krahasimi është fyes për Arrigon. Ai ka fituar shumë, unë asgjë. Saki ka shkruar historinë e futbolit në rezultate dhe inovacionin që ka sjellë", thekson trajneri napolitan. Lidhur me trajnerin që qëndron më shumë pranë tij në mënyrën se ai e percepton futbollin, Sarri shtoi. "Një trajner që ndoshta është afër mënyrës time të të menduarit është Marko Giampaolo e sa i përket sistemit Var, mund të shtoj se jam skeptik. Teknologjia i heq spontanitetin dhe entuziazmin futbollit. Jam për një përdorim të moderuar të tij", përfundoi trajneri i Napolit.

Shkurt

Viali kritikon përforcimet e Milanit

Ish-sulmuesi i Juventusit Xhanluka Viali ka komentuar zgjedhjet e Milanit në merkaton e verës, në veçanti ato për repartin e sulmit. Shumë para të investuara sipas komentatorit teknik, që për mikrofonat e "Sky Calcio Club" u shpreh. "Nëse do të isha drejtues i Milanit, nuk do të kisha marrë Kaliniçin dhe Çalhanoglu ashtu si edhe Andre Silvan, dhe të gjitha paratë do t'i kisha shpenzuar për Andrea Belottin për sulmin", tha Viali. Pas shtatë javëve Serie A, kuqezinjtë regjistrojnë 4 fitore dhe 3 humbje, ku dy të fundit erdhën njëra pas tjetrës, ndaj Sampdorias dhe Romas (të dyja 2-0). Sfida e radhës për trajnerin Montella është delikate, në derbi me Interin e vendit të tretë me 19 pikë.

• • •

Mustafi jashtë fushave për një kohë të gjatë

Mbrojtësi shqiptar, Shkodran Mustafi ka pësuar një lëndim që do ta lërë jashtë fushave për një kohë të gjatë. Këtë e ka konfirmuar trajneri i kombëtares gjermane, Joakim Lev. Mustafi u lëndua gjatë angazhimit me kombëtaren gjermane në fitoren prej 5 me 1 ndaj Azerbajxhanit në kualifikimet për Botëror. "Mustafi duket se ka lënduar muskujt, që në çdo rast mund ta lë atë për një kohë më të gjatë", është shprehur Lev.

• • •

Hernandez nuk laroghet nga Uest Hemi

Havier Hernandez nuk do të rikthehet në Spanjë. Sulmuesi meksikan së fundmi është piketuar nga mediat spanjolle për një transferim te Valencia ose Villarreal duke e lidhur këtë lëvizje për t'i qëndruar më pranë të dashurës së tij, aktores spanjolle Andrea Duro por është vetë lojtari që ka reaguar duke mohuar gjithçka. 29-vjeçari shkruajti në "Twitter" se gjithçka është shkruar nuk ka asnjë bazë dhe se është i lumtur te Uest Hem.

• • •

Sanja i ofrohet Interit dhe Milanit

Mediat italiane raportojnë se mbrojtësi francez, Bakari Sanja, i cili është futbollist i lirë i është ofruar gjigantëve nga Serie A, Interit dhe Milanit. 34-vjeçari francez ka qenë pa klub që nga lirimi i tij nga skuadra e madhe angleze, Mançester Siti, në fund të sezonit të kaluar. Megjithatë, sipas "FcInterNews.it", mbrojtësi i djathtë është i gatshëm të përfundojë karrierën e tij në Itali apo më saktë në kampionati elitar, Serie A. Si i tillë, agjenti i francezit i ka njoftuar të dy klubet nga "San Siro", Interin dhe Milanin se klienti i tij do të jetë i gatshëm të nënshkruajë për ta në qoftë se i jepet mundësia. Mediumi italian pretendon se opsioni i preferuar i Sanjas do të ishte bashkimi me Interin. Megjithatë, francezi është gjithashtu i hapur për mundësinë e nënshkrimit me Milanin.

Droni në Beograd

"Triumph" debuton në Poloni

Nata dramatike Tetorit të vitit 2014 në Beograd përjetësohet edhe në një film kushtuar momenteve që ndryshuan rrjedhën e historisë së futbollit shqiptar por edhe të marrëdhënieve mes dy popujve. Regjisorët Kreshnik Jonuzi dhe Luftar Von Rama kanë përfunduar punën për filin e titulluar "Triumph", premiera e të cilit do të shfaqet në Festivalin e Filmit të Varshavës që do të zhvillohet në datat 19-, 20 dhe 21 Tetor ku bota do të njihet me një pjesë të madhe të të vërtetave të asaj nate që mund të kishte përfunduar në një tragjedi. Në këtë film në formatin e një dokumentari, pasqyrohen detajet e momenteve dramatike në stadiumin e Partizanit të Beogradit ku Shqipëria dhe Serbia u ndeshën për sfidën eliminatore të Euro 2016, por situata doli jashtë kontrollit pas shfaqjes së dronit me simbolet kombëtare shqiptare mbi kokat e tifozëve të zemëruar serbë. Jonuzi shprehet se titulli "Triumf" pasqyron ndjesinë e shqiptarëve pas asaj nate të mbushur me ngjarje kontroverse. Filmi dokumentar është 88 minuta i gjatë dhe përfshin intervista e momente të veçanta si atmosfera përreth ekipit kuqezi. Ky film ka pasur një buxhet të ulët dhe për realizimin e tij kanë kontribuar komunitetet shqiptare në SHBA.

Grizman, objektivi i Barcelonës në vitin 2018

Antoine Grizman është, sipas "Mundo Deportivo", objektivi i madh i Barcelonës për verën e vitit 2018. Mësohet se klubi katalanas do t'i mbyllë llogaritë me francezin përpara se të bashkohet avantazhi i klauzolës së përfundimit të kontratës së futbollistit, që shkoi deri në 100 milionë euro këtë verë. Atletiko Madrid është i bindur për të rinovuar me Grizman, ndaj ka vendosur një mburojë kontraktuale këtë verë me 200 milionë euro për largimin, me kusht që ta ulë atë verën e ardhshme. Grizman, kësisoji, do të parakalonte Kutinjon në planet e Barcelonës. Lojtari nuk dëshiron të largohet nga La Liga dhe Barça, me Messin, që shkon 31 vjeç në sezonin e ardhshëm, do të përgatisë mënyrën për të pasur një lojtar të ri. Përveç Grizman, një tjetër emër i pranishëm në axhendën e Barcelonës është ai i mesfushorit të Totenhemit, Dele Alli. Katalanasja "Sport" e ka në kopertinën e vet këtë lajm sot dhe



njofton se Barça e ka atë si një alternativë ndaj Kutinjos.

Shkupi në Manstir përballet me Pelisterin

Mifatri pret fitore në debutim

Shkup, 9 tetor – Skuadra e basketbollit Shkupi sot (e martë) do ta zhvillojë ndeshjen e parë në elitën e basketbollit vendor. Kundërshtari i parë i skuadrës shkupjane do të jetë Pelisteri, ndeshje kjo e cila do të zhvillohet në palestrën në Manastir. Ndryshe, trajneri i kësaj skuadre Enver Miftari për gazetën KOHA shprehet i lumtur që skuadra e tij do të ketë mundësi të bartet me skuadrat e Ligës së parë. "Sigurisht se në Manastir shkojmë për të fituar ndeshjen. Jemi në pritje të dy basketbollistëve amerikan dhe nëse ata vijnë dhe nëse kemi referim real, nuk besoj se do të kemi probleme të mposhtim Pelisterin", shprehet Miftari, i cili ka folur edhe për përforcimet që këtë afat iu bashkuan ekipit. "Përmenda se jemi në pritje të dy lojtarëve amerikan, ndërsa nga KB "Gostivar" kanë arritur katër përforcime, Bullatoviçi, Ilijevski, Gogoçevi dhe Ristovi. Poashtu në ekip është rikthyer Besart Mehmeti, i cili së fundmi luante në Gjermani si dhe Artan Nika, i cili ka luajtur në Austri. Njëherit këta të fundit kanë qenë edhe shtylla kryesore për U 20 të KB Shkupit, kohën kur ishim kampion të Maqedonisë. Dua të përmend faktin se koha për të sjell lojtar më cilësor nuk na lejoi koha, ndërsa këtë presim ta bëjmë në të ardhmen", deklaroi për KOHA, Miftari. Pelisteri – Shkupi luhet sot (e martë) në ora 16.30. *(B.K.)*

Për cilësitë e mia duhet të flasë trajneri dhe të tjerët, unë duhet të punoj çdo ditë që të përmirësohem. Përpiqem gjithmonë të parashikoj lëvizjet e sulmuesve. Trajneri im më ka thënë se nuk duhet ta bëj shpesh sepse mund të ndëshkohem

Tabarez: Messi nuk mund të bëjë gjithçka për Argjentinën

Messi dhe Argjentina ishin në pozitën e dytë në Kupën e Botës 2014, por gjigandët e Amerikës Jugore janë në rrezik të vërtetë që të humbasin turneun e vitit të ardhshëm në Rusi. Një barazim i pamëshirshëm në shtëpi me Perunë e la Argjentinën të gjashtën në renditjen e "CONMEBOL", me një kualifikuese të mbetur, kundër Ekuadorit, të martën

Oskar Tabarez nuk beson se dështimi për t'u kualifikuar në Kupën e Botës do të lërë një njollë në karrierën e shquar të Lionel Messit, pasi trajneri i Uruguait këmbënguli se fituesi i pesë herë "Topit të Artë" nuk mund të bëjë gjithçka për Argjentinën. Messi dhe Argjentina ishin në pozitën e dytë në Kupën e Botës 2014, por gjigandët e Amerikës Jugore janë në rrezik të vërtetë që të humbasin turneun e vitit të ardhshëm në Rusi. Një barazim i pamëshirshëm në shtëpi me Perunë e la Argjentinën të gjashtën në renditjen e "CONMEBOL", me një kualifikuese të mbetur, kundër Ekuadorit, të martën. Messi arriti të shkëlqejë personalisht në ndeshjen e Buenos Aires javën e kaluar, ndërsa, gjithashtu, krijoi mundësi për shokët e ekipit, Dario Benedetto, Emiliano Rigoni dhe Markus Akuna, ndaj trajneri i Uruguait, Tabarez, tha se ylli i Barcelonës ka nevojë për mbështetje, nëse dy herë kampionët e Argjentinës duan të kualifikohen për një Kupë Botërore, të 12-tën e njëpasnjëshme. "Unë nuk e shoh atë si një njollë dhe nuk duhet të jetë kështu", – tha Tabarez, kur u pyet nëse mosshkuarja në "Rusia 2018" do të ishte një minus në karrierën e Messit. – Ka shumë lojtarë të mëdhenj në historinë e futbollit që nuk ishin kampionë botërorë dhe ata nuk janë të ngjyrosur nga kjo, të paktën për mua. Përveç kësaj, Messi ende po luan, nuk mund të thuash se çfarë do të ndodhë. Argjentina ka probleme për t'u kualifikuar, por nëse ia del kësaj, do të jetë favorite për të fituar Kupën e Botës. Messi është një lojtar i madh, por nuk mund të bëjë gjithçka, ky është një sport ekipor. Ai luan me lavdërime për atë që është më i miri, por duke marrë të gjithë fajin mbi supe, kur gjërat nuk shkojnë mirë, edhe kur ai nuk është përgjegjës, kjo nuk shkon. Futbolli nuk është i lehtë dhe jo gjithmonë lojtarët më të mirë mund të trajtojnë gjithçka. Statistikat kanë për qëllim të interpretohen, por nëse ju shikoni statistikat e Messit, gjatë gjithë karrierës së tij, ato janë mbresëlënëse, nuk mund ta besoni. Dhe kjo është e mjaftueshme për të hyrë në historinë e futbollit, por nganjëherë nuk është e mjaftueshme për Botërorin. Ai duhet të jetë kampion i Kupës së Botës për të hyrë në histori, ose nuk është i denjë, me këtë gjë nuk pajtohem kurrsesi", përfundoi Tabarez.

OSKAR TABAREZ

"Messi është një lojtar i madh, por nuk mund të bëjë gjithçka, ky është një sport ekipor. Ai luan me lavdërime për atë që është më i miri, por duke marrë të gjithë fajin mbi supe, kur gjërat nuk shkojnë mirë, edhe kur ai nuk është përgjegjës, kjo nuk shkon. Futbolli nuk është i lehtë dhe jo gjithmonë lojtarët më të mirë mund të trajtojnë gjithçka

Gjermania në "Rusi 2018" me rekord

Rrugëtimi i Gjermanisë në kualifikueset për Botërorin e Rusisë u mbyll me rekord. Pas fitores së 10-të në po aq sfida të Grupit C, 5-1 ndaj Azerbajxhanit, kampionët e botës në fuqi regjistruan një diferencë golash +39 , si asnjë tjetër në historinë e futbollit evropian. Një rekord për skuadrën e Joakim Lev që kalon në këtë statistikë diferencën +33 të Rumanisë në kualifikueset për Kupën e Botës 1998. Në 10 ndeshje eliminatore skuadra e drejtuar nga Lev numëron 10-të fitore si asnjë tjetër në historinë e kualifikueseve të Botërorit, 43 gola të shënuar dhe vetëm 4 të pësuar. Rezultatet e "Die Mannschaft" përfshijnë edhe fitoret e thella 8-0 dhe 7-0 ndaj San Marino-s, i cili ka humbur të 10 ndeshjet kualifikuese duke regjistruar diferencën më negative të golave për skuadrat evropiane, -49.

Publicitet

Myler shigjeton Ançelotin

Me Hejnkes do të kemi përsëri trajnim të mirë

Tomas Myler ka synuar kritikat ndaj ish-trajnerit të karrierës Karlo Ançeloti, duke thënë se "Bayern Munih do të ketë një trajnim të mirë përsëri, pas kthimit të Jupp Hejnkes". Ançeloti u shkarkua 24 orë pasi BaJernI u mund 3-0 nga PSZH në Ligën e Kampionëve, me ish-trajnerin Hejnkes, që do t'i drejtojë bavarezët deri në fund të sezonit. Presidenti Uli Henes pretendoi se Ançeloti humbi mbështetjen e pesë lojtarëve të rangut të lartë në klub, ndërkohë që ka pasur raporte në Gjermani se seancat e tij të trajnimit ishin të heshtura dhe kishin filluar ta pengonin skuadrën. Arjen Roben thuhet se ka kritikuar seancat, por ka mohuar me forcë pretendimet, ndërsa Mats Humels ka hedhur poshtë, gjithashtu, sugjerimet se ai ishte ndër ata që u kthyen kundër italianit. Por Myler, i cili luftoi në pjesën më të madhe të vitit të Ançelotit për një vend titullari, e ka mirëpritur rikthimin e trajnerit Hejnkes, që iku nga "Allianz Arena" pas tripletës. Ai pranoi se shpreson një përmirësim në përgatitjet e Bajernit. "Do të kemi një stërvitje të mirë, përsëri, – u citua të thoshte për "Welt", pas fitores kualifikuese të Gjermanisë (5-1) ndaj Azerbajxhanit. – Hejnkes është njeriu i duhur, sepse ai mund të frymëzojë skuadrën që të ketë aftësinë për të vuajtur më shumë, për të pasur më shumë përkushtim dhe për një mbrojtje më të mirë. Hejnkes do të punojë me interes dhe pasion. Ka disa "vida", që duhet të shtrëngohen." Bajern Munih, i cili qëndron prapa liderëve të Borussia Dortmund në klasifikimin aktual të Bundesliga, kthehet të luajë kundër Fraiburgut, të shtunën, për kampionat.

"Topi i Artë"

Zbulohen pesë kandidatët e parë

Braziliani Nejmar, lojtar i PSZH, Marselo dhe kroati Luka Modriç, të dy nga Real Madridi, janë tre nga kandidatët e parë për "Topin e Artë", çmim që jepet për lojtarin më të mirë nga revista franceze "France Football". Pranë tyre janë Paulo Dybala, argjentinasi i Juventusit, dhe francezi N'Golo Kante i Çellsit. Këta janë pesë të parët, që revista organizatore e çmimit prestigjioz individual i ka publikuar në "Twitter". "France Football" do të zbulojë gjatë gjithë ditës 30 aspirantët e këtij çmimi, i cili, pas përfundimit të marrëveshjes që revista ka mbajtur nga viti 2010 me FIFA-n për shpallejn e tij, zgjidhet përsëri nga gazetarët ndërkombëtarë, pa pjesëmarrjen e kapitenëve të ekipeve kombëtare dhe trajnerëve. Më i madhi në këtë edicion është portugezi Kristiano Ronaldo, i cili e ka fituar "Topin e Artë" në vitet 2008, 2013, 2014 dhe 2016 dhe është në ndjekje të argjentinasit Leo Messi, që e ka fituar këtë trofe pesë herë, në vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2015.

DASHI (20/III-20/IV)

Keni disa fillime që më shumë i ngjajnë përfundimeve të punës sesa fjalimeve të përgjithshme! Por, gjërat dhe stresi do ju largojnë gjatë ditës! Në dashuri do të keni konflikt emocionesh, që do ju jepni mundësi të reja për jetë!

DEMI (21/IV-20/V)

Shoku i juaj i zemrës apo dikush i afërt do ju ndihmojë! Fjalët që do ua thonë do jeni shumë të këndshme! Është mënyra më e mirë për të mos u keqkuptuar më të tjerët dhe të filloni një drejtim të ri në jetë.

BINJAKËT (21/V-20/VI)

Nuk dini saktësisht se çfarë të mendoni sot pasi që një lajm i ri dhe i madh do vije për ju. Do të ndiheni konfuz por kjo do ju ndihmoj për të marrë përgjigjen e mundshme! Është momenti i duhur që të mendoni më shumë edhe për familjen.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)

Jeni përplot energji kështu që duhet të fokusoheni më shumë në punët që keni! Mos u stresoni shumë pasi që mund të keni problem me njerëz të ndryshëm. Në fund do të arrini që të bëni atë që e keni paraparë!

LUANI (23/VII-22/VIII)

Do të ndjeni të ndrydhur nga puna sot! Megjithatë është mirë të punoni! Ajo çka duhet të përpiqeni është që të lëni përshtypje tek njerëzit e tjerë sidomos tek ata të cilët japin komplimente!

VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)

Gjithmonë do të jeni të gatshëm që t'i ndihmoni shokët apo bashkëpunëtoret e juaj. Jepni kohë më shumë vetës për të dalë nga konfuzioni dhe vikendin ta kaloni sa më mirë.

PESHORJA (23/IX-22/X)

Keni një dëshirë të brendshme e cila i përgjigjet përpjekjeve të juaja për t'u kënaqur me jetën dhe kënaqësitë e vogla. Ky mund të jetë njëri prej veprimeve më të mira që do ju kënaq në të ardhmen.

AKREPI (22/X-21/XII)

Sot është një ditë ku duhet që të jeni sa më "in" sidomos në punë! Yjet ju sugjerojnë që të merreni më shumë me besimin në gjërat që kanë të bëjnë personalisht me juve!

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)

Bëhuni një njeri pak më i ashpër më të afërmit pasi që nuk janë duke punuar shumë! Kjo sepse nuk jeni në gjendje që të punoni sa duhet! Në fund do të arrini që të keni një ngritje më të madhe në karrierë.

BRICJAPI (22/XII-20/I)

Një koment i çuditshëm do t'ju dal në rrugë edhe pse paksa më vonesë. Yjet ju sugjerojnë që t'i injoroni ata që ju paraqiten aktorë para syve! Keni maturinë e nevojshme për t'ia dal mban shumë gjërave.

UJORI (20/I-19/II)

Është një ditë e mirë për të bërë regjim tek të tjerët! Në fund do të humbni një mundësi të mirë dashuria! Megjithatë mos mërziteni pasi që gjëra të reja do të dalin në sipërfaqe.

PESHQIT (20/II-19/III)

Ana e juaj emocionale është shumë e fuqishme sot! Kështu do të ndiheni të pakalueshëm në shumë gjëra. Keni kujdes nga moti pasi që mund të keni probleme me shëndetin..



						Mensur Mamuti	MUZIKANTI ITALIAN NË FOTO	VEPËR E MUZIKANTIT NË FOTO	SHTIM I POPULLSISË	AKTORI AMERIKAN, HOK
						AKTORI AMERIKAN, DEP				
						VEGËL MUZIKORE ME KATËR PALË TELA (SH.)				
						SHKRONJË GREKE				
						VRULL				
						ÇDONJËRI NGA DY SKAJET E BOSHTIT TË TOKËS				I DYFTYRSHËM
						SPANJA		SHKRONJA FQINJE / DËSHTIM		
						NJËSIA E FUQISË / SQUFURI				
KOHA	ENERGJIA	FRIKËSOHEM / BANORE E NJË SHTETI EVROPIAN	T	GYP QELQI ME ILA1Ë PËR INJEKSION	SHKAK (KRAHIN.) / AZOTI					
PJESË E TELEVIZIONIT						LLOJ LETRE SHTYPI / ELEMENT KIMIK (N)				
KOHA					ADRESA (SHKURT.) / NË RREGULL (ANG.)				KALIUMI / TABELA E OREVE	
VEPRIMTARIA MUZIKORE E PERSONIT NË FOTO										
VEPËR E MUZIKANTIT NË FOTO							JO I MOSHUAR / ELEKTRO-MOTOR			
POETESHA LIBANEZE, ADNAN					ÇËSHTJET E DISKUTIMIT / REOMIRI					
HIDHËRIM								RIMINI		

ZGJIDHJET: XHONI, UTAT, ZETA, ELAN, POL, E, IH, VATI, T, SEBEP, EKRAN, ROTO, REM, ADR, K, KOMPOZITOR, NABUKO, I RI, ETEL, TEMAT, ZEMËRIM, RI.

Sudoku

shumë i lehtë

			5		6			
	9	8						
			9		3	2	6	
4		1		2		9		5
			8		1			
7		2		5		8		1
		3	7		5		8	
		7					2	
			1		2			

mesatar

			4	2	3			
	2		7		5		9	
3								5
1	8		5		9		7	3
9								1
7	4		1		2		8	6
4								9
	6		9		8		3	
			3	5	4			

Shumë i lehtë: 324516798, 698274513, 175983264, 481627935, 539841672, 762359841, 213765489, 957438126, 846192357. **Mesatar:** 659423718, 821765394, 374891625, 186549273, 932687541, 745132986, 413276859, 567918432, 298354167.



Golriz Ghahraman, deputetja e parë refugjate në Zelandë të Re

Numërimi i të ashtuquajturave "vota special" pas zgjedhjeve në Zelandë të Re, i ka siguruar një vend në Parlamentin e këtij shteti edhe Golriz Ghahraman, deputetja e parë refugjate në histori të këtij shteti. Ghahraman kishte ardhur në Zelandë të Re nga Irani kur ishte vetëm nëntë vjeçare. Tani 36 vjeçare, Ghahraman, që i takon partisë së të gjelbërve, ka punuar më parë për Kombet e Bashkuara si avokate ndërsa është shkolluar në Universitetin e Oxfordit. Në zgjedhjet e fundit në Zelandë asnjë parti nuk ka arritur ta fitojë shumicën prej 61 votash që ta formojë qeverinë. Partia Nacionale që udhëhiqet nga Bill English, në zgjedhjet e 23 qershorit ka fituar 58 ulëse, ndërsa Laburistët që udhëhiqen nga Jacinda Ardern, arritën 45 ulëse. Tani qeveria duhet të formohet me koalicione dhe pritet që ai që do të vendos se kush do ta bëjë qeverinë do të jetë edhe njëherë, populisti i paparashikueshëm, Winston Peters - lideri i Partisë së Parë të Zelandës së Re. Të Gjelbrit që kanë siguruar shtatë ulëse, janë partnerë natyralë të Laburistëve.

"Karoshi" po vret çdo ditë e më shumë japonezët

Vdekja për shkak të stresit në punë ose karoshi është një rrezik për shëndetin dhe njihet zyrtarisht si sëmundje nga Ministria e Shëndetësisë japoneze që nga viti 1987

Jeta e japonezëve është mjaft stresuese me ditë të gjata pune, pak pushime, presione për shkak të hierarkisë së shoqërisë etj. Të gjitha këto kanë lindur një dukuri, atë të vdekjes për shkak të stresit në punë, ose për shkak të një pune të mbingarkuar. Dukuri që njihet me emrin karoshi. Vdekja për shkak të stresit në punë ose karoshi është një rrezik për shëndetin dhe njihet zyrtarisht si sëmundje nga Ministria e Shëndetësisë japoneze që nga viti 1987, me një mortalitet në rritje nga komplikacionet e shëndetit si goditje cerebrale apo atake kardiake. Një vdekje e pësuar nga dikush që punon më shumë se 65 orë në javë për më shumë se një muaj konsiderohet karoshi. Kjo dukuri filloi të lindte pasi shkatërrimit të Japonisë nga Lufta e Dytë Botërore. Sipërmarrja filloi të konsiderohej si një familje, ku i punësuari i dedikonte trup e shpirt dhe në këmbim i ofrohej një punë gjithë jetën, rritje rroge dhe rangu dhe përfitime të tjera si mundësia për të çuar fëmijët në shkolla të caktuara apo institute. Rasti i parë karoshi u raportua në vitin 1969, kur një nëpunës i një shoqërie gazetash vdiq për shkak të një ataku kardiak në moshën 29 vjeçare, duke punuar pa pushim dhe pa fjetur. Ky rast nuk pati vëmendjen mediatike dhe nuk u bë i ditur emri i personit, derisa katër vite më vonë Hosokawa, Tajiri dhe Uehara publikuan një libër me titull "Karoshi" dhe që aty dukuria filloi të kuptohej si një problem shëndetësor që prek të gjithë shoqërinë sepse është një mënyrë jetese nga e cila rrjedh një pasojë. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës, japonezët punojnë më shumë se 12 orë duke lënë mënjanë jetën personale dhe dukuria karoshi numëron 10.000 vdekje në vit, një shifër jo shumë e qartë pasi ka edhe raste që nuk publikohen. Nga ana tjetër vetëvrasjet për shkak të stresit në punë, njihen me emrin karoshisatsu. Simptomat e karoshit janë varësia nga puna dhe ankthi i pamundësisë për të mbyllur gjithçka në ditët e pushimit, në pushime si dhe ndenja e fajit kur nuk e bën si duhet punën, si dhe problemet e gjumit, dhimbjet e stomakut dhe të kokës. Disa ndërmarrje kanë kufizuar numrin e orëve ekstra si dhe janë ofruar për të gjetur zgjidhje për një ekuilibër të jetës personale dhe profesionale. Megjithatë shumë pak e ndjekin sepse shihet me sy të keq dalja shpejt nga puna kur të tjerët punojnë akoma. Mbetet ende shumë për të bërë në drejtim të trajtimit të kësaj dukurie.

KALENDARI HISTORIK 10 TETOR

1631 - Ushtria saksone okupon Pragën.
1695 - Mbreti Willem III ik nga Holanda Jugore dhe kthehet në Angli
1839 - Trupat angleze okupojnë Bejrutin.
1913 - Anija britanike për udhëtarë Volturno kaplohet nga zjarri në Oqeanin Atlantik ku vdesin 136 persona.
1935 - Lidhja e Kombeve dënon sulmin e Italisë ndaj Abisinisë (Etiopisë).

1957 - Aksidenti në reaktorin nuklear britanik në Windsdale.
1963 - Franca heq dorë nga kontrolli i bazës detare Bizerte në Tunizi.
1970 - Shpallet pavarësia e Fixhit.

A E DINI SE...



Presidenti i 15 i SHBA-së, Xhejms Bukanan, blinte vazhdimisht skllevër me paratë e tij, në mënyrë t'u garantonte më pas atyre lirinë.

Studimet tregojnë se burrat përjetojnë në fakt më shumë dhimbje emocionale pas ndarjes se sa femrat.

Në vitin 1980, një spital Las Vegas pushoi nga puna disa punonjës, pasi kishin vënë baste se kur do të vdisnin pacientët.

BARSOLETA

MADHËSIA

Një sipërmarrës varrimi punoi deri vonë natën. Ai e përgatiti trupin e zotëri Schwartz për djegie, por gjatë punës u habit kur ia pa "senin" e madh.
- "Me vjen keq zotëri Schwartz, por nuk mund të lejoj që edhe ky 'sen' të digjet. Duhet të ruhet për brezat e ardhshëm...". Kështu që ia preu dhe e futi në çantë dhe e mori në shtëpi.
- "Eja të shohësh diçka" - i tha gruas se tij duke e hapur çantën.
- "O zot", bërtiti gruaja - "paska vdekur zotëri Schwartzi".

THËNIA E DITËS

Breshka, gomari dhe prindi kanë fatin të mbajnë samarin tërë jetën në shpinë. (Dritëro Agolli)